

NDIKIMI I SHQIPËRISË NË RAJON NË HAPËSIRËN SHQIPFOLËSE

Autorë: Dorian Jano
Enri Hide
Klodjan Rama
Ben Andoni

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG

NDIKIMI I SHQIPËRISË NË RAJON NË HAPËSIRËN SHQIPFOLËSE

Tiranë 2018

Botues: Friedrich-Ebert-Stiftung
Office Tirana
Rr. Abdi Toptani
Torre Drin, Kati i 3-të
Kutia Postare 1418
Tiranë, ALBANIA

Përgjegjëse: Mariola Qesaraku
Redaktor: Dorian Jano

Autorë: Dorian Jano,
Enri Hide,
Klodjan Rama,
Ben Andoni

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit Friedrich Ebert.

Publikimet e Fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE ____ ***5***

POLITIKA E JASHTME DHE E SIGURISË E SHQIPËRISË NË BALLKANIN PERËNDIMOR ____ ***9***

POLITIKA E JASHTME DHE E SIGURISË E SHQIPËRISË NË BALLKANIN PERËNDIMOR ____ 11

KONTRIBUTI I SHQIPËRISË NË RAJON ____ 13

MARRËDHËNIET DYPALËSHE DHE BASHKËPUNIMI NË FUSHËN E SIGURISË ____ 15

Shqipëria dhe Maqedonia: ____ 15

Shqipëria dhe Kosova: ____ 16

Shqipëria dhe Mali i Zi: ____ 18

Shqipëria dhe Serbia: ____ 19

RRUGA DREJT TË ARDHMES: 'LIDER I RAJONIT' ____ 21

NDIKIMI EKONOMIK I POLITIKAVE TË SHQIPËRISË NDAJ SHQIPTARËVE NË TË GJITHË RAJONIN E BALLKANIT PERËNDIMOR ____ ***23***

KUADRI INSTITUCIONAL DHE MARRËVESHJET EKONOMIKE ____ 24

MARRËDHËNIET EKONOMIKE ____ 27

Shqipëri-Kosovë: ____ 27

Shqipëri-Maqedoni: ____ 31

Shqipëri - Mali i Zi: ____ 34

Shqipëri – Serbi: ____ 36

PRIORITET POLITIKAVE SEKTRORIALE DHE ATO LOKALE ____ 38

NDIKIMI I SHQIPËRISË NË RAJON NË KULTURË, ARSIM, MEDIA DHE SPORT ____ ***40***

INSTITUCIONALIZIMI I MARRËDHËNIEVE NDËR-KULTURORE ____ 42

SFIDAT E NDIKIMIT NË KULTURË: NGA MARRËVESHJET TEK PERCEPTIMI PUBLIK ____ 44

Roli i Medias: Fuqizimi i Institucioneve Private ____ 49

Sporti: Bashkëpunim në një Sektor të Globalizuar ____ 51

Potencialet e Arsimit ____ 52

Periferi e Periferisë: Rasti i Luginë së Preshevës dhe Bujanovcit ____ 55

DREJT KRIJIMIT TË SISTEMEVE TË PËRBASHKËTA KULTURORE ____ 56

SHTOJCA: MARRËVESHJET BILATERALE TË SHQIPËRISË ME VENDET E RAJONIT ____ ***58***

I. MARRËVESHJET MIDIS SHQIPËRISË DHE MAQEDONISË ____ 58

II. MARRËVESHJET MIDIS SHQIPËRISË DHE MALIT TË ZI ____ 61

III. MARRËVESHJET MIDIS SHQIPËRISË DHE KOSOVËS ____ 63

IV. MARRËVESHJET MIDIS SHQIPËRISË DHE SERBISË ____ 69

FIGURA DHE TABELA

Figura 1 Marrëdhëniet ekonomike midis Shqipërisë dhe Kosovës (2010-Gusht 2017) 27
Figura 2 Importet e Kosovës sipas vendeve të origjinës (2010-2015) 28
Figura 3 Eksportet e Kosovës sipas vendeve të origjinës (2010-2015) 29
Figura 4 Trendi i shkëmbimeve tregtare Shqipëri-Maqedoni (në mil. Euro) 32
Figura 5 Marrëdhëniet tregtare midis Shqipërisë dhe Malit të Zi (në miliona Euro) 34
Figura 6 Marrëdhëniet tregtare midis Shqipërisë dhe Serbisë (në miliona Euro) 37

Tabela 1 Shkëmbimet tregtare të Shqipërisë me Kosovën 2010- 2016 (Mln Euro) 28
Tabela 2 Eksportet e Kosovës drejt Shqipërisë sipas grup mallrave (në Euro) 29
Tabela 3 Importet e Kosovës nga Shqipëria sipas grup mallrave (në Euro) 29
Tabela 4 Numri i vizitorëve drejt Shqipërisë 30
Tabela 5 Stoku i investimeve të huaja direkte 31
Tabela 6 Shkëmbimet tregtare midis Shqipërisë dhe Maqedonisë (në miliona Euro) 32
Tabela 7 Eksportet shqiptare drejt Maqedonisë gjatë viteve 2011-2016 (në Euro) 32
Tabela 8 Importet shqiptare nga Maqedonia gjatë viteve 2011-2016 (në Euro) 33
Tabela 9 Stoku i IHD-ve (në miliona Euro) 33
Tabela 10 Numri i turistëve që kanë vizituar Shqipërinë 2013-2015 34
Tabela 11 Marrëdhëniet tregtare midis Shqipërisë dhe Malit të Zi 2010 – 2016 (në miliona Euro) 34
Tabela 12 Eksportet shqiptare sipas grup mallrave 35
Tabela 13 Importet shqiptare nga Mali i Zi sipas grup mallrave 35
Tabela 14 Numri i vizitorëve nga Mali i Zi gjatë 2013-2016 36
Tabela 15 Marrëdhëniet tregtare midis Shqipërisë dhe Serbisë (në miliona Euro)2010 – 2017 37
Tabela 16 Importet shqiptare nga Mali i Zi sipas grup mallrave (in 000 Euros) 38
Tabela 17 Eksportet shqiptare nga Mali i Zi sipas grup mallrave (in 000 Euros) 38

HYRJE

Dorian JANO

...ajo që të gjithë ju patë sot, në fakt është kurorëzimi i një pune përgatitore, të gjatë, jo thjeshtë për të bashkërenduar dokumentet e marrëveshjeve, por për të çuar përpara një plan strategjik integrimi të hapësirës sonë të përbashkët, të ndërveprimit ekonomik dhe kulturor, sepse ai politik është një ndërveprim që nuk ka munguar asnjë çast, qysh në krye të herës. Takimi i sotëm konsolidon pa kthim, një proces ku rruga drejt bashkimit kombëtar, e parë si integrim mes vedi, në funksion të modernizmit të dy shteteve tona dhe integrimit të tyre të plotë në Bashkimin Evropian, ka një përmasë shumë konkrete, të përditshme, idesh, projektesh, instrumentesh dhe energjish të përbashkëta, që po jetësojnë dita-ditës, një angazhim kombëtar të përbashkët, krijimin e hapësirës së njehsuar dhe modelin e bashkëpunimit mes nesh, por dhe për rajonin më gjerë. Deklarata e Kryeministrit Edi Rama në konferencën për shtyp me Kryeministrin e Kosovës, pas mbledhjes së përbashkët të dy qeverive

Roli i Shqipërisë në rajon shpesh-herë është vlerësuar si neutral dhe larg interesave të saj kombëtare, dhe vetëm vitet e fundit ka një qasje me të fokusuar dhe artikuluar drejt hapësirave mbarë-kombëtare. Në analizat e studiuesve të ndryshëm, politika e jashtme rajonale e viteve 1992 deri në vitin 2013 rezulton ti ketë rezistuar me sukses presioneve për të ndërhyrë në çështjet e brendshme të vendeve fqinjë ku jetojnë bashkëkombësit e saj.[1] Madje në vlerësimet e diplomateve të njohur shqiptar, Tirana zyrtare ka qenë aq e përkëdhelur dhe madje e obsesionuar nga roli konstruktiv, moderues dhe gjenerator i paqes dhe stabilitetit në rajon, aq sa që në disa raste ajo ka anashkaluar disa ekzigjenca të interesave të saj kombëtare.[2] Ndërkohë që pas vitit 2014, qeveria shqiptare po ndërmerr disa hapa konkretë për të rritur ndikimin e saj në rajonin shqipfolës duke institucionalizuar bashkëpunimin dhe marrëdhëniet me vendet fqinje në nivel të një partneriteti strategjik. Kjo frymë e re, pasqyrohet jo vetëm në prioritetet dhe dokumentet strategjikë të qeverisë, por edhe tek rrethet e politik-bërësve edhe ato intelektuale. Mbrojtja e interesave kombëtare dhe forcimi i rolit dhe i ndikimit të politikës së jashtme shqiptare në rajon po artikulohet si një bosht i

[1] Për një analizë të detajuar të politikës së jashtme rajonale shqiptare të mosndërhyrjes nga viti 1992 deri në vitin 2013 shih: Gjevori, Elvin (2018) "Kin state non-interventionism: Albania and regional stability in the Western Balkans", *Nations and Nationalism* 24 (1): 171–193.

[2] Citim i diplomatit të njohur shqiptar Shaban Murati nga libri i tij "Hije në diplomacinë shqiptare" (2012: 247). Referuar: Beshku, Klodiana (2016) "Perceptime të Intelektualëve mbi Performancën e Politikës së Jashtme Shqiptare (2013-2015)", Qendra e Ekselencës, Ministria e Punëve të Jashtme, Maj, Tiranë, fq.20.

rëndësishëm i cili përshkruan vertikalisht të gjithë boshtet e tjera të politikës së jashtme shqiptare; ajo përbën një nga prioritetet kryesore dhe po gërshetohet me objektivat dhe përparësitë kombëtare të anazhimit tonë në NATO dhe anëtarësimit në BE.[3] Në të njëjtën linjë me politikën e jashtme shqiptare të pas viteve 2014, edhe perceptimi i intelektualëve dhe ekspertëve të politikës së jashtme është rritur ndjeshëm ndaj marrëdhënieve me shtetet fqinjë, duke e kushtëzuar bashkëpunimin rajonal me mbrojtjen e interesit kombëtar.[4] Sipas studimit të qendrës së ekselencës pranë Ministrisë së Jashtme, i cili analizon perceptimet e profesionistëve të politikës së jashtme, 'ruajtja e interesit kombëtar' është një element i cili përmendet shpesh nga përgjigje-dhënësit në mënyrë spontane, edhe kur nuk kërkohej specifikisht nga pyetja.[5]

Po cila është dinamika e bashkëpunimit midis Shqipërisë dhe vendeve të rajonit shqip-folës dhe çfarë ndikimi ka krijuar ajo sot? Kjo është pyetje kryesore e cila do të trajtohet nga esetë e këtij botimi. Qëllimi i këtij studimi është të kuptojë më mirë zhvillimet e fundit në marrëdhëniet bilaterale midis Shqipërisë dhe vendeve të rajonit si dhe ndikimin e tyre në rajonin shqip-folës. Në këtë koleksion esesh, ne analizojmë dinamikën aktuale të bashkëveprimit midis Shqipërisë dhe shteteve fqinje me popullsi shqipfolëse, duke pasur parasysh jo vetëm analizën institucionale dhe marrëdhëniet ndërshtetërore por edhe analizën e këndvështrimit shoqëror dhe perceptimit publik. Në mënyrë që të krijojmë një kuptim sa më gjithëpërfshirës, si dhe një analizë shumëdimensionale të zhvillimeve të fundit ne kemi shqyrtuar jo vetëm burime parësore (kryesisht dokumente zyrtare, të dhëna statistikore, prononcime publike të drejtuesve të lartë, si dhe intervista me ekspertë dhe personalitete të fushës) por edhe ato dytësore (studime dhe analiza, artikuj dhe komente mediatike). Në këtë koleksion esesh, ne do të trajtojmë në mënyrë të veçantë iniciativat e bashkëpunimit të thelluar në planin politik, ekonomik dhe atë kulturo të marrëdhënieve dypalëshe të Shqipërisë me vendet e rajonit ku ka popullsi Shqiptare, duke e vendosur fokusin jo vetëm në diskursin politik dhe folklorizmin e çështjes, por edhe në forcimin institucional të marrëdhënieve specifike mes shteteve si dhe ndikimin real të Shqipërisë në rajon në hapësirën shqipfolëse.

Politika e jashtme e Shqipërisë sot, ka kaluar nga një rol 'pasiv', tepër neutral në rajon, drejt një politike me aktive në bashkëpunimin rajonal dhe së fundmi një qasje më bilaterale sidomos me shtetet ku ka shqiptarë, por të gjitha këto nën kuadrin e integrimit evropian dhe parimit të fqinjësisë së mirë. Në vlerësimin tonë, politika e jashtme e Shqipërisë mund dhe duhet të luajë një rol të rëndësishëm jo vetëm në promovimin dhe mbrojtjen e interesave,

[3]Shih: "Prioritetet" e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme http://www.punetejashtme.gov.al/al/misioni/prioritetet, parë për herë të fundit në 23 janar 2018; si dhe Bushati, Ditmir (2015) "A ka Shqipëria një politikë të jashtme?", Fjala e Ministrit Bushati mbajtur në Fakultetin e Shkencave Sociale, 28 tetor, http://www.punetejashtme.gov.al/al/zyra-e-shtypit/fjalime/fjala-e-ministrit-bushati-mbajtur-ne-fakultetin-e-shkencave-sociale-me-teme-a-ka-shqiperia-nje-politike-te-jashtme, parë për herë të fundit në 23 janar 2018.

[4] Beshku, Klodiana (2016) "Perceptime të Intelektualëve mbi Performancën e Politikës së Jashtme Shqiptare (2013-2015)", Qendra e Ekselencës, Ministria e Punëve të Jashtme, Maj, Tiranë, fq. 20.

[5] *Po aty*. fq.23.

identitetit dhe kulturës kombëtare (roli primar në *RealPolitikë*) por edhe atë të promovimit të një qëllimi dhe misioni të përbashkët politik të fqinjësisë së mirë dhe integrimit të rajonit në familjen evropiane. Çdo iniciativë e ndërmarrë në nivel dypalësh apo atë rajonal do të duhet të ketë si qëllim fundor përmirësimin e jetesës së qytetarëve të dy (gjithë) vendeve, përparimin e zhvillimit rajonal dhe përshpejtimin e integrimit në BE. Ajo që vërehet, është se pavarësisht strategjive dhe iniciativave të shumta, shumica e angazhimeve të ndërmarra mbeten përsëri në letër ose pa një vazhdimësi. Nëse në aspektin institucional ka një rritje të bashkëpunimit në nivel kortezial dhe dikasteresh, kjo gjë duket se po zbehet në nivel shoqëror dhe sidomos midis grupeve të ndryshme të interesit dhe njësive ekonomike private apo atyre lokale. Për më tepër, ndikimi i këtij procesi është shumë i pakët mes publikut, dhe ndryshimi në perceptimet e ndryshme qytetare lidhet kryesisht me cilësinë e marrëdhënieve dhe krijimi e periferive në pothuajse shumicën e fushave të bashkëpunimit (periferi shoqërore, politike, ekonomike dhe kulturore). Egziston rreziku që të gjitha këto iniciativa të bashkëpunimit dypalësh në hapësirën shqip-folëse të humbasin besueshmërinë për sa kohë mbeten në nivel qendror dhe retorik, pa rezultate konkrete afatgjata për popullsinë në përgjithësi dhe me perspektivën e cunguar të një projekti më madhor atë të integrimit sa më të shpejtë në hapësirën evropiane. Ka ardhur koha, që institucionet të krijojnë instrumentet e duhura të monitorimit të marrëveshjeve dhe iniciativave të ndërmarra, mekanizmat e duhura shtesë të fuqizimit të bashkëpunimit në nivel lokal dhe nga aktorë privatë në mënyrë që t'i japi jetë një bashkëpunimi real dhe afatgjatë në hapësirën rajonale shqip-folëse.

Ky koleksion esesh është një analizë kritike e diskursit, politikave dhe institucioneve në lidhje me rolin e Shqipërisë në rajon në hapësirën Shqip-folëse, jo vetëm për të kuptuar dhe bërë një analizë të situatën aktuale por edhe për të sugjeruar rekomandime konkrete se ku duhet të rahi më shumë politika e jashtme e Shqipërisë në rajon. Për nxitjen dhe forcimin e një bashkëpunimi dypalësh më efikas dhe real, përveç masave të ndërmarra deri më tani, ne mendojmë që tre duhet të jenë objektivat kryesore:

- Nënvizimi i avantazheve reciproke në të gjitha fushat: Qeveria dhe misionet diplomatike shqiptare dhe aktorë të tjerë të shoqërisë në rajon do të duhet jo vetëm të bashkëpunojë por edhe të asistojë në marrëdhënie të qëndrueshme dypalëshe me vendet e rajonit në shumë fusha me interes të përbashkët për të promovuar dhe mbrojtur jo vetëm interesat e vendit, si një rol klasik i diplomacisë, por edhe për të krijuar ura reciprociteti për interesa të përbashkëta me vendet e rajonit, siç është lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit, zhvillimi ekonomik, konsolidimi i demokracisë dhe respektimi i minoriteteve.
- Angazhim gjithëpërfshirës dhe i baras-peshuar në të gjithë vendet me popullsi shqiptare: Për të shmangur diferencimin midis vendeve dhe krijimin e periferive të periferisë, do të duhet të krijohen instrumente dhe iniciativa të cilat të krijojnë hapësira për të gjithë komunitetin shqip-folës pavarësisht origjinës së shtetit. Hapësira e përbashkët duhet të jetë e njehsuar dhe e baraspeshuar për të krijuar mundësi për të gjithë popullsinë shqipfolëse.

- Krijimin e mekanizmave të një bashkëpunimi dypalësh të decentralizuar: Përmirësimi i marrëdhënieve dypalëshe, përveç takimeve dhe shkëmbimit të vizitave zyrtare të nivelit të lartë, duhet të zhvillohet edhe në nivel specialistësh apo atë lokal pasi ky bashkëpunim do të duhet të jetë objektivi fundor i cili ka ndikim të drejtpërdrejtë në komunitet dhe tek qytetarët. Gjithashtu, do të duhet të krijohen të gjithë lehtësitë burokratike dhe stimuj konkretë për të inkurajuar marrëdhëniet dypalëshe edhe midis institucioneve private dhe grupeve të interesit, të tilla si universitete, institute, sindikata, mediave, organizata profesionale dhe ato jo-fitim prurëse, dhomave të tregtisë etj., pasi ato janë një faktor ndikimi afat-gjatë dhe substancial.

POLITIKA E JASHTME DHE E SIGURISË E SHQIPËRISË NË BALLKANIN PERËNDIMOR

Enri HIDE

Në politikat ndërkombëtare ka ekzistuar gjithmonë dallimi midis fuqive të mëdha, shteteve që ndikojnë në natyrën e rregullave të arenës ndërkombëtare, dhe fuqive të vogla, të cilat shpesh nuk janë në gjendje të ndryshojnë ose formësojnë rregulla. Implikimet e një konfigurimi të tillë bëjnë që ata të ndjekin strategji të ndryshme për të promovuar dhe mbështetur interesat kombëtare, duke iu qasur politikës së jashtme dhe aleancave në mënyrë të ndryshme. Rothstein (1966) i ka përshkruar fillimisht fuqitë e vogla si "shtete që e pranojnë se nuk mund ta garantojnë sigurinë kryesisht duke përdorur kapacitetet e tyre dhe se duhen bazuar thellësisht tek ndihma e shteteve, institucioneve, proceseve dhe zhvillimeve të tjera".[6]

Me një popullsi më pak se 3 milionë banorë dhe vetëm 0.06% të GDP-së së Shteteve të Bashkuara, Shqipëria renditet padyshim mes fuqive të vogla në politikën ndërkombëtare. Sjellja e saj si e tillë ka qenë e qartë dhe e dukshme që prej fundit të Luftës së Dytë Botërore, kur vendi u radhit krah fuqive më të mëdha komuniste, duke forcuar sistemin socialist brenda tij dhe duke i rezistuar ndikimit të fuqive të mëdha perëndimore. Këto aleanca përfshinë fillimisht Bashkimin Sovjetik e më pas Kinën. Vetëm për një periudhë të shkurtër kohore përpara rënies së komunizmit, vendi u izolua plotësisht për t'u bazuar në dukje në kapacitetet e tij. Kjo periudhë është e njohur për vështirësitë e mëdha ekonomike dhe sociale. Politika e jashtme e Shqipërisë pas rënies së komunizmit ka ndjekur përgjithësisht një model të ngjashëm, ku Bashkimi Evropian dhe NATO kanë shërbyer si mbështetës të kapaciteteve të Shqipërisë për të garantuar sigurinë e saj dhe për t'u shndërruar në aktor të rëndësishëm gjeopolitik në rajonin e saj të drejtpërdrejtë. Rothstein identifikon tre aspekte unike të gjendjes së një fuqie të vogël. Së pari, nevojitet ndihmë e huaj dhe mbështetje. Shqipëria është bazuar gjerësisht në ndihmën dhe aleancat me Shtetet e Bashkuara, vendet-anëtare të Bashkimit Evropian dhe sidomos NATO, për t'u transformuar nga një konsumator sigurie në

[6] Rothstein, R. L. (1966) "Alignment, Nonalignment, and Small Powers: 1945-1965", *International Organization*, 20(3), fq. 397-418

ofrues sigurie për rajonin e Ballkanit Perëndimor. Për rrjedhojë, Shqipëria e ka përdorur këtë qasje për të promovuar interesat e saj kombëtarë dhe për të mbrojtur interesat e shqiptarëve të shpërndarë në vende të ndryshme të rajonit. Së dyti, mundësitë që ka një fuqi e vogël për të garantuar sigurinë janë të pakta, ndërsa koha për të korrigjuar gabimet është më e kufizuar. Kjo vlen sidomos për pozicionin shpesh të pasigurt të Shqipërisë në rajon dhe për marrëdhëniet e saj shpesh të brishta me vendet e tjera, veçanërisht Serbinë, e cila ka vepruar shpeshherë si konkurrente e faktorit shqiptar në Ballkanin Perëndimor. Së fundi, liderët e shteteve të tilla e shohin mungesën e fuqisë si një element të patjetërsueshëm të identitetit të tyre në politikën e jashtme, pra si një determinizëm gjeopolitik. Liderët shqiptarë kanë theksuar vazhdimisht rëndësinë e integrimit të vendit në Bashkimin Evropian dhe NATO, në të gjitha fjalimet e tyre, strategjitë e politikës së jashtme dhe diskursin publik. Edhe kur në rajon janë shfaqur apo intensifikuar diskutimet rreth nacionalizmit etnik shqiptar, ose kur ideja e të ashtuquajturës "Shqipëri e Madhe" ka fituar disi vëmendjen e diskursit publik në rajon, liderët shqiptarë e kanë refuzuar këtë retorikë dhe kanë insistuar në vend të saj në rëndësinë e paqes dhe stabilitetit të rajonit. Një retorikë e tillë mund t'i atribuohet asaj që Rothstein e konsideron "dobësia e përhershme e një shteti të vogël".

Studimi akademik i shteteve të vegjël në Evropën e sotme fokusohet në identifikimin e përgjigjeve për dy çështje: e para për politikat e sigurisë së shteteve të vegjël, ndërsa e dyta për implikimet mbi integrimin evropian. Të dyja lidhen ngushtësisht me politikën e jashtme aktuale të Shqipërisë. Analiza klasike e dallimit midis shteteve të mëdha dhe atyre të vegjël fokusohet tek fuqia. Në këndvështrim pozitiv, fuqia kuptohet si aftësia e shteteve për të ndikuar dhe ndryshuar sjelljen e shteteve të tjerë. Në kuptimin negativ, fuqia mund të kuptohet si aftësia e shteteve për të mos iu nënshtruar presionit të një shtetit tjetër, ose si autonomi. Ky perceptim dual i fuqisë ndihmon klasifikimin e shteteve sipas fuqisë së tyre dhe kategorizimin e tyre në shtete të fuqishëm dhe më pak të fuqishëm. Sipas Goetschel "shtetet e vegjël kanë relativisht pak ndikim mbi mjedisin e tyre ndërkombëtar, ndërsa autonomia e tyre lidhur me këtë mjedis është relativisht e kufizuar".[7] Mungesa e autonomisë ose ndikimi mund të përcaktohet edhe nëpërmjet disa elementëve kuantitativë, si: nga prania ndërkombëtare e një shteti (numri i ambasadave, konsullatave, etj.); nga Produkti i Brendshëm Bruto (PBB); popullsia, përmasat e territorit, etj. Autorë të tjerë kanë shtuar edhe perceptimet psikologjike të liderëve si variabël për të kuptuar më mirë shtetet e vegjël. Në rastin e Shqipërisë mund të argumentohet se politika e jashtme është karakterizuar nga dobësia dhe ndjenja e inferioritetit, si dhe nga perceptimi i lidershipit se ndikimi i vendit në arenën ndërkombëtare është i papërfillshëm dhe përgjithësisht i kufizuar në Ballkanin Perëndimor. Për rrjedhojë, politika e jashtme dhe ajo e sigurisë që një shtet i vogël zgjedh të implementojë, tenton të minimizojë dhe/ose të kompensojë deficitin e fuqisë me të cilin është i detyruar të përballet. Mbështetja e Shqipërisë tek NATO për të promovuar politikën e saj të sigurisë në rajon dhe shndërrimin e vendit në kontribuues për stabilitetin e rajonit përkundrejt tensioneve nacionaliste, reflekton deficitin e fuqisë dhe pozitat e një shteti të vogël.

[7] Goetschel, Laurent (1998) "The foreign and security policy interests of small states in today's Europe", in *Small States inside and outside the European Union* L. Goetschel (ed.), Springer US, fq.20.

Për të analizuar politikën e jashtme dhe të sigurisë të Shqipërisë në rajon gjatë dekadës së fundit, ky studim ndërtohet mbi kuadrin teorik që ofron Rothstein dhe mbi debatin rreth ndikimit që procesi i integrimit në Bashkimin Evropian ka për politikën e jashtme të shteteve të vegjël. Ai shqyrton jo vetëm rolin e Shqipërisë si faktor stabiliteti në rajon, por edhe sendërtimin e marrëdhënieve dypalëshe me vende të caktuara, si Kosovën, Serbinë, Maqedoninë dhe Malin e Zi. Synimi i tij është të hartëzojë politikën rajonale të sigurisë së Shqipërisë dhe ndërveprimin e saj me shtetet e tjerë, për të kuptuar më mirë pozitën e vendit, strategjitë e përdorura për të promovuar interesat kombëtare në rajon dhe mangësitë eventuale të kësaj qasjeje. Studimi merr në shqyrtim ngjarjet kryesore historike që kanë formësuar politikën e jashtme të Shqipërisë gjatë viteve të fundit. Ai bazohet kryesisht në burime parësore dhe dytësore, për të ofruar një analizë deskriptive. Përmes burimeve parësore, shumica e dokumenteve qeveritare që trajtojnë marrëveshje të ndryshme dypalëshe dhe rajonale midis Shqipërisë dhe vendeve të rajonit, do të përpiqemi të kuptojmë fushat kryesore të interesit të vendit në rajon, e specifikisht për secilin shtet. Burimet dytësore, si studimet akademike, analiza e ekspertëve të rajonit, etj, janë përdorur si argumente mbështetëse të burimeve parësore. Për të kuptuar më mirë zhvillimet e fundit dhe ndikimin e vendit në rajon, bazohemi gjithashtu në intervista me ekspertë dhe aktorë relevantë. Ky studim merr gjithashtu në shqyrtim një numër artikujsh mediatikë në vendet fqinje, për të kuptuar perceptimin mediatik e publik, përmes çështjeve që mediat mbulojnë dhe mënyrës së artikulimit të tyre.

Politika e Jashtme dhe e Sigurisë e Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor

Rajoni i Ballkanit Perëndimor ka zënë historikisht rol qendror në strategjinë e politikës së jashtme dhe të sigurisë së Shqipërisë, për shkak të determinizmit gjeopolitik dhe procesit historik që e ka prodhuar atë. Shqipëria ka qenë aktor aktiv në ngjarjet e rajonit, duke synuar të shndërrohet gjatë dy dekadave të fundit nga konsumator sigurie në prodhues sigurie dhe stabiliteti. Për shumë vite, Shqipëria është konsideruar faktor stabiliteti në rajon. Pas rënies së regjimit komunist, vëmendja e vendit u zhvendos kah integrimit Euro-Atlantik. Nevoja për të analizuar ndikimin e Shqipërisë në rajon përforcohet edhe nga rëndësia gjeopolitike e faktorit shqiptar në Ballkan. Për shkak të numrit të lartë të shqiptarëve në rajon, politika e jashtme e Tiranës zyrtare perceptohet si komponent vendimtar për stabilitetin e përgjithshëm të Ballkanit Perëndimor.

Integrimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe NATO ka qenë orientimi kryesor i politikës së jashtme të të gjitha qeverive shqiptare pas rënies së komunizmit. Për qeverinë e udhëhequr nga Ilir Meta, gjatë periudhës 1999-2001, *koalicionit të asokohe "Aleanca për Shtetin" iu desh të përballej me krizën e Kosovës dhe mbështetjen e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë.*[8] Megjithatë, pas përfundimit të luftërave në ish Jugosllavi, diskursi politik dhe lidershipi në Tiranë u orientua kah "unifikimit të shqiptarëve brenda Evropës", duke mos e promovuar idenë e Shqipërisë të Madhe, çka do të stimulonte kriza në shtete të tjera të

[8] Programi i Qeverisë Ilir Meta (28 tetor 1999 – 6 shtator 2001) http://shtetiweb.org/2015/09/14/programi-qeverise-ilir-meta-28-tetor-1999-6-shtator-2001/ (9/11/2017)

rajonit, si në rastin e Maqedonisë në vitin 2001. Sikurse rezulton nga analiza e programit të qeverive të mëparshme, të majta dhe të djathta, radhitja kah politikës së Bashkimit Evropian dhe Shteteve të Bashkuara në rajon, si dhe promovimi i mëtejshëm i paqes dhe sigurisë në Ballkan, përbënin një prioritet madhor dhe rëndësi të jashtëzakonshme strategjike,[9] kurse integrimi në BE dhe NATO u shndërrua në "prioritetin e të gjitha prioriteteve".[10] Pas anëtarësimit në NATO (2009), qeveria shqiptare u angazhua të vazhdonte mbështetjen e një politike të jashtme që synonte paqen, si dhe të vijonte rolin e konsoliduar tashmë si kontribuues i rëndësishëm i paqes dhe stabilitetit në rajon e më gjerë. Integrimi në NATO tregoi një shenjë të qartë të rolit të Shqipërisë në promovimin e NATO-s në rajon. Vihet re se edhe qeveria Rama (2013-2017) u fokusua në sfidat e Shqipërisë për të fituar statusin e vendit kandidat në Bashkimin Evropian, duke nxjerrë qartazi në pah programin e qeverisë, sipas të cilit "*Shqipëria është evropiane jo vetëm brenda rajonit, por edhe globalisht.*"[11] Theksi i mandatit të parë të Kryeministrit Rama u vu në: "*korrigjimin e gabimeve të së kaluarës dhe rritjen e besueshmërisë së strukturave Euro-Atlantike në rajon*".[12] Shqipëria duhet të shërbejë si model për rajonin, sipas këtij programi, në dy drejtime kryesore; së pari, për të promovuar n NATO-n në vendet fqinje dhe, së dyti, duke rritur bashkëpunimin ekonomik me shtetet e Ballkanit Perëndimor. Gjatë kësaj periudhe fokusi u vendos tek *diplomacia në shërbim të zhvillimit ekonomik.*

Në këndvështrimin e qeverisë shqiptare, shprehur në programin e saj politik, bashkëpunimi rajonal ka rëndësi themelore. Në këtë qasje mund të shquhet qartë edhe influenca e Procesit të Berlinit. Që prej fillimit të procesit, në Ballkanin Perëndimor janë shtuar iniciativat e bashkëpunimit rajonal në disa nivele, duke përdorur kryesisht konceptin e "efektit përhapës", pra të integrimit sektorial nëpërmjet samiteve që targetojnë çështje specifike. Siç pohohet në programin zyrtar të qeverisë aktuale shqiptare: "*...synimi nuk është vetëm korrigjimi i gabimeve të së kaluarës që kanë rrezikuar seriozisht të ardhmen Euro-Atlantike të Shqipërisë, por edhe forcimin e cilësisë dhe shpejtësisë së procesit integrues në Bashkimin Evropian, si dhe forcimin e besueshmërisë së vendit në rajon dhe në strukturat Euro-Atlantike*".[13] Disa qeveri pas luftës së Kosovës janë fokusuar në promovimin e stabilitetit të rajonit, ndonëse nacionalizmi mbetet një nga sfidat kryesore. Siç shprehet Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme (MEPJ), roli i Shqipërisë si vend kandidat për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian dhe vend anëtar i NATO-s që prej prillit të vitit 2009, është jetik për zhvillimin dhe stabilitetin e rajonit. Sipas MEJP: "*Shqipëria është vend me rëndësi strategjike për sigurinë, paqen dhe prosperitetin e Ballkanit, Mesdheut dhe Evropës. Politika jonë e jashtme është e vendosur të forcojë rolin dhe kontributin, si faktor me impakt*

[9] Programi i Qeverisë Fatos Nano 4 (2002 – 2005) http://shtetiweb.org/2015/09/13/programi-qeverise-fatos-nano-4-2002-2005/
[10] Programi i Qeverisë Sali Berisha (2005 – 2009) http://shtetiweb.org/2015/09/13/programi-qeverise-sali-berisha-2005-2009/
[11] Programi i Qeverisë Rama (2013 – 2017) http://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2017/09/Programi-i-Qeverise.pdf
[12] *Po aty.* fq.10-12.
[13] Programi zyrtar i qeverisë shqiptare mbi politikën e jashtme: https://kryeministria.al/en/program/european-albania-in-the-region-and-worldwide/foreign-policy (parë për herë të fundit në datën 8/11/2017).

rajonal, për të rritur sigurinë dhe për të garantuar stabilitet politik dhe rritje ekonomike rajonale."[14]

Sipas programit të qeverisë shqiptare, vendi duhet të shërbejë si model për rajonin në dy drejtime: së pari, promovimi i NATO-s në vendet fqinje dhe, së dyti, përmes rritjes së bashkëpunimit ekonomik me shtetet e Ballkanit Perëndimor. Prandaj gjatë kësaj periudhe fokusi u vendos *tek diplomacia në shërbim të zhvillimit ekonomik.* Një prej indikatorëve kryesorë që tregon bashkëpunimin midis Shqipërisë dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor janë Samitet e nivelit të lartë, të mbajtur në kuadrin e Procesit të Berlinit. Ministri i Punëve të Jashtme Ditmir Bushati në një intervistë për Deutsche Welle, theksonte se "*diplomacia ekonomike ka qenë lajtmotivi i viteve të fundit. Në këtë perspektivë, vizita e Kryeministrit Rama në Serbi është realizuar brenda kuadrit të Procesit të Berlinit. Ky proces qartazi po rikonfiguron dhe ristrukturon orientimin rajonal përmes instrumenteve të qartë të bashkëpunimit*."[15] Për më tepër, lidhur me NATO-n dhe influencën e Shqipërisë në rajon, është e rëndësishme të theksohet se Shqipëria është në të njëjtën linjë me politikën e vetë aleancës, duke mbështetur "politikën e dyerve të hapura". Në këtë perspektivë, integrimi i Malit të Zi në organizatë konsiderohet një ngjarje vendimtare për arkitekturën e sigurisë së rajonit. Siç deklaronte Gjenerali Peter Pavel gjatë vizitës në Shqipëri: "*roli i Shqipërisë ka qenë i rëndësishëm për promovimin e bashkëpunimit dhe stabilitetit në Ballkanin Perëndimor si dhe në luftën kundër organizatës terroriste të ashtuquajtur Shteti Islamik "nëpërmjet mbështetjes logjistike të koalicionit kundër ISIL dhe trajnuesve të forcave speciale në Irak*". Një element i rëndësishëm që duhet shtuar këtu është se "*Shqipëria është ofruar të mirëpresë një qendër ekselence të NATO-s për studimin e fenomenit të luftëtarëve të huaj.*"[16] Megjithatë është e diskutueshme nëse Shqipëria po e përdor të gjithë potencialin e saj për të influencuar rajonin. Vizitat e fundit të autoriteteve shqiptare në Serbi dhe Maqedoni tregojnë rritjen e vëmendjes së Shqipërisë për çështjet rajonale.

Kontributi i Shqipërisë në Rajon

Që prej rënies së regjimit komunist, qeveritë shqiptare janë bazuar më së shumti në rolin e Shqipërisë si shtyllë strategjike e sigurisë, paqes dhe prosperitetit në Ballkan.[17] Politika e jashtme e Shqipërisë ka përsëritur dhe artikuluar në mënyrë të përsëritur gjatë dy dekadave të fundit qëllimin e saj për të forcuar rolin dhe kontributin e vendit si faktor me impakt rajonal për rritjen e sigurisë, garantimin e stabilitetit politik dhe rritjen ekonomike rajonale.[18] Për të

[14] Shih programin e MPEJ për rolin e Shqipërisë në rajon. http://www.punetejashtme.gov.al/en/mission/albania-in-the-region (parë për herë të fundit në datën 7/11/2017).
[15] Intervistë e Ministrit të Punëve të Jashtme Ditmir Bushati për Deutsche Welle 2014 http://www.dw.com/sq/bushati-procesi-i-berlinit-po-strukturohet-p%C3%ABrmes-instrumenteve-konkrete/a-18040654 (parë për herë të fundit në datën 5/11/2017)
[16] European Western Balkans. 2017. General Pavel: NATO to pursue open door policy. https://europeanwesternbalkans.com/2017/09/17/general-pavel-nato-pursue-open-door-policy/ (parë për herë të fundit në datën 5/11/2017)
[17] Roli i Shqipërisë si ofrues sigurie në rajon konfirmohet edhe nga intervistat me ekspertë të ndryshëm nga rajoni.
[18] Ministria e Punëve të Jashtme. Shqipëria në rajon. http://www.punetejashtme.gov.al/en/mission/albania-in-the-region (parë për herë të fundit në datën 18/11/2017).

arritur objektivat e politikës së jashtme janë përdorur disa qasje, nga marrëveshjet bilaterale me vendet e tjera të rajonit, deri tek pjesëmarrja dhe nxitja e bashkëpunimit shumëpalësh rajonal, shpeshherë nën ombrellën e Bashkimit Evropian.

Një prej sfidave kryesore me të cilat përballet Shqipëria në rajon është situata e shqiptarëve etnikë në shtetet e ndryshme të rajonit, nga Serbia në Malin e Zi dhe Maqedoni.[19] Pavarësisht kapaciteteve të dobëta të vendit pas përfundimit të regjimit komunist, ekspertët besojnë se ai ka qenë përgjithësisht i suksesshëm në shmangien e përpjekjeve për të destabilizuar rajon nga një këndvështrim sigurie. Shqipëria ka arritur të ofrojë disa perspektiva alternative të ruajtjes së paqes dhe sigurisë në rajon, veçanërisht nëpërmjet integrimit në NATO dhe bashkëpunimit substancial me organizatat ndërkombëtare të dedikuara ndaj sigurisë dhe bashkëpunimit. Integrimi i Shqipërisë në NATO konsiderohet arritja më e madhe për të konsoliduar rolin e vendit si lider në rajon dhe faktor i rëndësishëm për të siguruar paqen. Megjithatë, kriza e brendshme politike dhe stagnacioni socio-ekonomik, kanë frenuar përpjekjet e integrimit evropian dhe mund të konsiderohen një prej dështimeve të qeverive të njëpasnjëshme të vendit për të shfrytëzuar potencialin e tij të plotë.[20]

Qeveria aktuale e Shqipërisë ka përcaktuar tre objektiva/akse të politikës së jashtme të Shqipërisë në rajon dhe përtej tij. Së pari, në qendër të misionit të saj është mbrojtja e interesave kombëtare, parandalimi i konfliktit dhe kontributi në garantimin e stabilitetit demokratik të rajonit.[21] Ndërsa integrimi evropian dhe bashkëpunimi me Shtetet e Bashkuara rezultojnë akset qendrore të politikës aktuale të jashtme dhe të sigurisë së Shqipërisë, ajo fokusohet gjithashtu në objektivin e vendit për t'u shndërruar në model frymëzimi për bashkëpunimin në rajon si dhe tek përpjekjet për të përmirësuar e thelluar bashkëpunimin ekonomik me vendet e rajonit. Si vend anëtar i NATO-s, qeveria shqiptare e konsideron veten një aktor që nxit dhe mbështet proceset e integrimit të vendeve të tjera dhe tregohet garantuese e ruajtjes dhe konsolidimit të paqes e stabilitetit të rajonit.[22]

Ekstremizmi i dhunshëm është një prej sfidave të shumta të përbashkëta të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Grupet ekstremiste që janë zhvilluar në rajon me kalimin e viteve janë integruar më së miri me njëri-tjetrin.[23] Pavarësisht kësaj, gjatë etapës fillestare të shfaqjes së fenomenit (sidomos gjatë viteve 2012-2014) në nivel rajonal është vërejtur një numër i kufizuar përpjekjesh të harmonizimit dhe koordinimit të qasjeve për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin fetar. Megjithatë në rajonin e Ballkanit ekzistojnë një numër mekanizmash dhe partneritetesh rajonale, ndonëse shumica e tyre nuk janë iniciuar nga vendet e rajonit. Këto përfshijnë Bashkëpunimin Ekonomik të Detit të Zi, Iniciativën Adriatiko-Joniane, Iniciativën e Evropës Qendrore, Procesin e Bashkëpunimit të Evropës

[19] Intervistë me Baki Rexhepi, Gazetar, Kosovë.
[20] Intervistë me ekspertët Ragmi Mustafa dhe Shaip Kamberi.
[21] Zyra e Kryeministrit. 2017. Politika e Jashtme. https://kryeministria.al/al/programi/shqiperia-evropiane-ne-rajon-dhe-ne-bote/politikat-e-jashtme (parë për herë të fundit në datën 20/11/2017).
[22] *Po aty.*
[23] Hide, Enri (2017). Emerging Security Issues: Countering Violent Extremism. Center of Excellence. Albanian Ministry of Foreign Affairs, Tirana, Albania.

Juglindore dhe Këshillin e Bashkëpunimit Rajonal.[24] Një prej iniciativave më të rëndësishme që lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm, është Deklarata për Iniciativën e Bashkëpunimit Policor, që ka si objektiv luftën kundër terrorizmit dhe është nënshkruar nga Shqipëria, Sllovenia, Serbia, Mali i Zi, Austria dhe Bosnjë-Hercegovina.[25] Në nivel dypalësh, Shqipëria ka nënshkruar një sërë marrëveshjesh me shtetet e rajonit, si marrëveshja me Bosnjë-Hercegovinën në vitin 2010, marrëveshja me Maqedoninë në vitin 2005 dhe me Serbinë në 2010.

Marrëdhëniet Dypalëshe dhe Bashkëpunimi në Fushën e Sigurisë

Shqipëria dhe Maqedonia: Rreth një e katërta e popullsisë së Maqedonisë përbëhet nga shqiptarët, çka bën që influenca e Shqipërisë në një periudhë krize të fortë politike dhe tensionesh etnike në Maqedoni, të ketë implikime në zhvillimet e brendshme dhe politikën e jashtme të Maqedonisë. Kjo mund të vërehet edhe në një numër akuzash gjatë vitit 2017 për përfshirjen e Shqipërisë në punët e brendshme të vendit. Në mars të vitit 2017, zyrtarë të Maqedonisë pretenduan se Shqipëria po përpiqej të promovonte axhendën e saj të politikës së jashtme, duke nxitur ndryshimet kushtetuese në Maqedoni, duke e njohur gjuhën shqipe si gjuhën e dytë zyrtare të vendit. Gjatë periudhës së sipërpërmendur, media raportoi se partitë politike shqiptare të Maqedonisë, të mbështetura nga Tirana zyrtare, paraqitën kushtet paraprake të hyrjes në cilindo koalicion qeveritar. Rusia, një aktor tjetër i përfshirë gjatë kësaj periudhe, do të argumentonte se Bashkimi Evropian po mbështet "Platformën Shqiptare" dhe po luante një rol të dëmshëm në garantimin e stabilitetit të rajonit.[26] Sipas Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, një çështje kyçe shqetësuese është gjendja e të drejtave të njeriut, të shqiptarëve që jetojnë në Maqedoni. Qëndrimi zyrtar shqiptar është se pavarësisht nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit, ka mungesa të theksuara të barazisë së të drejtave midis qytetarëve shqiptarë dhe maqedonas të Maqedonisë. Veçanërisht shqetësues është progresi i ngadaltë në garantimin e respektimit të përdorimit zyrtar të gjuhës shqipe, flamurit kombëtar shqiptar, punësimit dhe shërbimeve sociale.[27] Mbulimi i Shqipërisë në mediat maqedonase është sa interesant aq dhe i pazakontë. Rasti i Maqedonisë është i veçantë për shkak se shumica e mbulimit mediatik të shqiptarëve lidhet me zgjedhjet lokale në vend. Roli i partive politike në koalicionet post-zgjedhore në vend ka qenë në qendër të vëmendjes mediatike. Gjithashtu, një pjesë e mbulimit të Shqipërisë lidhet me rastet kur ka raportime për

[24] CODEXTER (2014, November). *Profiles of Counter-Terrorist Capacity: Albania*. Council of Europe, f. 1.
[25] Misioni i Përhershëm i Republikës së Shqipërisë në Organizatat Ndërkombëtare. Vjenë. (22 Maj 2014). *Notë Verbale*. Nr. Prot. 304. http://www.osce.org/fsc/119814?download=true (parë për here të fundit në datën 12/07/2016).
[26] Zëri i Amerikës. (Mars 2017). Presidenti i Maqedonisë paralajmëron për kërcënimin e sovranitetit të vendit nga Shqipëria. https://www.voanews.com/a/macedonian-president-warns-of-albanian-threat-to-sovereignty/3754238.html (parë për herë të fundit më 10/11/2017); Euractiv. (Mars 2017). Shqipëria paralajmëron Maqedoninë të mos i japë krizës ngjyrim etnik. http://www.euractiv.com/section/elections/news/albania-warns-macedonia-not-to-bring-ethnic-twist-to-crisis/ (parë për here të fundit më 10/11/2017).
[27] Ministria e Punëve të Jashtme e Shqipërisë Marrëdhëniet me Vendet e Rajonit. http://www.punetejashtme.gov.al/al/misioni/shqiperia-ne-rajon/marredheniet-me-vendet-e-rajonit (parë për herë të fundit më 10/11/2017).

ngjarje të rëndësishme në Shqipëri, me impakt apo dimension edhe rajonal, si kriza politike dhe bojkotet e herëpashershme të proceseve politike e institucionale.

Pavarësisht ngjarjeve të fundit, Shqipëria dhe Maqedonia kanë ndërtuar një bashkëpunim intensiv në fushën e sigurisë. Që prej vitit 2000, midis dy vendeve janë nënshkruar të paktën shtatë marrëveshje vetëm në sektorin e sigurisë. Në vitin 2000 ministrat e brendshëm të të dy vendeve nënshkruan një protokoll kundër emigracionit të jashtëligjshëm. Protokolli do të kontribuonte në përmirësimin e koordinimit të politikave të emigracionit dhe në përpjekjet kundër emigracionit të jashtëligjshëm në të dy anët e kufirit. Pas krizës së vitit 2001 në Maqedoni, ku Ushtria Çlirimtare Kombëtare u përplas me Forcat e Sigurisë të Maqedonisë, qeveria shqiptare dhe ajo maqedonase nënshkruan një memorandum mirëkuptimi për të vijuar dhe përparuar bashkëpunimin dhe kontaktet midis dy ministrive të mbrojtjes. Bashkëpunimi midis dy vendeve u forcua edhe në kuadrin e luftës së përbashkët kundër terrorizmit. Përpjekjet e para për të luftuar terrorizmin dhe krimin e organizuar u konkretizuan në vitin 2004, kur dy qeveritë nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi. Qëllimi i marrëveshjes ishte intensifikimi i bashkëpunimit në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafiqeve të jashtëligjshme, trafikut ndërkombëtar të drogës, emigracionit të jashtëligjshëm dhe aktiviteteve të tjera të jashtëligjshme. Për të intensifikuar përpjekjet kundër trafikimit të qenieve njerëzore përgjatë kufijve të dy vendeve në vitin 2006 u nënshkrua një Protokoll shtesë, i cili do të plotësonte marrëveshjen e mëparshme. Objektivi specifik i tij do të ishte intensifikimi i bashkëpunimit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore përgjatë kufirit. Ky intensifikim i raporteve institucionale në nivelin e politikës së jashtme dypalëshe dëshmon se reciprociteti ka prodhuar një shkallë të lartë ndërvarësie. Kjo ndërvarësi, e ndërthurur dhe me elementë të tjerë si integrimi i Shqipërisë në NATO, ka potencialin të prodhojë një inerci afatgjatë bashkëpunimi midis këtyre dy vendeve në rajon. Një vit më pas u nënshkruan edhe dy marrëveshje të tjera që përfshinin Shqipërinë, Maqedoninë dhe vende të tjera të NATO-s, për të zhvilluar stërvitje të përbashkëta ushtarake dhe për bashkëpunim ushtarak në fushën e shkencës dhe teknologjisë. Këto marrëveshje kishin si synim të asistonin Shqipërinë dhe Maqedoninë në përmbushjen e standardeve të NATO-s, duke i përgatitur këto vende për anëtarësimin e ardhshëm në aleancë. Në të njëjtën fushë u nënshkrua më vonë një memorandum i dytë mirëkuptimi midis ministrive të mbrojtjes së të dy vendeve. Qëllimi i këtij memorandumi ishte rritja e bashkëpunimit dhe vullneti i të dy vendeve për të arritur paqen dhe prosperitetin në rajon përmes shkëmbimit të ekspertëve të të dy vendeve.

Shqipëria dhe Kosova: Shqipëria dhe Kosova janë dy vendet e rajonit që kanë zhvilluar bashkëpunimin më intensiv mes tyre në fushën e sigurisë. Veç aspekteve politiko-strategjike të këtij bashkëpunimi, të dyja vendet kanë nënshkruar nëntë marrëveshje bashkëpunimi në kuadër të forcimit të sigurisë, mbrojtjes, politikës së jashtme, mbrojtjes ndërkufitare, luftës kundër trafiqeve të jashtëligjshme, terrorizmit, etj. Të gjitha institucionet publike që operojnë në fushat e sigurisë dhe të politikës së jashtme kanë nënshkruar marrëveshje themeltare me njëri-tjetrin që prej shpalljes së pavarësisë së Kosovës, me qëllim përmirësimin e koordinimit midis dy vendeve dhe adresimin e sfidave të përbashkëta të sigurisë. Këto përfshijnë

marrëveshjet e bashkëpunimit dhe operacionet e përbashkëta midis ministrive të punëve të jashtme, ministrive të mbrojtjes dhe ministrive të punëve të brendshme. Në vitin 2009, qeveritë e Shqipërisë dhe të Kosovës nënshkruan një marrëveshje për bashkëpunimin policor ndërkufitar, e cila synonte të lehtësonte dhe të rriste efikasitetin e kontrolleve kufitare për të luftuar trafiqet e jashtëligjshme. Kjo marrëveshje u parapri nga një protokoll bashkëpunimi që i hapi rrugë koordinimit dhe bashkëpunimit midis dy vendeve në politikën e jashtme dhe të sigurisë. Bashkëpunimi ndërkufitar midis dy vendeve ka qenë në fokus të politikës së jashtme të tyre, siç provohet nga numri shumë i madh i marrëveshjeve të nënshkruara midis ministrive të punëve të brendshme. Në vitin 2012, patrullat e përbashkëta ndërkufitare hapën rrugën për kontrollin efikas të kufirit dhe për rritjen e sigurisë kufitare midis dy vendeve. Ndërkohë, kësaj qasjeje iu shtua edhe dimensioni i bashkëpunimit ushtarak, i cili u konsolidua me marrëveshjen midis Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe Forcave të Sigurisë të Kosovës. Kjo marrëveshje rregulloi procedurat e hyrje-daljes dhe rezidencës së përkohshme në territorin e secilit shtet.

Bashkëpunimi dhe koordinimi midis dy vendeve është intensifikuar gjatë viteve të fundit dhe vazhdon të ofrojë një shembull të influencës së Shqipërisë jashtë kufijve të saj. Në vitin 2014, ministria e mbrojtjes e Shqipërisë dhe ministria e forcës së sigurisë të Kosovës, nënshkruan një protokoll mbi bashkëpunimin në fushën e arsimimit dhe trajnimit ushtarak. Kjo siguroi një tërësi fushash koordinimi si: asistencë dhe ekspertizë në fushën ligjore, e nevojshme për anëtarësimin në NATO dhe në iniciativat rajonale, si dhe vlerësime të përbashkëta të mjedisit rajonal të sigurisë. Njëkohësisht dy vendet kanë intensifikuar bashkëpunimin në fushën e sigurisë duke e zgjeruar atë në ndërtimin e strukturave të përbashkëta të arsimimit dhe trajnimit, si dhe të shkollave të përbashkëta të përgatitjes së personelit të sigurisë. Nga pikëpamja e bashkëpunimit në sektorin e sigurisë dhe si reagim aktiv ndaj kërcënimeve të sigurisë publike, të dy vendet nënshkruan në vitin 2015 një Marrëveshje në fushën e sigurisë që synonte të përmirësonte më tej nivelin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë, bashkëpunimin në fushën e rendit publik dhe kërcënimeve publike të sigurisë. Marrëveshja ka për qëllim kryesor ofrimin e asistencës së ndërsjellë në parandalimin dhe zbulimin e krimeve si dhe kërkime të përbashkëta për individët që kanë kryer krime në të dy anët e kufirit. Një fushë tjetër bashkëpunimi dhe koordinimi përfshin sigurinë kibernetike. Në vitin 2016, Shqipëria dhe Kosova nënshkruan një Marrëveshje Bashkëpunimi që synon bashkëpunimin në fushën e sigurisë kibernetike dhe parandalimin e sulmeve të mundshme. Kryesisht marrëveshja lejon bashkëpunimin e thelluar të njësive të sigurisë kompjuterike dhe agjencive të luftës kundër krimeve kibernetike për reagimin dhe parandalimin ndaj sulmeve të mundshme. Kjo marrëveshje lejon agjencitë e sigurisë kibernetike në të dy vendet të bllokojnë sistemet e informacionit duke rritur nivelin e mbrojtjes nga sulmet kibernetike që po shndërrohen në një prej sfidave më të mprehta të sigurisë për shtetet kombe në epokën bashkëkohore dhe një ndër instrumentet më të preferuar të disa fuqive të mëdha, si Rusia.

Sa i takon mbulimit të Shqipërisë në mediat e Kosovës, situata ndryshon radikalisht krahasuar me vendet e tjera. Kjo mund t'i atribuohet disa faktorëve, si historia, kultura dhe gjuha e përbashkët, të gjithë pjesë të identitetit shqiptar në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Gjithashtu mbulimi mediatik në Kosovë lidhet me interesin publik për proceset politiko-

shoqërore në Shqipëri, ndonëse vërehet intensifikimi i mbulimit mediatik për çështje me rëndësi ekonomike ose etnike. Artikujt në mediat kosovare janë kryesisht neutrale, duke u fokusuar kryesisht në raportimin dhe analizën e ngjarjeve të përditshme.

Përmes këtyre proceseve të bashkëpunimit intensiv institucional dhe politik në sektorët e politikës së jashtme dhe të sigurisë, Shqipëria dhe Kosova po shndërrohen gradualisht në një partneritet strategjik solid. Ky partneritet po ndërton gradualisht një prej akseve gjeopolitikë fondamentalë të Ballkanit Perëndimor, pavarësisht sfidave të shumta të bashkëpunimit midis tyre në politikën e jashtme, të cilat lidhen herë pas here edhe me interesat e politikës së brendshme.

Shqipëria dhe Mali i Zi: Gjatë dy viteve të fundit, qeveria shqiptare ka ndërmarrë një sërë iniciativash dhe përpjekjesh për të rritur rolin dhe ndikimin e saj midis minoritetit të shqiptarëve etnikë të Malit të Zi. Kjo kurbë e përpjekjeve për të ndikuar në faktorin shqiptar të Malit të Zi arriti kulmin në vitin 2016, përpara zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare të Malit të Zi, kur tre partitë kryesore të shqiptarëve në vend u dakordësuan për të formuar një koalicion që do të rriste përfaqësimin e tyre parlamentar dhe do të intensifikonte përpjekjet për garantimin e të drejtave të minoritetit shqiptar. Ministri i punëve të jashtme të Shqipërisë e ngriti zyrtarisht këtë çështje në vëmendje të homologut malazez, ndërsa kjo çështje u riaktivizua gjatë një takimi të nivelit të lartë midis kryeministrit të Shqipërisë dhe homologut malazez. Për të rritur forcën e tyre përfaqësuese, partitë shqiptare u angazhuan të punonin së bashku dhe nënshkruan një marrëveshje më 26 nëntor 2016. Gjatë vitit 2017, qeveria shqiptare ndërmjetësoi një marrëveshje midis katër partive shqiptare në një qytet me shumicë shqiptare që është aktualisht pjesë administrative e kryeqytetit.[28]

Nga pikëpamja gjeopolitike, Mali i Zi është praktikisht vendi më i ri anëtar i NATO-s, ndonëse rrugëtimi drejt këtij statusi hasi jo pak pengesa dhe kundërshti, sidomos nga një pjesë e partive politike dhe ndërhyrja e Rusisë në proces, deri dhe përpjekjet e dështuara për grusht shteti. Gjithashtu procesi i integrimit të Malit të Zi në Bashkimin Evropian është një vlerë e shtuar e tablosë gjeostrategjike të rajonit të Ballkanit Perëndimor. Për shkak të veçorive gjeopolitike të Malit të Zi, rëndësia e tij strategjike është rritur vitet e fundit, duke rritur edhe interesin e Shqipërisë për të zhvilluar më shumë fusha bashkëpunimi.

Nga pikëpamja e determinizmit gjeografik, kufiri i përbashkët i Shqipërisë me Malin e Zi ka intensifikuar bashkëpunimin midis dy vendeve. Në fushën e bashkëpunimit ndërkufitar, ministritë e punëve të brendshme të të dy vendeve nënshkruan në vitin 2008 një marrëveshje të patrullimi të përbashkët për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore, trafiqet e drogave, emigracionin e paligjshëm dhe aktivitete të tjera të jashtëligjshme në të dy shtetet. Një vit më vonë u nënshkrua një protokoll i ngjashëm midis dy vendeve për iniciativa të përbashkëta në pikën kufitare Muriqan-Subokin. Protokolli adreson kryesisht trafikun e drogës dhe të qenieve njerëzore, duke u materializuar me kontrolle të përbashkëta në pikat kufitare.

[28] Mejdini, Fatjona. 2017. Tirana ndërmjetëson për të unifikuar qëndrimin e partive politike shqiptare të Malit të Zi. http://www.balkaninsight.com/en/article/ethnic-albanians-in-montenegro-together-to-win-tuzi-10-31-2017 (parë për herë të fundit më 10/11/2017).

Në fushën e mbrojtjes së të dhënave, të dy vendet kanë nënshkruar një deklaratë bashkëpunimi midis Komisionerit të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë të Mbrojtjes së të Dhënave Personale të Malit të Zi. Deklarata e nënshkruar në vitin 2011 synonte të krijonte struktura të përbashkëta të ndarjes së informacionit që lidhet me sigurinë kombëtare dhe me ruajtjen e sekretit për këto lloj informacionesh. Kjo marrëveshje u krijoi të dy vendeve mundësi për të çuar bashkëpunimin mes tyre në nivel më të lartë, për sa kohë do të ndajnë me njëri-tjetrin të dhëna sensitive. Për më tepër, në kuadër të NATO-s, ministritë e mbrojtjes së të dy vendeve nënshkruan një marrëveshje teknike për të nisur bashkëpunimin midis dy vendeve për procesin e çaktivizimit të municioneve të papërdorura.

Sa i takon mbulimit mediatik, mediat malazeze fokusohen kryesisht tek marrëdhëniet me Kosovën. Shumica e artikujve të analizuar për këtë studim janë analiza të zhvillimeve të fundit dhe deklarata të përfaqësuesve të lartë. Një vëmendje e lartë e mediave malazeze lidhet gjithashtu me procesin e integrimit në Bashkimin Evropian të vendeve të rajonit, si dhe krahasimet me etapat dhe sfidat e procesit për Malin e Zi. Një numër më i vogël artikujsh mediatikë fokusohen në probleme si krimi i organizuar apo kapja e shtetit nga interesa të grupeve të mëdha kriminale. Përgjithësisht artikujt mbulojnë çështjet ndërkufitare të lidhura me zonën e Shkodrës. Shqiptarët përbëjnë afërsisht 5% të popullsisë së Malit të Zi, por kanë pasur rëndësi kritike dhe rol vendimtar në disa zhvillime politike, veçanërisht gjatë referendumit të pavarësisë nga Serbia dhe në mbështetjen e koalicionit për t'u integruar në NATO dhe Bashkimin Evropian, gjë e cila sipas kryeministrit të Shqipërisë dëshmonte se shqiptarët e kanë shpëtuar Malin e Zi të paktën dy herë në historinë e tij bashkëkohore.[29]

Shqipëria dhe Serbia: Shqipëria dhe Serbia janë padyshim protagonistët gjeopolitikë në Ballkanin Perëndimor. Të dyja vendet kanë pasur rol vendimtar në proceset politike rajonale dhe kanë qenë antagonistë gjatë dekadave që pasuan rënien e komunizmit. Dy vendet kanë bërë kohët e fundit përpjekje thelbësore në disa fronte të politikës së tyre të jashtme për të kapërcyer të kaluarën dhe për të përmirësuar marrëdhëniet në disa fronte. Por kjo nuk do të thotë se interesat e tyre gjeopolitike përkojnë medoemos me njëra-tjetrën, sidomos për çështjen e Kosovës, rolit të Shqipërisë dhe shqiptarëve në rajon, apo edhe perceptimit të ndryshëm për rëndësinë e NATO-s dhe projektimin e saj gjeostrategjik në rajon. Përpjekjet e bashkëpunimit janë nxitur e mbështetur më tej nga Procesi i Berlinit, i cili njeh dhe pranon se normalizimi i marrëdhënieve midis Shqipërisë dhe Serbisë ka rëndësi kyçe për ruajtjen e stabilitetit të rajonit. Çka është më e rëndësishme, të dyja vendet kanë kuptuar kufizimet e politikave nacionaliste, ndërsa Shqipëria ka ndërmarrë një sërë hapash përtej marrëdhënieve klasike të fqinjësisë së mirë në rajon.[30]

[29] Tanjug. 2017. Kryeministri shqiptar shpjegon si shqiptarët "e kanë shpëtuar dy here Malin e Zi". https://www.b92.net/eng/news/region.php?yyyy=2017&mm=04&dd=12&nav_id=101007 (parë për here të fundit më 10/11/2017).

[30] Sokol Lleshi. 2015. Bashkëpunimi rajonal. Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare. http://www.aiis-albania.org/sites/default/files/Regional%20Cooperation.pdf (parë për herë të fundit më 12/11/2017).

Pavarësisht intensifikimit të përpjekjeve për të forcuar dhe rimëkëmbur marrëdhëniet midis dy vendeve, vëmendja është fokusuar kryesisht në fusha më pak sensitive krahasuar me sfidat dhe kërcënimet rajonale të sigurisë. Në politikën e saj të jashtme me Serbinë, Shqipëria ka ndjekur vitet e fundit qasjen e bazuar në "masat e ndërtimit të besimit", duke u përpjekur të identifikojë interesat e përbashkëta për të ashtuquajturat "politika të ulëta" (të cilat shërbejnë për të krijuar një klimë besimi mes aktorëve të politikës së jashtme që kanë qenë më parë antagonistë ose kundërshtarë me njëri-tjetrin), përpara se të përparojë në çështjet e "politikave të larta", që hasin dhe kundërshtitë më të mëdha mes palëve. Kështu, në vitin 2010, të dy vendet u përfshinë për herë të parë në marrëveshje dypalëshe në fushën e sigurisë. Në mars të vitit 2010, Shqipëria dhe Serbia nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi në fushën e krimit të organizuar, trafiqeve ndërkombëtare të drogës dhe terrorizmit ndërkombëtar. Marrëveshja fokusohet në bashkëpunimin më të ngushtë dhe koordinimin dypalësh për të luftuar krimin e organizuar, trafiqet dhe terrorizmin, si një mënyrë për të zhvilluar kontributin e dy vendeve në luftën kundër terrorizmit ndërkombëtar dhe në fuqizimin e përpjekjeve për të siguruar paqen dhe stabilitetin në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Një tjetër protokoll i bashkëpunimit midis ministrive të punëve të jashtme të të dy vendeve, synonte të arrinte komunikim më efikas institucional për të përgatitur terrenin dhe klimën mes dy vendeve për mundësi të tjera bashkëpunimi në të ardhmen. Ndonëse këto mund të mos jenë të mjaftueshëm, ato shënojnë një moment të qartë kthese nga politikat e ngurta armiqësore të së kaluarës. Marrëdhëniet mes dy vendeve janë përkeqësuar gjatë dhe pas viteve 1990-të dhe Luftës në Kosovë, duke rritur shkallën e përplasjes mes dy aktorëve më të rëndësishëm gjeopolitikë të Ballkanit Perëndimor. Ky nivel armiqësie duke qartë dhe në vizitat e nivelit të lartë mes dy vendeve. Vetëm në vitin 2004 ministri i punëve të jashtme i Serbisë dhe Malit të Zi Vuk Drashkoviç realizoi vizitën e parë zyrtare në Shqipëri që prej vitit 1948, e cila u pasua në vitin 2005 nga vizita në Serbi e ministrit shqiptar të punëve të jashtme.[31] Ndërsa reciprociteti në nivel vizitash të përfaqësuesve më të lartë të dy shteteve u ndërpre sërish pas deklaratës së pavarësisë së Kosovës, përpjekjet për të lënë pas krahëve historinë e vështirë dhe të kuptuarit e rolit të aktorëve kyç gjeopolitikë për të dy vendet ka marrë epërsi gjatë viteve të kaluara, siç dëshmojnë vizita e kryeministrit shqiptar në Beograd (nëntor 2014) dhe ajo e Vuçiç në Tiranë (maj 2015).

Mbulimi mediatik i Shqipërisë në Serbi ka qenë përgjithësisht negativ apo neutral në rastin më të mirë. Shumica dërrmuese e mbulimit mediatik lidhet me Kosovën dhe rolin e Shqipërisë në rajon si mbështetëse dhe promovuese e pavarësisë së Kosovës. Media serbe e trajton Shqipërinë kryesisht si ndërmjetës, veçanërisht gjatë periudhës së parë të pavarësimit të Kosovës. Artikujt që i dedikohen në mënyrë specifike Shqipërisë të marrë në shqyrtim për këtë studim lidheshin me vizitat bilaterale të kryeministrave të dy vendeve, e sidomos me ngjarjet që pasuan ndeshjen e futbollit midis ekipeve kombëtare. Tendenca e vizibilitetit të Shqipërisë në mediat serbe rezulton në rritje, kurse çështja e Kosovës më neutrale, ndërsa tashmë bisedimet mes Kosovës dhe Serbisë kanë hyrë në një etapë të re.

[31] International Security and Affairs Center. 2011. Serbia and Albania: Preparing for a new start. Policy Paper. https://www.isac-fund.org/download/sr-al-ENG.pdf (parë për herë të fundit më 12/11/2017).

Rruga Drejt të Ardhmes: 'Lider i Rajonit'

Në dekadat që pasuan fundin e komunizmit, Shqipëria ka shënuar progres të konsiderueshëm në njohjen e saj si aktor i rëndësishëm gjeopolitik në politikat rajonale të Ballkanit Perëndimor. Padyshim që faktorizimi gjeopolitik është forcuar sidomos pas anëtarësimit në NATO në vitin 2009, duke transformuar ambiciet e vendit për të shërbyer si garantues stabiliteti dhe sigurie në rajon. Angazhimi më i madh nëpërmjet iniciativave rajonale dhe rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit me vendet e tjera të rajonit, ka krijuar më shumë incentiva për një rol më të madh gjeostrategjik të Shqipërisë në Ballkanin Perëndimor.

Shqipëria është në një pozicion unik për ta pretenduar këtë rol dhe për të përdorur instrumentet dhe mekanizmat e politikës së jashtme në dispozicion për të arritur këto objektiva. Siç rezulton nga analiza krahasimore e programeve të politikës së jashtme të qeverive shqiptare ndër vite, akset kryesore të politikës së jashtme përfshijnë shndërrimin në lider në rajonin e Ballkanit Perëndimor, jo vetëm për të mbrojtur interesat dhe të drejtat e shqiptarëve të shpërndarë në vendet fqinje, por edhe për t'u shndërruar në faktor paqeje dhe stabiliteti në një rajon me histori të trazuar. Gjithsesi Shqipëria nuk ka arritur potencialin e saj të plotë të shndërrimit në aktor vendimtar dhe ndërmjetës për zgjidhjen e problematikave të rajonit. Siç sugjeron analiza e ofruar në këtë studim, influenca e saj në rajon në tërësi dhe në vendet specifike të tij, mbetet ende e kufizuar. Shumë mundësi janë humbur gjatë dekadave të kaluara, ku dy ndër shkaqet kryesore rezultojnë destabiliteti i brendshëm politik dhe udhëkryqet e shumta të politikës së brendshme, të cilat e kanë penguar vendin të shpalosë dhe arrijë ambiciet e tij në arenën ndërkombëtare. Për më tepër, performanca ekonomike para dhe pas krizës financiare globale ia ka vështirësuar vendit përdorimin e diplomacisë ekonomike, si mjet që mund të garantojë përparësi dhe pozitë më të favorshme krahasuar me vendet e tjera të rajonit.

Prania e shqiptarëve etnikë në shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor duhet të shërbente si instrument i rëndësishëm i politikës së jashtme. Por për shumë vite shqiptarët në Serbi, Malin e Zi dhe Maqedoni nuk kanë patur vëmendjen e duhur në strategjinë e politikës së jashtme shqiptare. Vetëm vitet e fundit zyrtarët e politikës së jashtme kanë artikuluar një qasje të integruar politike në mbrojtje të të drejtave shqiptarëve në rajon. Por rritja e interesimit të politikës së jashtme për mbrojtjen e këtyre të drejtave duhet të përballet me nevojën për të shërbyer si burim stabiliteti – prandaj arritja e ekuilibrit të duhur në këtë drejtim do të forconte pozitën e vendit në rajon.

Gjithashtu, pavarësisht se gjatë viteve të fundit Shqipëria ka ndërmarrë një sërë përpjekjesh për të rritur bashkëpunimin bilateral me vendet e rajonit në fushat e ndryshme të sigurisë, strukturat ekzistuese nuk mjaftojnë për t'i dhënë Shqipërisë rolin gjeopolitik të ofruesit kyç të sigurisë në rajon. Një dimension i politikës së jashtme të Shqipërisë që ka nevojë substanciale të forcohet është diplomacia ekonomike, e cila e ndërthurur me pozitën e anëtarit të NATO-s, duhen shfrytëzuar për të përmirësuar pozitën e vendit në rajon dhe artikulimin më të mirë të interesave të tij.

Së fundi, nga pikëpamja gjeopolitike, politika ballkanike do të vijojë të shpalosë dy akse me interesa që jo gjithmonë përputhen, serbët dhe shqiptarët, ndonëse tashmë kanë filluar të

shfaqen embrionet e para të bashkëpunimit, të nxitur edhe nga Procesi i Berlinit dhe dinamika e integrimit në Bashkimin Evropian. Historia e antagonizmit dhe armiqësisë midis këtyre dy vendeve i ka shndërruar ata në aktorë kyç të ruajtjes së paqes dhe stabilitetit në rajon. Duke pranuar këtë, të dy vendet kanë intensifikuar bashkëpunimin e nivelit të lartë dhe kanë marrë lidershipin e zhvillimeve në Ballkanin Perëndimor. Ndonëse Shqipëria ka humbur shumë shanse historike gjatë periudhës së tranzicionit post-komunist, momentumi i krijuar nga anëtarësimi në NATO dhe Procesi i Berlinit kanë ofruar një shans unik për materializimin e ambicieve të Shqipërisë në rajon si faktor stabiliteti.

NDIKIMI EKONOMIK I POLITIKAVE TË SHQIPËRISË NDAJ SHQIPTARËVE NË TË GJITHË RAJONIN E BALLKANIT PERËNDIMOR

Klodjan RAMA

Situata ekonomike në vendet e Ballkanit Perendimor ka pësuar një përmirësim të vazhdueshëm përgjatë viteve. Sipas një raporti të Bankës Botërore, ekonomitë në këtë rajon po përjetojnë një rritje të vazhdueshme përafërisht me 2.6% në 2017, ndërsa prespektiva e rritjes duket optimiste veçanërisht për Shqipërinë, Kosovën dhe Malin e Zi falë projekteve të mëdha të financuara nga investimet e huaja direkte (IHD), rikuperimit të konsumit privat apo edhe eksportetmë të larta sikurse është rasti i Kosovës.[32]

Proceset e integrimit evropian kanë luajtur një rol të rëndësishëm në përçimin e stimujve pozitivë dhe krijimin e kushteve të favorshme nëpërmjet një kuadri ligjor funksional. Të gjitha ekonomitë e rajonit veprojnë tani nën kushtet e një tregu të lirë me më pak kufizime dhe barriera tregtare. Marrëdhëniet tregtare janë rregulluar në kuadrin e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore[33] dhe nga marrëveshje të ndryshme shumëpalëshe dhe dypalëshe midis vendeve. Megjithëse shkëmbimet ekonomike në përgjithësi janë intensifikuar, mbetet akoma shumë për t'u bërë për sa i përket volumeve tregtare. Për shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor, partnerët kryesorë ekonomikë dhe tregtarë janë jashtë rajonit, pavarësisht faktit se shumë prej këtyre vendeve kanë lidhje të ngushta kulturore dhe sociale me njëri-tjetrin, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes pakicave që jetojnë në vendet përkatëse.

Ky rast vlen edhe për Shqipërinë. Detyrimet e Shqipërisë ndaj të gjithë shqiptarëve janë sanksionuar në preambulën e kushtetutës shqiptare. Të gjitha qeveritë në të gjithë spektrin

[32] World Bank (2017), Job Creation Picks Up, Western Balkans Regular Economic Report, No.12. http://documents.worldbank.org/curated/en/477511510774559876/pdf/121417-WP-PUBLIC.pdf.

[33]CEFTA është një marrëveshje tregtare nënshkruar në 2006 ndërmjet Shqipërisë, Bosnje dhe Herzegovinës, Kroacisë, Bulgarisë, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë, Moldovisë, Romanisëdhe Serbisë. Bulgaria, Romania dhe me vonë Kroacia kanë dalë nga marrëveshja me hyrjen e tyre në BEnë 2007 dhe 2013, respektivisht.

politik kanë premtuar vazhdimisht mbështetje në të gjitha fushat e jetës, përfshirë këtu edhe aspektet ekonomike. Sidoqoftë, sa e prekshme ka qenë kjo mbështetje dhe nëse shqiptarët që jetojnë në vendet fqinje kanë përfituar në të vërtetënuk mund të thuhet me siguri. Me përjashtim të Kosovës ku shqiptarët përbëjnë shumicën e popullsisë, analiza e ndikimit të politikave ekonomike të Shqipërisë ndaj shqiptarëve që jetojnë në vendet fqinje është një sfidë më vete dhe e vështirë për shkak të madhësisë së këtyre komuniteteve dhe integrimit të tyre ekonomik në ekonomitë e vendeve përkatëse. Si rrjedhojë, do të ishte e nevojshme të shqyrtojmë marrëdhëniet tregtare ndërmjet këtyre vendeve në tërësi dhe të nxjerrim në pah ato aspekte që janë të përshtatshme për analizën ekonomike. Fokusi do të jetë tek treguesit kryesorë makroekonomikë siç janë eksportet, importet, volumet e tregtisë dhe bilanci tregtar, tregtia sipas grupeve të mallrave, si dhe investimet direkte, numri i bizneseve dhe numri i vizitorëve që hyjnë në Shqipëri. Këta tregues do të ndihmojnë në analizimin e trendeve të shkëmbimeve ekonomike përgjatë viteve dhe të evidentojnë sa të jetë e mundur përfituesit e këtyre shkëmbimeve tregtare. Duke u fokusuar në volumet e tregtisë sipas grupeve të mallrave dhe duke analizuar aktivitetet ekonomike në zonat e dominuara nga komunitetet shqiptare, mund të vlerësohen ndikimet e mundshme në mirëqënien e tyre. Investimet e huaja direkte në vendet përkatëse janë gjithashtu një tregues i rëndësishëm që tregon interesin e Shqipërisë për të investuar në vendet ku jetojnë shqiptarët.Gjithashtu një tjetër aspekt për tu patur në konsideratëështë edhe numri i bizneseve që e kanë origjinën e tyre nga këto vende. Vlen për tu theksuar se pjesa më e madhe e të dhënave të bizneseve që operojnë në Shqipëri janë të huaja, ndërkohë ishte mjaft e vështirë të grumbulloje të dhëna për bizneset shqiptare në vendet e tjera. Sidoqoftë, edhe pse këto tregues makroekonomik na mundësojnë një paraqitje të përgjithshme rreth marrëdhënieve tregtare mes këtyre vendeve, si dhe impaktin indirekt të politikave ekonomike në komunitetet shqiptare, si fillim do ishte e nevojshme të bëhej një paraqitje e përgjithshme e kuadrit ligjor dhe institucional që rregullon këto marrëdhënie ekonomike. Në këtë mënyrë do jemi në gjendje të kuptojmë nëse dhe si politikat ekonomike të Shqipërisë janë drejtuar për tek komunitet shqiptare si brenda dhe jashtë kufijve shtetëror.

Kuadri institucional dhe marrëveshjet tregtare mes Shqipërisë dhe vendeve fqinje ku banojnë shqiptarët do të diskutohet në seksionin pasardhës i cili do të paraqesë një analizë të marrëdhënieve tregtare mes Kosovës dhe Shqipërisë, një pasqyrë të marrëdhënieve tregtare mes Shqipërisë dhe Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë, respektivisht. Në fund, punimi do të mbyllet me disa përfundime përmbledhëse.

Kuadri Institucional dhe Marrëveshjet Ekonomike

Marrëdhëniet eknomike, por jo vetëm, mes vendeve të marra në studim rregullohen nëpërmjet një strukture institucionale që përshkon nivele të ndryshme të vendim-marrjes, nga OBT deri në nivelin kombëtar, madje edhe deri në nivel lokal. Për më tepër, proceset e integrimit evropian i kanë shtuar dhe më tepër kompleksitetin në të kuptuarit e ndikimit që ka kuadri institucional në rregullimin e marrëdhënieve ekonomike. Shumë marrëdhënie ekonomike janë të rregulluara nëpërmjet kuadrit institucional të Bashkimit Evropian (Acquis

Communautaire) të cilin e kanë apo janë duke e adoptuar vendet që aspirojnë të bëhen anëtare të BE. Si rezultat, bëhet edhe më i vështirë veçimi i politikave ekonomike që adresojnë apo shënjestrojnë komunitetet shqiptare.

Siç u përmend dhe më lart, marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare të Shqipërisë me vendet e Ballkanit Perëndimor janë të rregulluara nëpërmjet CEFTA-s, e cila është nënshkruar në vitin 2006 si dhe nëpërmjet marrëveshjeve bilaterale mes vendeve respektive. Veçanërisht me Kosovën, Shqipëria ka nënshkruar marrëveshje të shumta dhe ka një strukturë institucionale diverse. Një nga marrëveshjet kryesore mes Shqipërisë dhe Kosovës është Marrëveshja Kuadër "Për nxitjen dhe lehtësimin e tregtisë" nënshkruar më 11.01.2014 dhe hyrë në fuqi më 11 Mars 2015. Kjo marrëveshje adreson disa nga çështjet më të debatuara në lidhje me tregtinë e produkteve bujqësore dhe sigurisë ushqimore të cilat kanë qenë në fokus të disa mosmarrëveshjeve tregtare mes dy vendeve. Qeveritë e të dyja vendeve vazhdojnë me premtimet në lidhje me intensifikim dhe rritjen e shkëmbimeve ekonomike në të dyja anët e kufirit. Në maj të vitit 2016, qeveritë e Shqipërisë dhe Kosovës nënshkruan një marrëveshje për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjelltë të investimeve.[34] Gjithashtu, edhe më përpara janë lidhur një llojshmëri marrëveshjesh të tjera sektorale që variojnënga bashkëpunimi i ndërsjelltë në fushën e industrisë, tregtisë dhe standartizimit,[35] tek marrëveshje teknike siç janë marrëveshja për shmangien e tatimit të dyfishtë lidhur me tatimet dhe mbi të ardhurat mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal" nënshkruar më 28.3.2014 dhe hyrë në fuqi nëMars 2015,[36] apo marrëveshja mbi bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellë për çështjet doganore e vitit 2009.[37] Marrëveshje të tjera janë nënshkruar gjithashtu në fushat e turizmit,[38] infrastrukturës,[39] informacionit të klasifikuar,[40] si dhe të veterenarisë,[41] dhe standarteve.[42]

I gjithë ky kuadër legjislativ ka përgatitur terrenin për të rregulluar pjesën më të madhe të marrëdhënieve tregtare dhe marrëveshjeve sektorale, por zbatimi i tyre në praktikë shpesh ka ndeshur vështirësi të ndryshme.[43] Për më tepër, nëse analizojmë politikat ekonomike që mund të ndikojnë pozitivisht në ekonominë e përgjithshme të familjeve kosovare nuk egziston

[34]Marrëveshja e nxitjes dhe mbrojtjes së ndërsjelltë të investimeve, nënshkruar më 3 maj 2016.
[35]"Marrëveshja ndërministrore për bashkëpunim në fushën e Industrisë, Tregtisë dhe Standardizimit", nënshkruar më 30.09.2010.
[36]Marrëveshja "Për shmangien e tatimit të dyfishtë lidhur me tatimet dhe mbi të ardhurat mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal" nënshkruar më 28.3.2014 dhe hyrë në fuqi më 11 Mars 2015
[37] "Marrëveshja mbi bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellë, në çështjet doganore" të vitit 2009.
[38]"Marrëveshja për Bashkëpunim në Fushën e Turizmit" mes MTI & Ministria e Turizmit Kulturës Rinisë dhe Sporteve të Shqipërisë nënshkruar më 09.05.2006.
[39]"Memorandumi i Mirëkuptimit për hapjen e bashkëpunimit në infrastrukturën e cilësisë mes MTI & METE, nënshkruar më 06.02.2007
[40]Marrëveshja "Për shkëmbimin dhe mbrojtjen e ndërsjelltë të informacionit të klasifikuar, nënshkruar më 07.11.2012 dhe ratifikuar me ligj nr. 5/2013, datë 25.02.2013
[41] Marrëveshja "Për bashkëpunimin në fushën e veterinarisë, nënshkruar më 16.11.2012 dhe miratuar në parim me VKM-në nr. 947, datë 26.12.2012
[42]Memorandum Mirëkuptimi" mes MTI-Departamentit të Metrologjisë së Kosovës dhe Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë të Shqipërisë, nënshkruar më 26.11.2012
[43] Lawrence, Z.R., Frasheri, E., and Qazi, M. (2014). Integration in the Balkans: Albania and Kosovo. Report in the frame of the Economic Growth in Albania Project at the Center for International Development at Harvard University. Cambridge M.A. USA.

ndonjë politikë e veçantë që të privilegjojë një bashkëpunim më të ngushtë me Kosovën.[44] Një nga të paktat iniciativa ligjore që mund të konsiderohen se shenjëstrojnë komunitetet shqiptare në Kosovë, si dhe në Serbi, në sensin e njohjes së një statusi të privilegjuar në raport me shtetasit e huaj është Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 2655, of 2014 "Për përjashtimin e shtetasve të Republikës së Kosovës dhe shtetasve shqiptar të Republikës së Serbisë nga detyrimi për t'u pajisur me leje pune dhe çertifikatë të regjistrimit të punësimit". Përfshirjet e tjera direkte të qeverisë shqiptare në raport me shtetasit shqiptar që jetojnë në vendet fqinje të ballkanit kanë qenë në formën e ndihmës (edhe pse shumë e vogël) siç ka qenë rasti i ndihmës për martenitetin e Preshevës në Serbi me vlerë 50,000 Euro, apo 150,000 Euro si ndihmës për lehtësimin nga përmbytja në rastin e Maqedonisë.[45] Në lidhje me Maqedoninë, rishikimi i kuadrit institucional tregon një bashkëpunim të hershëm por të përgjithshëm. Ashtu si në rastin e Kosovës, qeveritë e dy vendeve janë angazhuar për nxitjen dhe mbrojtjen e ndërsjelltë të investimeve[46] bazuar në bashkëpunimin reciprok ekonomik[47]. Për sa i përket legjislacionit specific dhe sektoral, bashkëpunimi varion nga ai teknologjik, teknik dhe shkencor[48], tek shmangia e taksimit të dyfishtë mbi të ardhurat dhe kapitalin[49], si dhe tek bashkëpunimi në sektorin e turizmit.[50] Përveç bashkëpunimit në sektorin e turizmit i cili supozohet se mund të ketë ndikuar drejtpërdrejtë në disa komunitete shqiptare në Maqedoni, siç janë Ohri dhe Struga, pjesa tjetër e kuadrit ligjor është më tepër i një natyre të përgjithshme, dhe jo i drejtuar specifikisht ndaj komuniteteve shqiptare. Siç do vërehet në seksionet pasardhëse, shqiptarët në Maqedoni janë kryesisht të orientuar drejt bujqësisë dhe tregtisë me pakicë. Dhe si rezultat, ne thjesht mundemi të spekulojmë rreth një efekti potencial nga lart-poshtë (trickle-down) që rrjedh nga shkëmbimet e përgjithshme tregtare. Një pamje e ngjashme vërehet gjithashtu në rastin e Malit të Zi, ku disa nga marrëveshjet kryesore janë të fokusuara në bashkëpunimin ndër-institucional për standartet, akreditimin dhe metrologjinë,[51] bashkëpunimin në sektorin e turizmit, si dhe çështje specifike për bashkëpunimin në sektorin bankar, mjedisin dhe energjinë.[52]

Sidoqoftë, struktura institucionale dhe marrëveshjet e ndryshme të nënshkruara nga qeveritë respektive na paraqesin vetëm një pamje të përgjithshme të impaktit potencial të

---

[44] *Po aty.*

[45] See: Jano, D. (2017). Albanian International Development Policy and CSO Role in the EU Accession Perspectives. Policy paper, part of the project "Western Balkan CSOs for Global Development" financed by program of Official Development Aid of Slovakia, SlovakAid.

[46] Marrëveshje për mbrojtjen dhe nxitjen e ndërsjelltë të investimeve me Maqedoninë, 04.12.1997 në fuqi me 3.4.1998

[47] Protokoll mbi bashkëpunimin ekonomik midis Qeverisë Shqiptarë dhe Qeverisë Maqedone, 15.01.1998.

[48] Marrëveshje për bashkëpunimin shkencor, teknik dhe teknologjik midis Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisësë Maqedonisë, 01.06.1994.

[49] Marrëveshja ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Maqedone për shmangien e tatimeve të dyfishta, në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal, 02.11.1998

[50] Marrëveshje mbi bashkëpunimin në fushën e turizmit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, nënshkruar në Tiranë, në 16.11.2005, miratuar me vendimin nr.31, datë 18.1.2006, të Këshillit të Ministrave, hyrë në fuqi në 10.05.2006.

[51] Bashkëpunim ndër-institucional në fushën e standardeve, të akreditimit dhe metrologjisë ku palët kanë lidhur Marrëveshje të Bashkëpunimit institucional në vitin2009.

[52] Bashkëpunim në fushën energjetike për "ndërtimin e Linjës 400 kV Tiranë – Podgoricë".Projekti u financua nga KfW me një vlerë 43 million €.

politikave ekonomike. Analizimi praktik i shkëmbimeve tregtare dhe bashkëpunimit ekonomik do të na lejonte të kuptonim më mirë impaktin e politikave ekonomike egzistuese.

Marrëdhëniet Ekonomike

Shqipëri-Kosovë: Qeveritë e Shqipërisë dhe Kosovës janë angazhuar vazhdimisht për forcimin dhe intensifikimin e bashkëpunimit ekonomik midis dy vendeve. Një seri marrëveshjesh me fokus bashkëpunim ekonomik janë nënshkruar, duke filluar nga çështjet teknike të tilla si ndihma e ndërsjelltë në çështjet doganore e deri tek një partneritet më strategjik[53].Për sa i përket marrëdhënieve tregtare, Shqipëria dhe Kosova nuk kanë një marrëveshje specifike të tregtisë së lirë midis njëri-tjetrit, megjithëse janë bërë përparime në këtë drejtim përmes nënshkrimit të një protokolli "Për Zbatimin e Marrëveshjes Kuadër të arritur mes Këshillit të Ministrave tëRepublikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosovës për Bashkëpunimin në Nxitjen dhe Lehtësimin e Tregtisë" në mars të vitit 2015. Marrëdhëniet tregtare midis dy vendeve janë kryesisht të rregulluara sipas Marrëveshjes sëTregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) në të cilën Shqipëria dhe Kosova janë anëtare. Në vitin 2016, sipas zyrtarëve të Ministrisë së Financave të Shqipërisë, është nënshkruar një marrëveshje tjetër për mbrojtjen reciproke të investimeve, megjithëse kjo marrëveshje ende nuk është vënë në zbatim.

Megjithatë, pavarësisht nga përpjektjet dhe dokumentat e firmosura nga të dyja qeveritë, të dhënat tregojnë se volume dhe vlera e këtyre shkëmbimeve midis dy vende janë akoma të ulta dhe jotë qëndrueshme përgjatë viteve.Duke ju referuar Figurës 1, ka patur një rritje në volumin tregtar nga 2010-2015 me një luhatje të vogël në vitin 2013 dhe pas vitit 2015 ka një tendencë në rënie.

Figura 1 Marrëdhëniet ekonomike midis Shqipërisë dhe Kosovës (2010-Gusht 2017)



Burimi: INSTAT (2017); Shënim: Vlerat janë në miliona Euro

[53] Shih Sulçebe (2015) për një listë më të detajuar të marrveshjeve ekonomike midis Shqipërisë dhe Kosovës.

Ky trend vjen si pasojë e luhatjeve në eksportet e Shqipërisë në Kosovë, duke qenë se importet e Kosovës tregojnë një trend të qëndrueshëm gjatë viteve. Vlerat e treguesve kryesorë të tregtisë janë paraqitur më specifikisht në Tabelën 1. Siç tregohet, vlera më e lartë e vëllimeve tregtare është 192.7 milion Euro të regjistruara në vitin 2015. Volumi tregtar në vitin 2016 është 166 milionë euro, me një rënie prej rreth 14% krahasuar me 2015, për shkak të rritjes së eksporteve të Kosovës me 19% dhe rënies së importeve me 8%.

Tabela 1 Shkëmbimet tregtare të Shqipërisë me Kosovën 2010- 2016 (Mln Euro)

KOSOVA	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
EKSPORTET (E)	72.00	105.45	124.07	116.37	134.10	152.71	123.00
IMPORTET (I)	27.34	32.45	36.47	42.95	42.68	40.02	43.10
BILANCI TREGTAR (E-I)	44.66	73.00	87.60	73.42	91.42	112.69	79.90
VOLUMI TREGTAR (E+I)	99.34	137.90	160.54	159.32	176.78	192.73	166.10
MBULIMI TREGTAR (E/I) %	263%	325%	340%	271%	314%	382%	285%

Burimi: INSTAT

Shifrat tregojnë se Shqipëria është përfituesi kryesor nga marrëdhëniet tregtare me një bilanc tregtar pozitiv gjatë viteve. Megjithatë, kur merren parasysh eksportet në total të Kosovës, të dhënat tregojnë (Figura 2) se Shqipëria nuk është partneri kryesor tregtar.

Figura 2 Importet e Kosovës sipas vendeve të origjinës (2010-2015)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Serbia mbetet furnizuesi kryesor i mallrave në Kosovë, duke lënë pas Gjermaninë, Kinën, Maqedoninë dhe Shqipëria që ndodhet e pesta (Figura 3).

Figura 3 Eksportet e Kosovës sipas vendeve të origjinës (2010-2015)



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës

Megjithatë, sa i përket eksporteve, Shqipëria është një ndër vendet kryesore të destinacionit të mallrave të Kosovës. Peshën më të madhe e zënë grup produktet "lëkure dhe artikuj prej lëkure" me një rritje prej 643%, pasuar nga "prodhime druri dhe letre", me një rritje prej 130% dhe "makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi" me 64%. Mallrat e tjera nga 2015 në 2016 nuk kanë ndonjë ndryshim thelbësor (Tabela 2 dhe Tabela 3).

Tabela 2 Eksportet e Kosovës drejt Shqipërisë sipas grup mallrave (në Euro)

	2015	2016	2015 VS 2016 NDRYSHIMI NË %
USHQIM, PIJE, DUHAN	15,009,108	18,167,478	+21%
MINERALE, LËNDË DJEGËSE, ENER.ELEK	810,117	1,098,206	+36%
PRODUKTE KIMIKE DHE PLASTIKE	3,550,695	4,365,088	+23%
LËKURE DHE ARTIKUJ PREJ LËKURE	5,967	44,312	+643%
PRODHIME DRURI DHE LETRE	439,848	1,011,144	+130%
TEKSTILE DHE KËPUCË	241,641	198,690	-18%
MATERIALE NDËRTIMI DHE METALE	19,135,293	17,096,656	-11%
MAKINERI, PAJISJE DHE PJESË KËMBIMI	408,328	670,250	+64%
TË TJERA	419,688	450,732	+7%
TOTAL	**40,020,685**	**43,102,555**	**+8%**

Burimi: INSTAT

Tabela 3 Importet e Kosovës nga Shqipëria sipas grup mallrave (në Euro)

	2015	2016	2015 VS 2016 NDRYSHIMI NË%
USHQIM, PIJE, DUHAN	16,794,456	19,028,160	+13%
MINERALE, LËNDË DJEGËSE, ENER.ELEK	62,467,083	26,379,362	-58%
PRODUKTE KIMIKE DHE PLASTIKE	8,251,534	9,436,382	+14%
LËKURE DHE ARTIKUJ PREJ LËKURE	12,082	479	-96%
PRODHIME DRURI DHE LETRE	2,315,147	2,422,528	+5%
TEKSTILE DHE KËPUCË	592,245	703,284	+19%
MATERIALE NDËRTIMI DHE METALE	49,883,251	50,578,231	+1%
MAKINERI, PAJISJE DHE PJESË KËMBIMI	4,124,027	5,253,069	+27%
TË TJERA	8,266,877	9,195,629	+11%
TOTAL	**152,706,703**	**122,997,123**	**-19%**

Burimi: INSTAT

Rritja e volumit tregtar midis dy vendeve nga viti 2010 e në vazhdim ka ardhur si rezultat i përmirësimit të infrastrukturës rrugore të Shqipërisë, ku veçohet autostrada Tiranë-Prishtinë, njohur ndryshe si ”Rruga e Kombit”, për të cilën qeveria shqiptare u investua fuqimisht si nga pikëpamja financiare ashtu edhe nga ajo politike.Ky investim madhor ka patur një ndikim ekonomik pozitiv duke sjellë kështu uljen e e kostove të transportit dhe rritjen e qarkullimit të mallrave dhe njerëzve në dy anët e kufirit. Ndërkohë janë realizuar edhe masa të tjera të cilat janë të natyrës teknike që kanë patur qëllim lehtësimin e këtij qarkullimi. Për shembull doganat, janë dakordësuar të krijojnë një sistem kontrolli në vetëm një pikë të kufirit për automjetet dhe kamionët e tonazhit të lartë. Gjithashtu procedrat për tranzitimin e mallrave të destinuara për Kosovën bëhen edhe në Portin e Durrësit duke mos patur më kontroll në pikat kufitare midis Shqipërisë dhe Kosovës[54]. Gjithashtu lëvizja e njerëzve vecanërsht nga Kosova drejt Shqipërisë ka patur një rritje përgjatë viteve. Sikurse tregohet në Tabelën 4, numri i shtetasve të Kosovës që kanë vizituar Shqipërinë ka qenë mbi 2 milion gjatë vitit 2016. Duhet theksuar se vizitorët nga Kosova përbëjnërreth 40 % fluksit të turistëve që udhëtojnë drejt Shqipërisë për qëllime turistike.

Tabela 4 Numri i vizitorëve drejt Shqipërisë

Vitet	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Vizitorët nga Kosova	1,179,300	1,439,700	1,708,700	1,378,100	1,379,200	1,682,000	2,157,000

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Turizmit (Shqipëri)

Megjithatë, përkundër përmirësimeve të përgjithshme në vëllimet e tregtare dhe procedurave teknike, ende ekzistojnë sfida dhe barriera, veçanërisht lidhur me produktet bujqësore. Një prej pengesave që u bë temë e debatit publik në të dy anët e kufirit ka të bëjë me miellin e grurit që vjen nga Kosova. Ministria e Bujqësisë e Shqipërisë lëshoi një udhëzim në vitin 2015[55] për përcaktimin e standardeve të cilësisë dhe sigurisë së miellit të grurit, në të cilin kërkohej që nivelet e proteinave të miellit të grurit të jenë 12.5%. Ky udhëzim u kundërshtua ashpër nga qeveria kosovare dhe gjithashtu nga prodhuesit e miellit të Kosovës. Pala kosovare e sheh këtë si barrierë tregtare duke argumentuar se shumë vende të BE-së kanë një standard më të ulët në nivelet e proteinave, ndërkohë që disa vende të tjera nuk kanë nivele të përcaktuara fare. Përkundër kontestimit nga qeveria e Kosovës, kjo rregullore është ende në fuqi. Marrëdhëniet e tensionuara tregtare, veçanërisht të lidhura me produktet bujqësore reflektohen në të dyja anët pasi autoritetet e Kosovës bllokuan importin e vezëve të një prodhuesi shqiptar me argumente anti-dumping. Një element tjetër që konsiderohet se ka një ndikim negativ në tregtinë dhe marrëdhëniet ekonomike me Kosovën ka të bëjë me përdorimin e çmimeve të referencës, një praktikë e cila është në kundërshtim me rregullat e OBT-së. Duke ju referuar prodhimeve bujqësore, eksportet e patates nga Kosova janë për shembull subjekt i rritjes së çmimeve referuese.

Një aspekt tjetër që duhet marrë parasysh gjatë analizimit të ndikimeve të politikave ekonomike të Shqipërisë është vëllimi i investimeve të huaja të direkte (IHD) që janë

[54] Shiko gjithashtu Lawrence et al. (2014). Integrimi në Ballkan. Shqipëria dhe Kosova. Raport i përgatitur nga Qëndra Ndërkombëtare e Zhvillimit nëpërmjet projektit Rritja Ekonomike në Shqipëri.

[55] UDHËZIMNr. 207, datë 31.3.2015 “për përcaktimin e treguesve të sigurisë dhe të cilësisë së miellit të grurit të parapaketuar, për t'u shitur tek konsumatori i fundit ose për prodhimin e produkteve të tjera ushqimore” http://80.78.70.231/pls/kuv/f?p=201:Udh%EBzim:207:31.03.2015

shkëmbyer midis dy vendeve, si dhe numri i bizneseve. Shqipëria duket si një nga investuesit kryesorë në Kosovë me IHD që përbëjnë rreth 13% të IHD-ve totale për 2016[56]duke arritur vlerën më të lartë në vitin 2015 me 40.1 milion Euro (Tabela 5). Shifrat sugjerojnë një rritje të përgjithshme të investimeve të huaja direkte nga viti 2007 në 2016, me përjashtim të vitit 2012. Megjithatë, është e vështirë të ndahet destinacioni sektorial i IHD-ve sipas vendit të origjinës, pasi ishte e vështirë të merren të dhëna për numrin dhe aktivitetin e bizneseve shqiptare në Kosovë. Sipas të dhënave nga Banka Qendrore e Kosovës për IHD-të sipas sektorëve, pjesa më e madhe e flukseve hyrëse për vitin 2016 janë investuar në "pasuri të paluajtshme, me qira dhe aktivitete të biznesit" me një vlerë prej 167 milionë eurosh, pasuar nga "ndërtimi" me 29.2 milionë euro dhe "Shërbime financiare" me 19 milionë Euro.[57]

Tabela 5 Stoku i investimeve të huaja direkte

Viti	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Shqipëria	3.4	21.9	23.3	20.3	11.2	4.7	19.3	20.4	40.1	28.6
Kosova	5	14	9	10	5	13	13	26	29	29

Burimi: Banka Qëndrore e Kosovës dhe Banka e Shqipërisë

Nga ana tjetër, IHD-të e Kosovës në Shqipëri janë pak më të larta sa i takon vitit 2016, edhe pse pesha e investimeve të Kosovës në ekonominë shqiptare është shumë më e ulët. Pavarësisht kësaj, prania e bizneseve kosovare në Shqipëri është e konsiderueshme. Sipas të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit të Shqipërisë (QKB), rreth 817 biznese nga Kosova janë regjistruar deri në shtator të vitit 2017, dhe operojnë në industri përpunimi, mallra, riparime të makinave, pajisje shtëpiake, hotele dhe restorante, transport dhe telekomunikacion, ndërtim etj.

Shqipëri-Maqedoni: Maqedonia është një tjetër vend ku jetojnë një numër i madh i shqiptarëve. Duke qenë kështu një partner i rëndësishëm rajonal ekonomik dhe politik për Shqipërinë. Ndryshe nga rasti i tregtisë dhe marrëdhënieve ekonomike me Kosovën, në të cilën ndikimi i politikave ekonomike të zbatuara nga qeveritë e shqiptare janë më të dukshme, në rastin e Maqedonisë këto ndikime janë më të vështira për t'u dalluar. Megjithatë, përmirësimi ose përkeqësimi i marrëdhënieve tregtare dhe ekonomike mes dy vendeve me siguri që do të kishte një ndikim edhe për shqiptarët që jetojnë në Maqedoni. Të dy vendet kanë një aspiratë të përbashkët për t'u bërë anëtarë të BE-së, gjë që kërkon nevojën për të forcuar bashkëpunimin e tyre ekonomik. Në këtë drejtim, Shqipëria dhe Maqedonia kanë nënshkruar disa marrëveshje ekonomike, ndërsa marrëdhëniet e tyre tregtare rregullohen në kuadrin e CEFTA-s. Shkëmbimet tregtare midis dy vendeve tregojnë një trend të përgjithshëm në rritje edhe pse Shqipëria ka një bilanc tregtar negativ. Vëllimet tregtare për vitin 2016 kanë qenë 106 milionë euro, duke shënuar një rënie të lehtë prej 3.6% nga viti 2015 (Figura 4 dhe Tabela 6). Ndërkohë bilanci tregtar është negativ përgjatë viteve, edhe pse hendeku po zvogëlohet.

[56]Banka Qëndrore e Kosovës http://www.bqk-kos.org/?id=55.
[57]*Po aty*.

Figura 4 Trendi i shkëmbimeve tregtare Shqipëri-Maqedoni (në mil. Euro)



Burimi: INSTAT

Tabela 6 Shkëmbimet tregtare midis Shqipërisë dhe Maqedonisë (në miliona Euro)

	2011	2012	2013	2014	2015	2016
EKSPORTET	30	30	31	38	47	48
IMPORTET	64	60	62	60	63	58
BILANCI TREGTAR	-34	-30	-31	-22	-16	-10
VOLUMI TREGTAR	94	90	93	98	110	106
RAPORTI I MBULIMIT (E/I) %	47%	50%	50%	63%	75%	83%

Burimi: INSTAT

Përsa i përket mallrave, grupi kryesor i produkteve që Shqipëria eksporton në Maqedoni janë "minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike", dhe "materiale ndërtimi dhe metale", respektivisht në vlera rreth 15 milionë euro dhe 17 milionë euro (Tabela 7).

Tabela 7 Eksportet shqiptare drejt Maqedonisë gjatë viteve 2011-2016 (në Euro)

Artikujt	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Ushqim, pije, duhan	2.986.893	3.420.063	4.445.318	5.046.091	5.667.946	6.079.133
Minerale, lëndë djegëse, ener.elek	11.576.999	9.524.018	11.018.829	15.174.840	14.701.762	14.641.326
Produkte kimike dhe plastike	214.379	352.852	1.009.621	1.052.252	1.165.691	1.739.514
Lëkure dhe artikuj prej lëkure	290.281	230.568	78.820	26.294	29.171	5.526
Prodhime druri dhe letre	540.440	1.500.166	1.802.284	1.404.484	1.345.914	1.603.960
Tekstile dhe këpucë	975.913	97.648	972.223	618.248	750.418	568.357
Materiale ndërtimi dhe metale	9.639.224	12.325.779	9.995.646	11.321.661	14.045.133	17.166.135
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	3.094.429	1.733.929	1.839.646	2.415.141	6.958.408	3.803.228
Të tjera	527.932	469.481	248.141	802.244	2.151.879	1.955.301

Burimi: INSTAT

Ndërkohë, sa i përket importeve, grupi kryesor i produkteve janë "ushqim, pije dhe duhan", "materiale ndërtimi dhe metale" dhe "produkte kimike dhe plastike", me vlera rreth 20 milionë euro, 14 milionë euro dhe 12 milion euro, përkatësisht (Tabela 8).

Tabela 8 Importet shqiptare nga Maqedonia gjatë viteve 2011-2016 (në Euro)

Artikujt	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Ushqim, pije, duhan	22.413.338	20.455.562	17.606.702	18.740.089	23.243.847	20.487.104
Minerale, lëndë djegëse, ener.elek	1.982.397	1.144.718	3.106.780	4.341.615	2.242.040	1.611.890
Produkte kimike dhe plastike	13.544.349	13.172.870	11.818.544	11.714.001	10.897.755	12.585.580
Lëkure dhe artikuj prej lëkure	99.361	35.335	307.110	3.528	130.340	5.066
Prodhime druri dhe letre	2.043.838	2.163.109	2.182.112	2.472.987	2.344.891	3.045.915
Tekstile dhe këpucë	295.874	234.518	653.121	417.351	357.351	392.796
Materiale ndërtimi dhe metale	19.467.275	19.156.251	21.960.304	18.280.516	19.194.223	14.161.047
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	3.507.857	2.722.263	3.404.556	3.223.177	3.640.975	4.521.914
Të tjera	547.038	664.780	431.589	446.403	557.970	705.661
Totali	**63.901.326**	**59.749.407**	**61.470.818**	**59.639.667**	**62.609.393**	**57.516.971**

Burimi: INSTAT

Këto shifra nuk tregojnë qartë se çfarë ndikimi ekonomik kanë shqiptarët ndaj këtyre vëllimeve tregtare. Sidoqoftë, kur bëhet fjalë për strukturën e biznesit në rajonet shqiptare në Maqedoni, si Ohri, Struga, Tetova, Gostivari, Kumanova dhe Dibra, aktivitetet kryesore ekonomike në këto zona janë aktivitetet e shitjes me pakicë dhe shërbimet të hotelerisë[58].Nga kjo mund të supozojmë se ndikimi i shkëmbimeve tregtare midis dy vendeve mund të ketë vetëm një ndikim modest tek shqiptarët në Maqedoni. Duke patur parasysh se është e vështirë të matet efektshmëria e ndikimit ekonomik , këto të dhëna tregojnë që politikat ekonomike të Shqipërisë nuk janë përgatitur sipas aktiviteteve ekonomike të shqiptarëve të Maqedonisë.

Ndërkohë, investimet në të dy vendet në formë të IHD-ve janë mjaft të ulëta, pavarësisht rritjes përgjatë viteve. Siç shihet në Tabelën 9, stoku i IHD-ve në Maqedoni është rritur nga 20 milionë euro në vitin 2013 në 42 milionë euro në vitin 2016. Gjithashtu, stoku i IHD-ve të Shqipërisëështë rritur gjatë viteve me një rënie të lehtë në vitin 2015, duke arritur në 39.6 milionë euro në 2016.

Tabela 9 Stoku i IHD-ve (në miliona Euro)

Viti	*2013*	*2014*	*2015*	*2016*
Maqedonia	20	22	36	42
Shqipëria	30.5	35.3	32.6	39.6

Burimi: Banka e Shqipërisë dhe Banka Kombëtare e Maqedonisë

Duke ju referuar numrit të bizneseve maqedonase në Shqipëri, të dhënat nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) tregojnë se ka rreth 351 biznese me kapital të vetëm dhe të përbashkët, që veprojnë në pothuajse të gjithë sektorët e ekonomisë. Një sektor tjetër i ekonomisë që ka dëshmuar një rritje gjatë viteve është turizmi. Siç shihet në Tabelën 10, numri i vizitorëve maqedonas është rritur nga rreth 430 mijë në 515 mijë në vitin 2015, duke e bërë atë grupin e tretë më të madh të vizitorëve sipas vendit. Sipas të dhënave zyrtare, një pjesë e madhe e këtij numri përbëhet nga shqiptarë të Maqedonisë.

[58] Subjekte aktive sipas sektorëve të veprimtarisë NKD Rev.2, sipas komunave, sipas viteve, gjendja më 31 dhjetor http://makstat.stat.gov.mk/PXWeb/pxweb/en/MakStat/MakStat__DelovniSubj__AktDelovniSubjekti/275_DelSub_Op_02AcDSbD_ang.px/?rxid=355a8e23-5795-43b1-a451-076dd5f31994

Tabela 10 Numri i turistëve që kanë vizituar Shqipërinë 2013-2015

Viti	2013	2014	2015
Vizitorët	432.646	514.459	515.130

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Turizmit (Shqipëri)

Aktivitetet ekonomike midis dy vendeve pritet të rriten edhe në të ardhmen pas përfundimit të projektit të ri rrugor të shpallur nga qeveria shqiptare e cila do të lidhë Tiranën me rajonin e Dibrës. Nga ky projekt ndër përfituesit kryesorë sa i përket shqiptarëve të Maqedonisë, do të jenë ata të rajonit të Dibrës së Madhe. Megjithatë, deri tani asnjë analizë e thelluar ekonomike e këtij projekti nuk është bërë publike.

Shqipëri - Mali i Zi: Mali i Zi është vendi më i vogël në Ballkanin Perëndimor me një popullsi afërsisht gjysëm milion banorë, ku shqiptarët etnikë përbëjnë rreth 5% të popullsisë ose rreth 30 mijë banorë. Edhe marrëdhëniet tregtare midis Shqipërisë dhe Malit të Zi, gjithashtu zhvillohen në kuadrin e CEFTA-s. Pavarësisht një rënie të lehtë në vitin 2012, vëllimet e tregtare ndërmjet dy vendeve kanë dëshmuar një trend në rritje përgjatë viteve, duke u llogaritur 52 milionë euro gjatë vitit 2016. Duke u shprehur në përqindje, vëllimi i tregtisë në vitin 2016 është rritur me 10% krahasuar me vitin 2015, eksportet janë rritur me 29%, ndërsa importet kanë rënë me 11.6% (Figura 5 dhe Tabela 11). Përveç vitit 2015, eksportet shqiptare janë rritur vazhdimisht. Gjithashtu bilanci tregtar ka peshuar më tepër në anën e Shqipërisë, pavarësisht një zvogëlimi gjatë viteve 2013-2015. Vlera më e lartë e eksporteve është regjistruar në vitin 2016 me rreth 32 milionë euro, ndërsa vlera më e madhe e importeve është regjistruar në vitin 2015.

Tabela 11 Marrëdhëniet tregtare midis Shqipërisë dhe Malit të Zi 2010 – 2016 (në miliona Euro)

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Eksportet (E)	8.98	12.11	12.81	22.66	25.14	24.63	32.42
Importet (I)	6.65	9.94	7.76	13.12	16.50	22.39	20.08
Bilanci tregtar (E-I)	2.33	2.17	5.05	9.54	8.64	2.24	12.34
Volumi tregtar (E+I)	15.63	22.05	20.57	35.78	41.64	47.02	52.50
Raporti I mbulimit (E/I) %	135%	122%	165%	173%	152%	110%	161%

Burimi: INSTAT

Figura 5 Marrëdhëniet tregtare midis Shqipërisë dhe Malit të Zi (në miliona Euro)



Burimi: INSTAT

Në vitin 2016, eksportet u rritën me 32%, në të cilën peshën më të madhe e zënë grupi i mallrave "Tekstile dhe këpucë" me 47%, "ushqim, pije dhe duhan" dhe "materiale ndërtimi dhe metale" me 41% minerale, lëndë djegëse, energji elektrike "me 33% (Tabela 12).

Tabela 12 Eksportet shqiptare sipas grup mallrave

	2015	2016	% change
Ushqim, pije, duhan	4,138,518	5,825,005	+41%
Minerale, lëndë djegëse, ener.elek	10,560,994	14,000,427	+33%
Produkte kimike dhe plastike	1,496,048	1,142,181	-24%
Lëkure dhe artikuj prej lëkure	-	-	0%
Prodhime druri dhe letre	358,136	332,047	-7%
Tekstile dhe këpucë	112,638	165,635	+47%
Materiale ndërtimi dhe metale	6,916,687	9,753,808	+41%
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	456,473	489,858	+7%
Të tjera	595,162	714,078	+20%
TOTALI	**24,634,655**	**32,423,040**	**+32%**

Burimi: INSTAT

Ndërkohë, gjatë vitit 2016, importet drejt Shqipërisë janë zvogëluar në 10%, në të cilën pjesa më e madhe është zënë nga "makineritë, pajisjet dhe pjesët e këmbimit" të grupeve të mallrave, me 157%, "prodhime druri dhe letre" me 84% produkte kimike dhe plastike "me 67% (Tabela 13).

Tabela 13 Importet shqiptare nga Mali i Zi sipas grup mallrave

	2015	2016	% change
Ushqim, pije, duhan	3,767,052	3,531,366	-6%
Minerale, lëndë djegëse, ener.elek	7,989,091	6,116,882	-23%
Produkte kimike dhe plastike	352,882	590,328	+67%
Lëkure dhe artikuj prej lëkure	14,910	4,744	-68%
Prodhime druri dhe letre	3,994,833	7,359,956	+84%
Tekstile dhe këpucë	94,322	15,568	-83%
Materiale ndërtimi dhe metale	5,976,227	2,000,038	-67%
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	149,805	385,234	+157%
Të tjera	49,040	77,551	+58%
TOTALI	**22,388,161**	**20,081,667**	**-10%**

Burimi: INSTAT 2017

Gjithashtu, edhe në rastin e Malit të Zi, është e vështirë të specifikosh ndikimin e këtyre marrëdhënieve tregtare tek shqiptarët etnikë. Investimet direkte në vendet përkatëse janë shumë të ulëta, me investimet malazeze të cilat zënë rreth 0.9 milion euro (Banka e Shqipërisë), ndërsa investimet direkte të Shqipërisë në Malin e Zi gjatë viteve të fundit nuk reflektohen në mënyrë nominale duke sugjeruar një vlerë shumë të ulët (Banka Qendrore e Malit të Zi). Megjithatë, në Shqipëri funksionojnë disa aktivitete ekonomike me kapital malazez. Sipas të dhënave të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), rreth 46 biznese me kapital malazez dhe të përbashkët janë regjistruar në Shqipëri që operojnë kryesisht në industrinë e përpunimit, hoteleri dhe restorante, tregti, transportit dhe telekomunikacionit si dhe pasuri të paluajtshme. Shpërndarja e tyre gjeografike është e përqendruar në Tiranë me rreth 50%,të tyre në Shkodër me rreth 40% dhe pjesa tjetër prej 10% në Fier, Durrës dhe Berat. Nga ana tjetër, të dhënat për bizneset me kapital shqiptarë ose të përbashkët në Malin e Zi nuk ishin në publikuara.

Përsa i përket sektorit të turizmit, numri i turistëve malazezë reflekton një trend në rritje. Siç shihet në Tabelën 14, numri i vizitorëve në vitin 2016 ishte rreth 325 mijë vizitorë. Gjatë 2013-2014, numri i vizitorëve nga ky vend u rrit me 37%, nga 2014-2015, ajo u rrit vetëm pak me 1%, ndërsa nga 2015-2016 numri i vizitorëve u rrit me 35%. Duke marrë parasysh numrin total të vizitorëve që udhëtojnë drejt Shqipërisë, turistët malazez janë grupi i pestë më i madh dukë përfshirë këtu edhe ata me origjinë shqiptare që përbëjnë pjesën më të madhe.

Tabela 14 Numri i vizitorëve nga Mali i Zi gjatë 2013-2016

Viti	**2013**	**2014**	**2015**	**2016**
Vizitorët	174,500	238,500	240,781	324,968

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Turizmit (Shqipëri)

Gjithashtu, në lidhje me të dhënat e shqiptarët që vizitojnë Malin e Zi, ato përsëri nuk ishin publike. Kështu që është e vështirë të konkludohet për ndikimin e politikave ekonomike të Shqipërisë ndaj shqiptarëve etnikë që jetojnë në vendet fqinje. Megjithatë, ajo që mund të thuhet me siguri është se shqiptarët në të dy vendet kanë akoma mundësi të pashfrytzuara për thelluar bashkëpunimin dhe zhvilluar ekonominë, veçanërisht në sektorin e turizmit. Shumica e shqiptarëve në Mal të Zi jetojnë përgjatë kufirit mes dy vendeve duke filluar me deltën e lumit Buna, në Ulqin përgjatë detit Adriatik, përreth Liqenit ttë Shkodrës dhe zonat malore, të cilat kanë një potencial të konsiderueshëm për zhvillimin e turizmit.

Shqipëri – Serbi: Serbia është një tjetër vend i rëndësishëm ku jetojnë shqiptarët etnikë, me një popullsi prej 7,058,322 banorësh, nga të cilët rreth 0,82% (rreth 70,000) janë me origjinë shqiptare. Marrëdhëniet ekonomike midis Shqipërisë dhe Serbisë janë përmirësuar krahasuar me fundin e viteve 90-të dhe fillimit të viteve 2000. Arsyet kryesore për këto zhvillime të reja mes dy vendeve mund t'i atribuohen kryesisht procesit të integrimit në BE. Shqipëria ashtu sikurse Serbia synojnë ti bashkohen familjes evropiane dhe kanë bërë përparim të dukshëm në marrdhëniet mes tyre në shumë fusha, veçanërisht në kuadrin e bashkëpunimit ekonomik. Lëvizja e lirë e mallrave dhe e kapitalit është një nga parimet bazë të ekzistencës së BE-së siç përcaktohet në traktatet e BE-së.

Ashtu sikurse është përmendur më lart në këtë punim, Serbia është gjithashtu pjesë e marrëveshjes CEFTA, që do të thotë se shumica e marrëdhënieve ekonomike rregullohen sipas parimeve dhe kërkesave të kësaj marrëveshje. Gjithashtu, marrëdhëniet dypalëshe janë përmirësuar ndjeshëm, sidomos pas takimeve bilaterale mes dy qeverive dhe thirrjes së përbashkët të Kryeminsitrave të dyja vendeve për komunitetet përkatëse të biznesit që të investojnë dhe thellojnë bashkëpunimin mes tyre. Megjithëse Shqipëria dhe Serbia nuk kanë kufij të drejtpërdrejtë, vëllimi i tregtisë ndërmjet dy vendeve është i rëndësishëm. Duke ju referuar Tabelës 15 dhe Figurës 6, vëllimi i tregtisë për vitin 2017 ka qenë rreth 223 milionë euro, i cili duket dukshëm më i lartë se vëllimi i tregtisë me vendet e tjera fqinjë. Këto shifra janë rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit duke patur një diferencë të theksuar me ato të fillim viteve 2000.[59] Ska asnjë dyshim që përfituesi kryesor nga marrëdhëniet tregtare ekzistuese

[59] Të dhënat nga INSTAT tregojnë se importet dhe eksportet ndërmjet Shqipërisë dhe Serbisë deri në vitin 2006 ishin zero (www.instat.gov.al)

është Serbia, e cila rezulton me një suficit tregtar prej 151 milionë eurosh në 2017. Ndërkohë importet e Shqipërisë nga Serbia gjatë vitit 2017 arritën në 187 milionë euro, ndërsa përsa i përket eksporteteve, ato ishin vetëm 36 milionë euro duke konfirmuar kështu bilancin negativ tregtar, i cili qëndron si i tillë prej kohësh me Serbinë.

Figura 6 Marrëdhëniet tregtare midis Shqipërisë dhe Serbisë (në miliona Euro)



Burimi: INSTAT 2017

Tabela 15 Marrëdhëniet tregtare midis Shqipërisë dhe Serbisë (në miliona Euro)2010 – 2017

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
IMPORTET	133	147	175	114	177	155	135	187
EKSPORTET	14	27	12	17	12	24	35	36
BALANCA TREGTARE (E-I)	-118	-120	-162	-97	-165	-131	-100	-151
VOLUMI TREGTAR (E+I)	147	174	187	131	189	179	170	223
RAPORTI I MBULIMIT (E/I) %	11	18	7	15	7	15	26	19

Burimi: INSTAT 2017

Duke u fokusuar në mallra specifik do të vëmë re një trend në rritje gjatë viteve për shumicën e grupeve të mallrave (Tabela 16). Ndryshimi në totalin e importeve për grupet e mallrave nga 2010 në 2017 është 41%. Grupet e mallrave që përbëjnë pjesën më të madhe të importit të Shqipërisë nga Serbia janë "mineralet, lëndët djegëse dhe energjia elektrike" dhe "ushqimi, duhani dhe pijet". Ndërsa mallrat dominuese në grupin e mallrave "ushqim, duhan dhe pije" janë drithërat (gruri dhe misri)[60]. Serbia është një vend me peshë në tregun evropian të drithërave[61], duke përfshirë këtu edhe rajonin e Ballkanit Perëndimor, ku gruri i ardhur nga ky vend është furnizuesi kryesor për industrinë e prodhimit të brumërave dhe produktevetë pjekjes në Shqipëri. Përsa i përket grupit të mallrave "minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike", energjia elektrike është produkti kryesor i importuar nga Shqipëria, duke importuar dukshëm shumë herë më tepër se sa eksporton, sidomos gjatë periudhës së verës.

[60] Zyra e Statistikave të Republikës së Serbisë (www.stat.gov.rs)
[61] Për më shumë shih Djuric, I. (2014). Impact of policy measures on wheat-to-bread supply chain during the global commodity price peaks: the case of Serbia. Studies on the Agricultural and Food Sector in Transition Economies, Vol. 76, Halle (Saale): IAMO.

Tabela 16 Importet shqiptare nga Mali i Zi sipas grup mallrave (in 000 Euros)

	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
USHQIM, PIJE, DUHAN	26,21	20,93	21,73	35,71	46,93	50,48	56,96	50,89
MINERALE, LËNDË DJEGËSE, ENER.ELEK	34,01	49,10	106,34	31,99	73,16	56,96	38,82	69,61
PRODUKTE KIMIKE DHE PLASTIKE	9,767	11,22	10,39	14,51	14,91	15,14	14,77	17,25
LËKURE DHE ARTIKUJ PREJ LËKURE	2	5	0.749	3	0.121	98	212	170
PRODHIME DRURI DHE LETRE	2,422	2,730	4,370	4,286	4,075	5,280	4,750	5,031
TEKSTILE DHE KËPUCË	188	193	227	645	972	1,381	2,162	3,122
MATERIALE NDËRTIMI DHE METALE	55,696	58,678	28,752	22,030	32,698	20,269	11,593	34,487
MAKINERI, PAJISJE DHE PJESË KËMBIMI	3,572	3,492	2,339	3,768	3,929	5,414	5,610	6,076
TË TJERA	936	697	765	1,059	812	603	637	849
TOTAL	**132,8**	**147,1**	**174,9**	**114,0**	**177,5**	**155,7**	**135,5**	**187,5**

Source: INSTAT

Përsa i përket eksporteve të Shqipërisë drejt Serbisë, Tabela 17 tregon një rritje të rëndësishme në eksportet totale përgjatë viteve. Duke bërë përllogaritjet e ndryshimit të përqindjes së eksporteve të vitit 2010 me 2017, vërehet një rritje prej 147%. Rritja më e madhe është shënuar nga grupet e mallrave "ushqim, pije, duhan", "prodhime druri dhe artikuj prej letre" dhe "tekstile dhe këpucë".

Tabela 17 Eksportet shqiptare nga Mali i Zi sipas grup mallrave (in 000 Euros)

	2010	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**	**2016**	**2017**
USHQIM, PIJE, DUHAN	602	1,137	2,172	2,803	4,056	8,960	11,803	14,927
MINERALE, LËNDË DJEGËSE, ENER.ELEK	11,362	23,631	7,985	10,725	4,380	10,566	112	7,313
PRODUKTE KIMIKE DHE PLASTIKE	194	63	83	183	234	308	305	336
LËKURE DHE ARTIKUJ PREJ LËKURE	214	433	169	173	154	0.996	50	211
PRODHIME DRURI DHE LETRE	5	11	186	415	343	541	598	692
TEKSTILE DHE KËPUCË	413	579	476	607	885	1,715	6,054	11,415
MATERIALE NDËRTIMI DHE METALE	1,177	312	654	1,239	1,326	996	875	722
MAKINERI, PAJISJE DHE PJESË KËMBIMI	50	22	66	150	186	89	74	92
TË TJERA	613	788	561	555	494	857	537	543
TOTAL	**14,633**	**26,981**	**12,355**	**16,854**	**12,062**	**24,036**	**35,256**	**36,255**

Source: INSTAT

Duke patur ngjashmëri edhe me vendet e tjera, ndikimi i këtyre treguesve makro ekonomikë mbi shqiptarët që jetojnë në Serbi, nuk është i prekshëm drejtpërdrejtë mbi këto komunitete. Ndërkohë shifrat tregojnë se Serbia ndodhet në një pozicion më të favorshëm përsa i takon këtyre marrëdhënieve tregtare dhe është e vështirë të konkludohet nëse shqiptarët që jetojnë në këtë vend arrijnë përfitojnë ose jo drejtpërdrejt prej tyre.

Prioritet Politikave Sektroriale dhe ato Lokale

Marrëdhëniet ekonomike të Shqipërisë me vendet e tjera të Ballkanit Perendimor tregojnë një përmirësim gjatë viteve, duke patur një rritje të volumeve të tregtisë si në vlerë ashtu edhe në sasi. Shqipëria ka një bilanc tregtar pozitiv me Kosovën dhe Malin e Zi, por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për Serbinë dhe Maqedoninë. Ndërkohë lëvizja e njerëzve është gjithashtu

më e lartë në krahasim me vitet e mëparshme, kjo falë investimeve në infrastrukturën kryesore rrugore. Vlen të përmendet fakti se Investimet e Huaja Direkte të Shqipërisë zënë një pozitë të rëndësishme dhe luajnë një rol pozitiv për ekonominë e Kosovës. Një tjetër aspekt është edhe kuadri institucional, i cili është bërë më bashkëpunues për shkak të proceseve të integrimit në BE dhe si rezultat, janë nënshkruar disa marrëveshje rajonale, shumëpalëshe dhe dypalëshe që mbulojnë një gamë të gjerë fushash.

Megjithatë, të gjitha këto përmirësime janë shumë të përgjithshme dhe nuk na lejojnë të nxjerrim konkluzione të detajuara mbi ndikimin e tyre në komunitetet shqiptare kudo ato jetojnë. Vlen për tu përmendur se sektori kryesor në të cilin përfshihen shqiptarët brenda dhe jashtë kufijve zyrtarë është bujqësia. Rrjedhimisht lind nevoja e përgatitjes së një politike të qartë e cila do të mund të adresojë siç duhet sfidat e këtij sektori, dhe të lërë pas kontestimet dhe çështjet e ngritura sikurse janë ato me Kosovën. Ekziston një tendencë për të drejtuar dhe orientuar mbështetjen që vjen nga institucionet qëndrore, shpesh pa kuptuar nevojat e vërteta të komuniteteve lokale shqiptare. Përveç Kosovës, komunitetet e tjera shqiptare kanë një bashkëveprim më intensiv ndërkufitar me komunitetet lokale që jetojnë brenda Shqipërisë që nuk e kalon gjeogrfikisht krahinën në të cilën ata janë rezident. Për këtë arsye, mund të jetë më efektive që hartimi i politikave ekonomike që marrin parasysh kontekstin lokal. Një hap i rëndësishëm do të ishte investimi në përmirësimin e infrastrukturës ndërkufitare duke eliminuar pengesat institucionale dhe fizike që ekzistojnë. Kjo do të lejonte një ndërveprim më intensiv ekonomik dhe social. Duke patur parasysh procesin e integrimit në BE, bashkëpunimi ndërkufitar dhe iniciativat e ndryshme marrin një rëndësi të dorës së parë për të përfituar nga skemat e mbështetjes së BE dhe mundësive të tjera që ofron bashkëpunimi rajonal.

NDIKIMI I SHQIPËRISË NË RAJON NË KULTURË, ARSIM, MEDIA DHE SPORT

Ben ANDONI

Shqipëria bën pjesë në shtetet e vogla të Ballkanit, ku diplomacia kulturore dhe aksesorët e saj luajnë një rol të rëndësishëm për të rritur ndikimin e vendit dhe për të shtrirë statusin ndërkombëtar të përfaqësimit. Në rastin e Shqipërisë, kur flitet për Ballkanin, ky koncept merr një rëndësi të dorës së parë, për shkak se shumica e vendeve nga të cilat rrethohet, janë me popullsi shqiptare. Në të shkuarën e afërt, pra para periudhës demokratike, Tirana ka qenë një qendër kulturore virtuale, por që mori atribute direkte në vitet ’70, me marrëdhënien zyrtare e cila u ngrit zyrtarisht me ish-Federatën Jugosllave, sa i përket bashkëpunimit kulturor-arsimor-sportiv. Atëbotë, impakti i Tiranës ishte tejet i madh në praktikë, por më pak institucionalisht pasi shqiptarët e Republikave ish-Jugosllave dhe ish-Krahinës Autonome të Kosovës i referoheshin gjithësisht Tiranës, sa i përket kulturës dhe aspekteve të ndryshme të jetës në qarqet e tyre. Shqipëria këtë impakt e realizoi me propagandën e saj mediatike direkte, me emetimet radiofonike dhe programet televizive por edhe ato indirekte drejt vendeve të Perëndimit, nga ku shqiptarët që jetonin atje por me origjinë prej hapësirës së ish-Jugosllavisë e përcollën në qytetet dhe shoqërinë e kohës kosovare. Nga kjo propagandë, Shqipëria nuk përcolli vetëm kulturën, por edhe agjitacionin për mëvetësinë e Kosovës. Shumë nga aktorët politikë të asaj kohe, e kanë konfirmuar këtë ndikim, që u bë nëpërmjet një diplomacie kulturore të fshehur.[62]

Diplomacia kulturore e Tiranës zyrtare është artikuluar gjithnjë e më shumë në vitet e fundit. Në konceptin, nga ku rrjedh kuptimi për diplomacinë, gjejmë dhe vendin e diplomacisë kulturore. Për këtë i referohemi Konventës së Vjenës për Marrëdhëniet Konsullore në vitin 1963. Aty përcaktohen qartësisht marrëdhëniet diplomatike ndërmjet

[62] Begolli, Abdullah (2015), Ish-student i atyre viteve “Vitet (70-81), Univerziteti i Prishtinës dhe lufta e drejtëpërdrejtë Shqipëri-Serbi për Kosovën”, Albania Press, 25 Prill, http://www.albaniapress.com/lajme/21146/Vitet-70-81-Univerziteti-i-Prishtines-dhe-lufta-e-drejteperdrejte-Shqiperi-Serbi-per-Kosoven.html.

shteteve, specifikohen privilegjet dhe imunitetet e diplomatëve, etj.[63] Qartësisht kjo konventë është guri themelor për diplomacinë dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Në një nga format dhe llojet e diplomacisë që kanë evoluar, është edhe Diplomacia Kulturore. Kjo e fundit, ka marrë një vlerësim kohët e fundit, nga madhësia e dokumenteve, që janë nënshkruar realisht me të gjitha vendet fqinje.[64] Shpallja e pavarësisë së Kosovës në vitin 2008, ndryshoi shumë ekuilibra, sa i përket zhvillimeve gjeopolitike në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Qysh në vitet e para të pasluftës, kur Kosova kishte statusin e një protektorati ndërkombëtar, të dy vendet shprehën gatishmërinë e tyre, që jo vetëm të bashkëpunonin por edhe të asistonin në marrëdhënie të qëndrueshme bilaterale në shumë fusha të përbashkëta. Ndërkohë, ndikimi i Tiranës u rrit disi ndryshe në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, qysh pas Marrëveshjes së Ohrit, falë dhe një zyre rezidente të një televizioni kombëtar. Sa i përket Republikës së fundit të pavarur në Ballkan, Malit të Zi, ndikimi erdhi përmes bashkëpunimit direkt dhe pak shkëmbimeve. Në Kosovë, ndikimi i Tiranës është rritur falë institucionalizimit të marrëdhënieve dhe nënshkrimit të një sërë dokumentesh të vazhdueshëm. Më së shumti, mbledhjeve të përbashkëta të qeverive, ku takimi i fundit i Korçës ishte i katërti në radhë, mes dy qeverive. Në praktikë, impakti i Tiranës zyrtare deri pak kohë më parë ishte më i madh, falë një aksesi të tërë të medias private shqiptare. Fatkeqësisht, kjo përpjekje e medias u shua rreth vitit 2016 dhe sot, Kosova e Maqedonia, më pak Mal i Zi dhe shumë më larg Lugina e Preshevës, nuk janë prezentë më si më parë për publikun shqipfolës. Njësoj edhe në Shqipëri, ku lajmet mediatike për Kosovën, janë gjithnjë e më të pakta, përveç rasteve të krizave politike dhe ngjarjeve të jashtëzakonshme. Media, megjithatë, ka luajtur një ndikim të madh për përcjelljen e Shqipërisë dhe anasjelltas, porse në muajt e fundit, humbja e interesit po e zbeh këtë marrëdhënie të vyer.

Është e vërtetë se në vitet e fundit ka bashkëpunime dhe përpjekje, madje promovimi i kulturës kombëtare dhe mbështetja kulturore e shqiptarëve jashtë vendit përbën detyrim kushtetues, por deri më sot në programet e qeverive nuk kemi asnjë strategji mirëfilli apo zbatim praktik të këtij detyrimi. Në ministritë e lidhura direkt me kulturën dhe diplomacinë publike, atë të Punëve të Jashtme, të Kulturës dhe të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, nuk ka në organikën e tyre strukturë të posaçme dhe të specializuar për Diplomacinë Kulturore.[65] Është shumë e vështirë të gjesh referenca për buxhetin, në këto ministri ku punohet për Diplomacinë Kulturore, përkatësisht për arsimin në diasporë dhe promovimin kulturor jashtë vendit. Mbi të gjitha, në Shqipëri mungon bashkëveprimi ndërinstitucional për Diplomacinë Kulturore dhe përfaqësitë tona diplomatike, jo vetëm që nuk kanë mundësitë njerëzore dhe financiare në organizimin e veprimtarive kulturore, por edhe nuk janë aktivë kur diaspora i promovon ato. Shteti nuk ka të dhëna statistikore për promovimet e kulturës shqiptare në botë, sipas vendeve, sipas zhanreve kulturore etj.[66] Për fat të mirë vetë artistët dhe sidomos sportistët kanë kohë që e kanë kaluar këtë barrierë. Sportistët kosovarë, ata shqiptarë në

[63] Për një trajtesë të përmbledhur rreth zhvillimit të Diplomacisë shih: Meçalla, Eraldo (2015) "Çfarë është diplomacia?", Bota Sot, 29 qershor, http://www.botasot.info/opinione/422191/cfare-eshte-diplomacia/.
[64] Në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës (http://www.kultura.gov.al/) do të gjeni informacion mbi marrëveshjet e bashkëpunimit jo vetëm me aktorë shtetëror por edhe ato jo-shtetërore.
[65] Zyka, Luan (2017) "Diaspora dhe Diplomacia Kulturore", Panorama, 24 Nëntor, http://www.panorama.com.al/diaspora-dhe-diplomacia-kulturore/.
[66] *Po aty*.

Maqedoni, Preshevë, më pak në Mal të Zi, janë në vëmendje dhe vazhdimisht 'ushqim' për sportin shqiptar. Kurse ata shqiptarë janë shumë më pak të përfaqësuar, për shkak edhe të cilësisë dukshëm më inferiore.

Institucionalizimi i Marrëdhënieve Ndër-Kulturore

Marrëveshja për Partneritet Strategjik midis Shqipërisë dhe Kosovës, nënshkruar më 11.01. 2014 përbën dokumentin bazik, ku institucionalizohet bashkëpunimi i Shqipërisë me Kosovën. Pikat më të rëndësishme të këtij dokumenti konsistojnë në:

- *Hartimin e planeve të veprimit dhe strategjive të zhvillimit të përbashkët për arsimin para-universitar në Shqipëri.*
- *Koordinimin e politikave arsimore të përbashkëta, në përputhje me standardet evropiane.*
- *Hartimin e një platforme me qëllim promovimin e iniciativave të përbashkëta të bashkëpunimit në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore.*
- *Koordinimi i politikave në fushën e sportit, në përputhje me standardet evropiane, përfshirë organizimin e përbashkët të aktiviteteve të ndryshme sportive.*
- *Forcimi i bashkëpunimit mes bibliotekave kombëtare dhe arkivave të të dyja vendeve.*[67]

Në javët e fundit të vitit 2017, Shqipëria përgatiti një draft-marrëveshje me Maqedoninë edhe në aspektin kulturor, e cila do të finalizohej dhe do të paraqitej në mbledhjen mes dy qeverive në mes Dhjetorin e vitit 2017. Kjo ishte mbledhja e parë e dy qeverive tona dhe përpjekja për të filluar një histori të re mes dy vendeve tona, që pas zgjedhjes së kryeministrit Zaev në krye të Ekzekutivit maqedonas.[68]

Institucionalisht përpjekjet janë të organizuara shumë mirë. Dy ministritë respektive të Kulturës, organizuan në Tiranë në datën 13 shkurt 2014 takimin *"Kultura - hapësira jonë e përbashkët"* nën kujdesin e ministres shqiptare Kumbaro dhe ministrit të Kosovës Memli Krasniqi. Takimi që u zhvillua në Galerinë Kombëtare të Arteve pati pjesëmarrjen e të gjithë drejtuesve të institucioneve artistike e kulturore të të dy vendeve. Në përfundim të takimit u nënshkrua protokolli i bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Kulturës të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës, qëllimi i të cilit ishte themelimi i kalendarit të përbashkët kulturor vjetor, si dhe bashkërendimi i aktiviteteve kulturore mes dy vendeve.[69] Të dyja ministritë propozuan aktivitetet kulturore (nga propozimet e përcjella nga institucionet përkatëse), premtuan të koordinojnë dhe morën përsipër detyrimet financiare që lidhen me zbatimin e aktiviteteve. Ky protokoll i

[67] Shih faqen zyrtare të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, seksioni: "Marrëdhëniet me Vendet e Rajonit", http://www.punetejashtme.gov.al/al/misioni/shqiperia-ne-rajon/marredheniet-me-vendet-e-rajonit.
[68] Zyra e shtypit e Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë.
[69] Kumbaro, Mirela (2014) "Fjala e Ministres Kumbaro Furxhi në takimin: Kultura-Hapësira jonë e përbashkët", 14 Shkurt, http://www.kultura.gov.al/al/newsroom/deklarata-per-shtyp/fjala-e-ministres-kumbaro-furxhi-ne-takimin-kultura-hapesira-jone-e-perbashket.

bashkëpunimit, zë një hapësirë katër vjeçare dhe mbyllet në vitin 2018 duke i propozuar aktivitetet kulturore çdo fillimviti. Ashtu si u premtua kalendari i përbashkët kulturor nisi menjëherë në datën 14 shkurt në Prishtinë, me ekspozitën e fototekës "Marubi", në bashkëpunim me Galerinë e Arteve të Prishtinës, "Objekti i lëvizshëm i një arkivi". Ky kalendar, referuar Ministrisë shqiptare të Kulturës ka pasur një impakt institucional, por nuk shihet realisht ndikim mes publikut. Në fakt, këtë mungesë impakti e kanë pranuar dhe vetë zyrtarët. *"Do të thosha se ka qenë një "vrimë e zezë", por me nismën e parë të bashkëpunimit me Kosovën për një kalendar të përbashkët kulturor, të cilin është i katërti vit që e realizojmë, mund të themi se gjërat po ndryshojnë. Kemi realizuar shfaqe të përbashkëta, me lëvizshmëri të ndërsjelltë të krijuesve dhe artistëve në dy vendet",* shprehet ministria Kumbaro.[70]

I gjithë ky mjedis inkurajues, përcillte takimin e dytë të Tiranës, ku kryeministri i atëhershëm i Kosovës Isa Mustafa u prit me të gjitha nderimet protokollare nga homologu i tij Edi Rama, përpara se të gjithë ministrat së bashku të zinin vend rreth një tryeze të rrumbullakët e veshur me simbolet e Bashkimit Evropian, me në qendër shqiponjën e zezë dy krenare mbi një sfond të kuq, simbolet kombëtare shqiptare. Mbledhja u zhvillua në kohë rekord, kurse vendimet e marra prej këtij mediumi ishin domethënëse: 5 marrëveshje, 4 memorandume dhe dy protokolle bashkëpunimi. Ministria e Kulturës së Republikës së Shqipërisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës dhe Ministria e Diasporës së Republikës së Kosovës nënshkruan memorandumin e bashkëpunimit, me dëshirën për të forcuar marrëdhëniet ndërmjet dy vendeve me qëllim përçimin e vlerave të përbashkëta kulturore dhe historike. Ky memorandum u nënshkrua nga Ministrja Mirela Kumbaro, Ministri Valon Murati dhe Ministri Kujtim Shala, ku u shpreh vullneti i përbashkët për konkretizimin e bashkëpunimit në realizimin e Qendrave Kulturore në Diasporë. Dokumenti synonte nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës në programet "Ditët e Kulturës Shqiptare në Diasporë" dhe themelimit të përbashkët të "Qendrave Kulturore në Diasporë". Në nënshkrimin e marrëveshjes së kalendarit të ri kulturor Shqipëri- Kosovë më 20 shkurt 2015 në Prishtinë, Ministri i Diasporës i Kosovës, Valon Murati, dhe ministria e Kulturës e Shqipërisë, Mirela Kumbaro, u shprehën jo vetëm për objektivat dhe detyrat që dalin nga Ligji i Diasporës, por edhe për vetë aktivitetet kulturore për diasporën. Takimi i Prishtinës parapriu memorandumin e bashkëpunimit, i cili u nënshkruar në Tiranë mes ministrive të Diasporës, Kulturës në Kosovë dhe Shqipëri, për të shfrytëzuar sa më mirë kapacitetet tona dhe për të organizuar aktivitete kulturore në diasporë.[71] U premtua një bashkëpunim i ngushtë kulturor në mes Kosovës dhe Shqipërisë qysh në fillim të vitit. Shkëmbimi i aktiviteteve kulturore e deri te organizimet më të mëdha ishin premtimet që hynë në thes të përbashkët me idenë e

[70] Klubi i Debatit Politik (2017) "Ekskluzivisht për KDP-në flet ministrja Kumbaro: Kemi program për bashkëpunim kulturor mes shqiptarëve kudo që ndodhen", 12 Tetor, https://kdpolitik.com/2017/10/ekskluzivisht-per-kdp-ne-flet-ministrja-kumbaro-kemi-program-per-bashkepunim-kulturor-mes-shqiptareve-kudo-qe-ndodhen/.

[71] Pa Autor (2015) Shqipëri-Kosovë memorandum bashkëpunimi për "Ditët e Kulturës Shqiptare në Diasporë" dhe themelimin e "Qendrave Kulturore në Diasporë", 23 Mars, http://www.kultura.gov.al/al/newsroom/lajme/shqiperi-kosove-memorandum-bashkepunimi-per-ditet-e-kultures-shqiptare-ne-diaspore-dhe-themelimin-e-qendrave-kulturore-ne-diaspore.

"Kalendarit të përbashkët kulturor" në mes këtyre dy vendeve, raportoi asokohe emisioni "Express" në KTV. Megjithëkëtë, rezultati ishte i njëjtë edhe për vitin 2015. Ishin fare të pakta aktivitetet e përbashkëta kulturore që u zhvilluan brenda këtij viti. Ajo çfarë ishte paraparë të realizohej brenda 2015-ës, u realizua vetëm pjesërisht. Përveç shkëmbimit të dy shfaqjeve teatrale, disa ekspozitave dhe koncerteve, të tjerat do të mbeteshin thjesht nën hije. KTV-ja, televizoni kosovar, u përpoq të merrte kontakt me Ministrinë e Kulturës, por pothuaj ka qenë e pamundur të merrej një përgjigje sa i përket kësaj mbarëvajtje.[72] Ndërsa, ministrja e Kulturës së Shqipërisë, Mirela Kumbaro, të njëjtit medium iu shpreh se ky vit ka qenë aktiv sa u përket bashkëpunimeve, nëse do të bëhej krahasimi me vitin e kaluar. Kumbaro ka thënë se për vitin 2016 parashihej një bashkëpunim edhe më i madh mes dy vendeve, por që për këtë, sipas saj, duhet një mobilizim më i madh i krijuesve, citohet KTV.[73] Epilogu i zhvillimit ishte koncerti i bandës së njohur të rokut "Gjurmët" që përmbylli aktivitetet për atë vit sa i përket "Kalendarit Kulturor" Kosovë-Shqipëri. Ndërkaq, konferenca vjetore një herë në Prishtinë dhe një herë në Tiranë për trashëgiminë kulturore materiale dhe jomateriale me tematika specifike, trajnime të përbashkëta nga specialistët e UNESCO-s dhe organizata të tjera, trajnime nga stafi i Bibliotekës Kombëtare në Tiranë për specialistët në Prishtinë, pjesëmarrje e përfaqësuesve nga Kosova në aktivitetet e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik, konferenca për dramaturgjinë në Tiranë ishin disa nga ngjarjet, të cilat nuk u realizuan atë vit. Kësaj i shtohej edhe mosfunksionimi i portalit të përbashkët albanologjik Kosovë – Shqipëri, referuar të njëjtit burim.

Sfidat e Ndikimit në Kulturë: Nga Marrëveshjet tek Perceptimi Publik

Mbledhja e Qeverisë së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë, e cila ishte parashikuar të mbahej më 24 prill të vitit 2017 në Vlorë u shty pa dhënë asnjë datë dhe motiv. Ajo do të ishte mbledhja e katërt që Republika e Kosovës dhe Republika e Shqipërisë zhvillonin që pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Pa shumë zhurmë, ajo u arrit dhe është mbajtur më në fund në Korçë më 27 Nëntor të po të njëjtit vit. *"Është evidente se këto mbledhje më shumë kanë qenë një spektakël patriotik dhe një tendencë që të paraqitet një imazh i bukur kuqezi, se sa kanë pasur ndonjë efekt konkret në përmirësimin e jetës së qytetarëve",* është shprehur pak orë para mbledhjes së katërt të dy qeverive, analisti kosovar Artan Muhaxhiri.[74] Në një farë mënyre, shtyrja ka treguar realisht edhe nivelin e marrëdhënieve të Shqipërisë me Kosovën, Maqedoninë e më gjerë. Shumë strategji, dokumente, premtime, aktivitete dhe takime zyrtare, por impakt shumë i pakët dhe mbi të gjitha detyra të lëna përgjysmë mes dikasteresh. Ky perceptim sot është gjerësisht i shpërndarë në trojet shqiptare të rajonit dhe kjo është provuar

[72] Pa Autor (2015) "Sa pati shkëmbime kulturore mes Kosovës e Shqipërisë", Koha Net, 24 Dhjetor, http://archive.koha.net/?id=4&l=90701
[73] *Po aty*.
[74] Pa Autor, (2017) "Mbledhjet e qeverive të Kosovës dhe të Shqipërisë: Spektakël folklorik pa efekt ekonomik", Gazeta Express, 27 Nëntor, http://www.gazetaexpress.com/lajme/mbledhjet-e-qeverive-te-kosoves-dhe-te-shqiperise-spektakel-folklorik-pa-efekt-ekonomik-466860/.

në të gjitha Vox pop që ka bërë media, shtuar edhe me prononcimet e shumta të shumë personazheve të hapësirave ku jetojnë shqiptarët.[75]

Kush e krijon diferencën e perceptimeve në ditët tona? *"Mosnjohja e njani-tjetrit. Ende, ma shumë se nji çerek shekulli prejse u shemb komunizmi n'Shqipni, relacionet Tiranë-Prishtinë janë të mbushuna me stereotipe, keqkuptime, keqinterpretime, dhe interesa të kundërta",* shprehet publicisti kosovar Migjen Kelmendi.[76] Mospasja e rezultateve konkrete ishte ajo që e zhvlerësoi qëllimin e mbetjes së takimit të katërt në prill të vitit 2017. Palët ranë dakord më pas ta shtynin, pasi moszbatimi i disa marrëveshjeve që ishin firmosur, duke nisur që nga mbledhja e parë e mbajtur në Prizren, e bënte shumë pa thelb takimin. Vetëm me përmbushjen e tyre ishte menduar të thirret mbledhja e radhës.[77]

Që në mbledhjen e parë të përbashkët në Prizren është nënshkruar partneriteti strategjik Shqipëri-Kosovë, pasuar me atë të marsit të vitit 2015 në Tiranë dhe të qershorit të vitit 2016 në Prishtinë. Në një vlerësim të përgjithshëm, ku në dukje nuk janë strategjitë, kalendarët dhe aktivitetet duhet thënë se impakti i Shqipërisë në Rajon, mëton të jetë i madh, por ai është tejet larg realitetit që po jetojmë. Duket se prekjen më të madhe deri më tani e ka pasur deri diku media. *"Në këtë linjë, sidomos pas mbledhjes së përbashkët të dy qeverive, dhe Deklaratës për Partneritet Strategjik, dy ministritë e linjave kanë hartuar tashmë një kalendar të përbashkët kulturor dhe prej katër vitesh institucionet e kulturës, që veprojnë në kuadër të dy Ministrive të Kulturës të dy shteteve tona, e shtrijnë aktivitetin kulturor në shumë drejtime, p.sh, shënohen ditët e përbashkëta kulturore, historike dhe ka edhe bashkërendim të aktiviteteve kulturore e artistike për ditët me rendësi të veçantë kombëtare, kulturore e historike të Kosovës dhe Shqipërisë. Pra, janë një sërë projektesh nga të dyja vendet të cilat realizohen në bazë të një dinamike dhe një kalendari të saktësuar në mënyrë precize koha, shpenzimet si dhe bartësit e aktiviteteve",* referon Syl Ukshini.[78]

Larg këtyre, nga ana zyrtare, në kujtesën e publikut kanë mbetur vetëm protokollet me sfond e tituj patriotikë. Më së shumti janë vlerësuar simbolikat dhe gjetjet e sloganeve. Filloi me ditën simbolike të 11 Janarit, *"Një Tokë, Një Popull, Një Ëndërr",* mbledhja e parë e vitit 2014-ën në Prizren. Patosi i takimit ishte aq i madh saqë u caktuan 15 prioritete me zotimet respektive të Edi Ramës dhe Hashim Thaçit që ato do të realizoheshin në kohë rekord për 100 ditë. Një vit e pak muaj më vonë, mbledhja e dytë që u zhvillua më 23 mars 2015 në Tiranë, u mbajt në Pallatin e Kongreseve rreth një shqiponje dykrenare. Një gjetje e mrekullueshme nga organizatorët e Tiranës, ku theksi u vu në intensifikimin e marrëdhënieve. Me një diferencë kohore të njëjtë u mbajt mbledhja e tretë, që daton 7 korrikun e vitit 2016. E katërta u realizua vetëm më 27 Nëntor 2017 në Korçë. *"Mbledhja që sapo mbyllëm në Korçë flet për një bilanc arritjesh të rëndësishme bazuar mbi sa kemi bërë deri më sot. Ne kemi marrë këto angazhime mbi bindjen se ka akoma shumë për të bërë dhe praktikisht që nga mbledhja e parë në Prizren më 2014 e kemi pasuruar këtë kuadër me disa pjesë të rëndësishme ndërkohë*

[75] Intervistë me Kim Mehmetin, shkrimtar dhe publicist, datë 8 Nëntor 2017.
[76] Intervistë me Migjen Kelmendi, Publicist, datë 13 Nëntor 2017.
[77] Pa Autor, (2017) "20 April 2017 11:11 "Ja pse u shty mbledhja e përbashkët Kosovë-Shqipëri", Gazeta Mapo, 20 Prill, http://www.mapo.al/2017/04/ja-pse-u-shty-mbledhja-e-perbashket-kosove-shqiperi/1.
[78] Intervistë me Syl Ukshini, Ministër Këshilltar, I Ngarkuar me Punë Çështjet Politike, Integrime evropiane, organizata rajonale dhe ndërkombëtare, datë 24 Nëntor 2017.

që mbetet për të plotësuar një kërkesë tjetër. Me vjen mirë po ashtu që të tërë hapat e ndërmarrë janë të mirë përcaktuar. Bota shqiptare është një dhe e pandashme", tha kryeministri Rama entuziast pas marrëveshjeve të arritura më 27 Nëntor.

Shumë më pak fjalë për kulturën dhe realisht impaktin e saj. Po cili është bilanci real i bashkëpunimit të dy qeverive? A është rritur bashkëpunimi kulturor dhe arsimor? Një pjesë e madhe e opinionistëve në të dy anët e kufirit beson se kjo marrëdhënie është zbehur. *"Lëvizjet jo vetëm kulturore në relacionin Tiranë-Prishtinë ka vite që them se janë vetëm të nji drejtimi: prej Tirane në Prishtinë. Asgja e randësishme nuk shkon në drejtimin e kundërt. Andaj, nuk mundemi me folë për zbehje, ndoshta eventualisht për pakim të produktit kulturor që po vjen prej Tirane",* citohet Migjen Kelmendi, publicist, pronar i Televizionit kabllor "Rrokum".[79] Fatkeqësisht, individët, institucionet e ndryshme private dhe shtetërore në Ballkan kanë perceptime të ndryshme dhe kjo lidhet me cilësinë e këtyre marrëdhënieve, që me sa duket lë ende shumë për të dëshiruar, sa i përket impaktit të vërtetë të Tiranës. Kjo e fundit duket ka një mospërfillje për faktorin kosovar dhe mundësitë e bashkëpunimit. *"Do të doja që të kisha punë në Fondin e Galerisë Kombëtare në Tiranë,* shprehej piktori i njohur kosovar Rexhep Ferri,[80] një nga pararendësit e modernizmit në artet figurative në ish-Jugosllavi. "*Ata do ishin pjesë e modernizmit shqiptar të kohës së pasluftës, kohë kur Shqipëria e kishte të ndaluar, por zyrtarët e Galerisë së Arteve në Tiranë as nuk denjuan të mbanin ndonjë nga punët pas ekspozitës time atje".* Ka një lloj shemrie sa i përket cilësisë së punëve të autorëve kosovarë në Tiranë. Disa syresh, që kanë bërë histori, nuk janë të përfaqësuar në antologjitë dhe fondet shqiptare. Njësoj si Ferri nuk ka vend për Anton Pashkun, Rrahman Deden, Farudin Gungën etj.

"Mund të them se dy vitet e fundit ndodh një fenomen i çuditshëm: edhe Shqipëria nuk tregon ndonjë interesim për shqiptarët e Maqedonisë edhe ata kanë filluar të ndjehen të vetmjaftueshëm. Kjo, më së miri, shihet tek shikueshmëria e Televizioneve të Shqipërisë që është në rënie dhe është mekur euforia e dikurshme kur shqiptarët e këtushëm thuajse nuk i shikonin fare TV vendore. Por siç thashë: çdo gjë është e fundshme - edhe te mediat e Shqipërisë thuajse kanë harruar se ka shqiptarë në Maqedoni dhe i përmendin vetëm kur ndodh ndonjë skandal e jo për ndonjë ngjarje kulturore", shprehet publicisti Kim Mehmeti.[81] Largimi i marrëdhënieve lidhet disi dhe me globalizimin e informacionit. Informacioni global është shumë më i rëndësishëm sesa ai lokal. Ndaj humbësit më të mëdhenj janë komunitetet e vogla dhe produktet e tyre. Këtij trendi nuk i shpëton edhe vetë Ballkani ku lajmet kryesore, veç atyre politike, shkojnë me trendin ndërkombëtar për pasqyrimin e lajmeve që janë më së shumti të klikuara. Dhe, ndaj ndodh përshembull si me Malin e Zi, që marrëdhënia është disi e mbetur në nivele korteziale të Ekzekutivit dhe presidencës së dy vendeve për shkak se edhe marrëdhënia është e tillë. Mes dy vendeve ka pasur shkëmbime të vazhdueshme të zyrtarëve të lartë, ku diskutimet më të mëdha përveç marrëdhënieve bilaterale shkojnë për proceset e integrimit.*"Tirana zyrtare ka ndikim të*

[79] Intervistë me Migjen Kelmendi, Publicist, datë 13 Nëntor 2017.
[80] Citim nga autori pas ekspozitës personale 50 vjet nga krijimtaria e tij në Galerinë e Arteve në Tiranë. Nëntor 2013.
[81] Intervistë me Kim Mehmeti, ish-drejtuesi i zyrës së TOPCh në Maqedoni, datë 8 Nëntor 2017.

tërthortë, do të thoja, në kulturën e shqiptarëve në Malin e Zi. Nuk ka një bashkëpunim dhe komunikim institucional e as ndihmë prej institucioneve zyrtare kulturore të Republikës së Shqipërisë. I gjithë komunikimi kulturor zhvillohet nëpërmjet subjekteve kulturore private, shoqatave apo organizatave joqeveritare, që merren me kulturën. Më duket se më shumë ky lloj komunikimi kulturor zhvillohet në një kahje (drejtim)! Megjithatë, me keqardhje më duhet të them se në vend që të vijë duke u rritur, pas atij entuziazmi fillestar në fillim të viteve '90 të shekullit të kaluar, vërehet një lloj rënie e nivelit të komunikimit kulturor. Duhet thënë po ashtu se shqiptarët në Mal të Zi nuk janë të përfshirë fare në kalendarin e përbashkët kulturor Shqipëri – Kosovë", shprehet Ismet Kallaba.[82]

Duket se ngritja në nivele të larta të kulturës dhe përafrimi me parametrat ndërkombëtarë përbën sfidën e vërtetë të Shqipërisë. Besohet se përmbushja e parametrave evropianë, që lidhet me thithjen e filozofisë së etërve të Bashkimit Evropian, që Evropa të njihet si bashkësi kulturore do jetë rruga e fundme e bashkëpunimit. Dhe, duket se ky është emëruesi i përbashkët, nëse do arrijmë integrimin në Familjen Evropiane ku nëse elitat kulturore dhe mediatike të hapësirës shqiptarofone do kontribuojnë atëherë do t'ia dalim sëbashku. *"Ndaj, ne kemi ardhur në Korçë të frymëzohemi. Njëmendësia, por dhe ekonomia, na nxit gjithashtu për të bashkëpunuar në diplomaci, të kemi seli dhe përfaqësim diplomatik e konsullor komplementar dhe alternativ. Bashkë, si pjesë e Unionit Evropian ku të dyja shtetet aspirojnë të integrohen, do të jemi më të fortë. Bashkë do të na respektojnë më shumë",* shkroi një editorial Ministri i Jashtëm kosovar Behgjet Pacolli.[83] Një nga themeluesit e Bashkimit Evropian Robert Schuman, ish-ministri francez dhe njëri nga ideatorët kryesorë të kësaj bashkësie politike, në librin "Në emër të Evropës", mes shumë argumenteve përcaktoi se: *"Evropa para se të jetë Aleancë ushtarake apo entitet ekonomik, duhet të jetë bashkësi kulturore në kuptimin më të lartë të kësaj fjale"*. Kjo i mungon sot e kësaj dite Shqipërisë dhe vendeve të rajonit me popullsi shqiptare. Mungon përpjekja për të realizuar parametrat evropianë dhe po humbet koha me aktivitete pa substancë ose me impakt shumë të dobët.

"Perceptimi dominant i nji pjese përfaqësuese në rrafshin e institucioneve kulturore të Kosovës asht se - Tirana asht Piemonti shqiptar (sic!). Ndaj, ky perceptim krejtësisht i gabuem për mendimin tim, ban që institucionet kulturore të Kosovës të shndërrohen në makina fotokopjuese, të cilat nuk bajnë gja tjetër pos që importojnë ligje, programe, manifeste, politika, ide prej Tirane në Prishtinë, tue ja lejue vetes komoditetin - mos me mendue. Në këtë pozicion të vet-zgjedhun krejt jo-aktiv, institucionet kulturore të Prishtinës zyrtare e kanë humbë kredibilitetin dhe me të drejtë nga Tirana zyrtare shihen dhe përjetohen si - zgjatime te departamentit për kulturë të Kukesit (sic!). Pra, në këtë domen, ndikimi asht total. Prishtina s'ka politika kulturore", shprehet botuesi dhe publicisti Migjen Kelmendi.[84]

[82] Intervistë me Ismet Kallaba, kryetar i Shoqatës së Artistëve dhe Intelektualëve "Art Club" Ulqin, datë 12 Shtator 2017.
[83] Pacolli, Behgjet (2017), "Pse Korça, si start i ri për bashkëpunimin me Shqipërinë?", Gazeta Panorama, 27 Nëntor, http://www.panorama.com.al/pse-korca-si-start-i-ri-per-bashkepunimin-me-shqiperine/.
[84] Intervistë me Migjen Kelmendi, Publicist, datë 13 Nëntor 2017.

Në fakt, perceptimi është se Tirana, megjithëse përpiqet të jetë më institucionale, mungojnë resurset e duhura për të çuar përpara proceset e bashkëpunimit mes të dy vendeve. Dhe, fakti është se mes institucioneve kulturore të Shqipërisë dhe Kosovës funksionon gjithçka shumë mirë sa i përket dokumentacioneve.

Në këtë drejtim na vjen në ndihmë edhe një nga aspektet më të ndritura të këtij bashkëpunimi, që e përbënte marrëveshja për Portalin e parë të përbashkët albanologjik midis Shqipërisë e Kosovës. Megjithë përpjekjet për të cilin bibliotekat kombëtare e të dyja vendeve ishin investuar realisht, pas nënshkrimit të marrëveshjes së para katër vjetësh, ai ende sot e kësaj dite nuk është funksional. *"Neve kemi personele të kualifikuar por jo shumë mundësi dhe kapacitete logjistike, që të mbahet në nivelet që ne synojmë një portal i tillë. Dhe, nëse për momentin nuk arrijmë ta bëjmë ne këtë sot për sot, atëherë për Kosovën është pak më e vështirë",* citohet drejtoresha e Bibliotekës Kombëtare Persida Asllani.[85] Klikimi në adresën në internet, nuk jep mundësi qasjeje në portalin e ideuar për burime bibliografike si libra, artikuj, harta, dorëshkrime apo burime dixhitale të karakterit albanologjik. Të mendosh zhurmën sesi u trumbetua midis institucioneve qendrore të bibliotekarisë së dy shteteve Marrëveshja për krijimin e portalit albanologjik Shqipëri-Kosovë, atëherë e ke një zhgënjim. Ajo u nënshkrua prej Aurel Plasari, asokohe drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, dhe Sali Bashota, po ashtu në atë kohë drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Promovimi i portalit albanologjik (www.portalialbanologjik.net), ishte promovuar në prill të atij viti në kuadër të edicionit të nëntë të "Java e Bibliotekës në Kosovë", por ajo mbeti në nivele shumë të prapambetura. Kohë më parë përfaqësues të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë u shprehën se përgjegjësia për menaxhimin e portalit i takonte Bibliotekës Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani", e realisht përfaqësues të kësaj të fundit nuk e kishin fare të qartë se kur kish ndaluar së funksionuari portali albanologjik, kur u pyetën nga media.[86] Nëse portali nuk funksionon, kjo nuk do të thotë se Shqipëria s'ka një bashkëpunim institucional shumë cilësor me Kosovën. Këtë e dëshmoj dhe aktiviteti i fundit kushtuar shkrimtarit kosovar Anton Pashkut. Neve kemi angazhime dhe gjithçka funksionon sa më mirë brenda këtij bashkëpunimi, që është krijuar nga kalendari, shprehet drejtoresha e Bibliotekës Kombëtare, Persida Asllani. *"Derisa Tirana zyrtare po ballafaqohet me kalimin prej Komunizmit në Kanabizëm, Prishtina zyrtare po përballet me sfidat e shtetformimit dhe paqartësisë se çfarë procesi asht ky. Ende s'asht mirë i përmbrendësuem koncepti qytetar i Kosovës nga ana e lidërshipit kosovar. Ende Kosova qytetare përjetohet si diçka provizore, e cila si finale ka Bashkimin me Shqipninë. E kësaj, për fat të keq, po i ndihmojnë edhe koketimet e herëmbashershme të lidershipit në Tiranë, që po i ngashnjen dhe po i ushqen këto pritje politikisht joproduktive të politikës kosovare. Evropianizimi asht fjala dhe perspektiva e afrimit tonë"*, shprehet Migjen Kelmendi.[87] Po ndërsa me Kosovën, marrëdhënia e Shqipërisë është e ngrohtë për shkak se dy shtetet kanë shumë kanale bashkëpunimi, paçka se ka zëra pro dhe kundër impaktit pozitiv të Tiranës, nuk mund të thuhet kështu për shtetet e tjera me popullsi shqiptare.

[85] Intervistë me Persida Asllani, drejtoresha e Bibliotekës Kombëtare, datë 14 Nëntor 2017.
[86] Pa Autor (2015) "Portali i përbashkët albanologjik Kosovë - Shqipëri, jofunksional", Dialog Plus, 30 Tetor, http://dialogplus.ch/portali-i-perbashket-albanologjik-kosove-shqiperi-jofunksional-77647.
[87] Intervistë me Migjen Kelmendi, Publicist, datë 13 Nëntor 2017.

Ka një perceptim se Shqipëria është qendra dhe se besohet se mjediset e tjera janë thjesht periferike. Këtë e kupton në prononcime të vazhdueshme të faktorit shqiptar në Kosovë, Maqedoni dhe Mal të Zi. *"Kam besuar dhe besoj se periferitë kulturore- siç jemi ne shqiptarët e Maqedonisë duhet t'i mirëmbaj qendra sepse ato i nevojiten qendrës. Apo thënë ndryshe: potenca e një populli dëshmohet nëpërmjet asaj sa kujdeset për periferitë e veta shoqërore e kulturore. Shqipëria nuk ka as vullnet e madje as interesim ta bëjë këtë, kështu që kultura shqiptare është e fragmentarizuar. Gjithashtu përshtypja ime është se ka filluar të gjithëve të na pëlqeje të jetojmë nëpër principatat tona kulturore e madje me duket se as që na intereson integrimi i kulturës shqiptare brenda vetvetes. Duke qenë kështu, ndikimi i Shqipërisë te shqiptarët e Maqedonisë vërehet vetëm në politikë edhe aty e paraprirë nga përfitimet personale të elitave partiake",* shprehet shkrimtari Kim Mehmeti.[88]

Më shumë sesa vullnet, Shqipëria nuk gjeneron dot fonde për Ministrinë e saj të kulturës. Ministrisë së Kulturës për vitin 2018 i është dhënë një buxhet prej 2 miliardë lekësh të rinj, me një rritje prej vetëm 200 milionësh nga viti i kaluar. Sipas vetë raportit për projektbuxhetin, prezantuar nga ministrja Mirela Kumbaro në Komisionin e Medias, është një rritje që vjen si rrjedhojë e investimeve me lekë. Ministria bën me dije se fondi i pagave dhe sigurimeve shoqërore në totalin e buxhetit të Ministrisë së Kulturës përben 46.6% të buxhetit, çka do të thotë se pothuaj gjysma e buxhetit shkon për rroga e sigurime.[89] Akademitë e Shkencave në Kosovë dhe Shqipëri po vuajnë seriozisht mungesën e fondeve. Në të kaluarën të dy këto institucione, veçmas njëra-tjetrës dhe sëbashku, kanë luajtur një rol shumë të madh në aspekte të ndryshme, që jo thjesht lidheshin me kulturën kombëtare dhe çështje të identitetit kombëtar por arrinin të vendosnin disa standarde të qëndrueshme kulturore dhe gjuhësore që vijojnë të jenë të rëndësishëm edhe në të tashmen. Është hedhur ideja gjithnjë për bashkimin e dy akademive një akt që do ta ndihte shumë dhe do jepte një shtysë të re për arsimin, shkencën dhe kulturën në trojet shqiptare. Për fat të keq nuk është bërë gjë. Nga specialistë të ndryshëm mendohet se realizimi i një Akademi unike e shkencave mund të shpëtojë përpjekjen e qeveritarëve në procesin e standardizimit të teksteve për ciklin para-universitar dhe arsimin e lartë. Gjithsesi me problematikën e sotme dhe krizën e thellë që po kalon Akademia e Shkencave të Shqipërisë nuk mund ta luajë këtë rol. Aq më shumë ajo e Kosovës. Gjithsesi, të dy institucionet kanë një kalendar të pasur, që e kanë plotësuar me shumë aktivitete të përbashkëta.

Roli i Medias: Fuqizimi i Institucioneve Private

Për hir të së vërtetës, mediat shqiptare si TopCh, Digitalb, Supersport, Klan kanë krijuar partneritet e tyre në Kosovë e Maqedoni dhe ky përbënte ndikimin më të madh direkt që Shqipëria përcillte në rajon. Dhe, që merrte pas prej andej. Kosova dhe Maqedonia, falë atashimit të medias shqiptare, ishin shumë më të pranishme prej përditësisë së lajmit, por edhe problematikës së ngritur.

[88] Intervistë me Kim Mehmeti, ish-drejtuesi i zyrës së TOPCh në Maqedoni, datë 8 Nëntor 2017.
[89] Nikolli, Fatmira (2017) "Buxheti i 2018-ës, Kultura përplaset me Financat", 9 Nëntor, Gazeta Shqiptare, http://www.gsh.al/2017/11/09/buxheti-2018-es-kultura-perplaset-financat/.

Po sa realisht aktive është diplomacia kulturore shqiptare? Ajo është më e dobët në rajon edhe për faktin sepse nuk është më e atashuar direkt në praktikë. Sikur të mos mjaftojë kjo, qysh nga viti 2016, qendra e TopCh në Kosovë dhe zyra në Shkup u mbyllën për probleme financiare. Impakti i kulturës dhe i shkëmbimit kulturoro-arsimor tashmë ndihet dukshëm por sidomos me Maqedoninë, ai ka rënë ndjeshëm. Sot, nuk ka ndonjë përpjekje nga ana e Tiranës ta përçojë mendimin e saj në rajon përmes medias. Portalet, që kanë lulëzuar në të dy vendet, thjesht përcjellin shkarazi lajme mes vendeve, shpesh të pakonfirmuara. *"Nuk ka ndodh që ndonjë ngjarje e këtushme kulturore të përcillet nga mediat e Shqipërisë. Kjo vërehet posaçërisht pas mbylljes së redaksisë së Top Chanel në Shkup e cila gjatë viteve sa vepronte ndikoi shumë në faktorizimin e shqiptarëve të Maqedonisë brenda tërësisë shqiptare. Shkurt, përderisa dikur Tirana shihej si Piemont i çdo gjëje shqiptare tani te shqiptarët e Maqedonisë thuajse ka filluar të mbisundoj bindja se: ata na konsiderojnë si pjesa e pavlerë e popullit",* shprehet ish-drejtuesi i zyrës së TOPCh në Maqedoni, Kim Mehmeti.[90] Më shumë se nënvlerësim, largimi i interesit duket se po ngjet edhe si rezultat i indiferencës që Shqipëria dhe anasjelltas, rajoni me shqiptarë, kanë për njëri-tjetrin. Duket se në hapësirën shqiptare në Ballkan ka një përpjekje për krijimin e mini-identiteteve, brenda identitetit kombëtar shqiptar. Të gjithë synojnë më shumë krijimin e një vendi në familjen evropiane sesa integrimin te njëri-tjetri. Debate të vazhdueshme përcillen mes njëri-tjetrit, por një nga njohësit më të mirë të këtij fenomeni, Mehmet Kraja, do të shprehej në librin e tij për Identitetin Kosovar se: *"Identiteti kosovar" është një identitet politik i shpikur. Dhe ky identitet nuk ekziston as përtej politikës, sepse, Kosova jemi ne dhe ne jemi një hiç",* u shpreh ai në një intervistë.[91]

Për hir të së vërtetës, Tirana i është shmangur këtij fenomeni dhe është munduar që impaktin në Kosovë ta mbajë në nivele institucionale. Me gjithë sukseset dhe aktivitetet që shpallen nga të dy anët e kufirit, bashkëpunimi i Shqipërisë me Kosovën në fushën e kulturës është akoma larg niveleve të duhura. Kjo nuk mund të thuhej për sektorin privat, ku deri muajt e fundit, media tregoi se qëndronte shumë më përpara se aktorët shtetërorë.

Nëse me Kosovën ka një farë zhvillimi nuk mund të thuhet kështu për Maqedoninë dhe Malin e Zi. *"Mendoj se deri më tani, me aq sa jam i njohur, diplomacia kulturore e Shqipërisë në Mal të Zi nuk ka funksionuar. Për momentin, nuk më kujtohet ndonjë aktivitet kulturor që është organizuar apo sponsorizuar nga Ambasada e Republikës së Shqipërisë, gjerësisht Ministria e Punëve të Jashtme. Në këtë drejtim, përjashtim bëjnë vetëm ato projekte nga fusha e kulturës që realizohen me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadër të Programit të bashkëpunimit kufitar Shqipëri - Malit i Zi (programi IPA)"*, shprehet Ismet Kallaba, kryetar i Shoqatës së Artistëve dhe Intelektualëve "Art Club" nga Ulqini, profesor i Letërsisë.[92] Kaq e vërtetë është kjo saqë shqiptarët pothuaj nuk e ndjejnë fare ndikimin e Tiranës. Jo thjesht për mungesën e bashkëpunimit direkt, por edhe atë të institucionalizimit të pakët. Një funksionar shqiptar i Partisë Demokratike të Socialistëve të Malit të Zi (DPS),

[90] Intervistë me Kim Mehmeti, ish-drejtuesi i zyrës së TOPCh në Maqedoni, datë 8 Nëntor 2017.
[91] Demolli, Donjeta (2013) "Hiçi Nuk Ka Identitet", Gazeta Jeta, 27 Shkurt, http://kallxo.com/gjnk/hici-nuk-ka-identitet/
[92] Intervistë me Ismet Kallaba, kryetar i Shoqatës së Artistëve dhe Intelektualëve "Art Club" Ulqin, datë 12 shtator 2017.

partisë që drejtohet nga Milo Gjukanoviç, punonjës i Ministrisë së Arsimit në Podgoricë e konfirmon këtë, paçka se nuk do të prononcohet direkt. *"Nuk e kemi të pranishme Tiranën, ashtu si do ta donim dhe për më tepër jemi shumë të përçarë me njëri-tjetrin",* shprehet ai. *"Shumica e familjeve shqiptare kanë platforma të ndryshme satelitore, dixhitale etj. përpos atyre tokësore, ku ndjekin kanalet dhe emisionet kryesore të televizioneve shqiptare. Mund të them se kjo ka pasur ndikim pozitiv, sidomos te fëmijët dhe të rinjtë, në përdorimin e gjuhës letrare shqipe. Nuk duhet harruar po ashtu fakti se një pjesë e studentëve shqiptarë nga trevat shqiptare në Mal të Zi i ndjekin studimet në universitetet në Shqipëri, gjë që ka pasur ndikim pozitiv në shumë aspekte, qoftë gjuhësore, kulturore etj., sidomos në ruajtjen e identitetit kombëtar të shqiptarëve në Mal të Zi"* shprehet Ismet Kallaba, që njëkohësisht është edhe organizatori i Festivalit "Kalipso" në Ulqin.[93] *"Shqiptarët në Mal të Zi përbëjnë grupin e pazëshëm, duke i eliminuar nga sfera publike. Kjo "heshtje mediatike" është pjesë e politikës redaktuese të mediave malazeze ndaj shqiptarëve. "Ato pak përmbajtje që trajtojnë shqiptarët në Mal të Zi kanë të bëjnë kryesisht me politikën dhe me kronikën e zezë", kurse kultura shqiptare është e anatemuar në mediat malazeze sepse të shkruash për kulturën e një populli tjetër, në këtë rast kulturën shqiptare, do të thotë të shkruash mirë për të",* shkruhet në raportin *"Mediat në gjuhën shqipe në Mal të Zi dhe kultura kombëtare*".[94]

Sporti: Bashkëpunim në një Sektor të Globalizuar

Falë përmbajtjes së madhe sportive, Kosova dhe Shqipëria kanë kohë që japin e marrin me njëra-tjetrën. Fakt është se një numër lojtarësh të Kosovës janë pjesëtarë të përfaqësueses shqiptare, kurse dy trajnerë të njohur shqiptarë Josa dhe Shkëmbi drejtojnë tashmë dy ekipe në Kosovë. Mirel Josa, trainer i "Tiranës" dhe "Skënderbeut" dhe një nga më të suksesshmit në Shqipëri tashmë është trajner i ekipit të njohur të "Prishtinës". Një ekip me histori të madhe dhe që është drejtuar dhe me trajnerë të njohur me renome ndërkombëtare. Kurse Bledi Shkëmbi, ish kapiten i Skënderbeut, është emëruar trajner i "Lirisë". Këto afrime të fundit kanë treguar se edhe Shqipëria po fillon të ndikojë sadopak në Kosovë. Në Maqedoni ndikimi më i madh ka qenë nga pak futbolliste shqiptarë që luajnë atje dhe që për fat janë afruar nga ekipe shqiptare. Trajneri Shpëtim Duro ka përcjellë përvojën e tij shqiptare në një nga ekipet më të mira të kampionatit maqedon, që është "Shkëndija" e Tetovës.

Sa i përket Shqipërisë, ky lloj bashkëpunimi dhe njohja me Kosovën, ka bërë që drejt saj të vërshojnë futbollistë të të gjitha moshave. Vetëm lojtarë të "Prishtinës" janë gati një skuadër e tërë. Kështu, sot, në Shqipëri ish lojtarë të Prishtinës që luajnë janë, Astrit Fazliu, Labionot Ibrahimi, Mentor Mazrekaj, Ilir Berisha, Enis Gavazaj, Argjend Malaj, Veton Shabani e Liridon Latifi.[95]

---

[93] *Po aty.*

[94] Kallaba, Ismet (2015) "Mediat në gjuhën shqipe në Mal të Zi dhe kultura kombëtare", *Thesis*, nr.2, fq. 110-111.

[95] Pa Autor (2017) "Sa shumë ish-lojtarë të Prishtinës luajnë në Shqipëri, përforcime të mundshme për Evropë", Gazeta Olle, 2 Qershor, http://gazetaolle.com/sa-shume-ish-lojtare-te-prishtines-luajne-ne-shqiperi-perforcime-te-mundshme-per-evrope-foto/.

Ndikimi i madh i Tiranës është rritur edhe prej platformës dixhitale të Sport, nga ku përcillen lajme, por edhe shkëmbehen më të rejat e fundit mes vendeve tona, ku një vend të madh ka zenë dhe Maqedonia, por kuptohet që pjesën më të madhe të lajmeve e mbajnë sportistët e Kosovës.

Potencialet e Arsimit

Impakti i Shqipërisë sa i përket arsimit lidhet më së shumti me një lloj përpjekje që është bërë sa i përket standartizimit të teksteve shkollore por edhe përpjekjen e madhe për hartimin e kurrikulave të përbashkëta shkollore. Kjo përpjekje mori hov sidomos pas nënshkrimit të *Marrëveshjes së bashkëpunimit për unifikimin e Kurrikulës së sistemit arsimor parauniversitar të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, në datën 03.06.2014.* Në kuadër të kësaj marrëveshjeje, palët kanë mbështetur procesin e bashkërendimit në nivel teknik dhe profesional dhe kanë zhvilluar mes tyre shumë aktivitete. Nga ky takim u arrit te *Unifikimi i Kornizës Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar të Shqipërisë me Kornizën Kurrikulare të Arsimit Parauniversitar të Kosovës.*[96]

Por këto marrëveshje u dukën se ngjanin bukur në letër porse në praktikë situata ishte e dhimbshme. Përpos takimeve të dy palëve, një rast i vitit 2016 nxori përballë hendekun që qëndronte mes Marrëveshjeve të burokratëve të arsimit mes dy vendeve tona dhe realiteteve. Kështu tre mijë studentëve nga Kosova, të cilët ishin në universitetet private shqiptare, nuk u njihej diploma në Kosovë. Prej nga 2010-a ata kishin bërë kërkesa të vazhdueshme në ministri dhe në të gjitha institucionet përkatëse për këtë problematikë. Përgjigjja si zakonisht thuhej se do të bëhej shpejt, madje në takimin e ministrit të Arsimit të Kosovës me ministren e Arsimit të Shqipërisë, më 8 shkurt 2016, u premtua se brenda javës do të nisë procesi i njësimit të diplomave, por kjo nuk ndodhi![97] Marrëdhënia e institucioneve të arsimit shqiptar është më e afërt me Kosovën, pastaj me Malin e Zi, Maqedoninë. Kuptohet se nga ana institucionale ka një mal marrëveshjesh dhe bashkëpunimesh.[98] Ato datojnë që nga *Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në fushat e arsimit dhe shkencës, nënshkruar më 8 mars 2010*. Në zbatim të marrëveshjes është realizuar:

- *Shkëmbimi i ndërsjellët i studentëve për studime universitare dhe pasuniversitare.*
- *Realizimi i diplomave të përbashkëta në nivelin master dhe doktoratë me logon e një universiteti në Shqipëri dhe një tjetri në Kosovë.*

[96] Material i përgatitur i Zyrës së Shtypit të Ministrisë së Arsimit për raportin lidhur me Marrëveshjet Arsimore të Republikës së Shqipërisë dhe vendet e rajonit, datë 15 Nëntor.
[97] Pa Autor (2016) "Kosovë, 3000 studentëve nuk u njihen diplomat shqiptare", Gazeta Shqip, 15 Mars, http://gazeta-shqip.com/lajme/2016/03/15/kosove-3000-studenteve-nuk-u-njihen-diplomat-shqiptare/.
[98] Pa Autor (2014) "Deklarata për bashkëpunim dhe partneritet strategjik Shqipëri-Kosovë", Shqiptarja.com, http://shqiptarja.com/skedat/2724/deklarata-per-bashkepunim-dhe-partneritet-strategjik-shqiperi-kosove-195455.html.

Në të gjitha takimet është konkluduar se arsimi do mbetet një rrugë nga ku mund të bëhet shumë për progresin social dhe ekonomik të dy vendeve në të ardhmen. Në realitet gjendja është shumë e mjerueshme. Infrastruktura shkollore lë shumë për të dëshiruar dhe Shqipëria me atë gjendje të arsimit që shpalos, ku për çdo vit ka probleme me tekstet, korrupsionin dhe mungesën e kualifikimit të stafit pedagogjik, nuk mund të ketë ndonjë lloj impakti të spikatur në Kosovë. Dhe, shqetësimet nuk mbarojnë këtu, pasi liberalizimi i përhapjes së shkollave private, ka bërë që niveli i arsimit të jetë në nivele aq shumë të ulëta saqë në disa segmente të arsimit gjëndja është kritike. Shembujt e mirë janë shumë të pakët në Shqipëri dhe po ashtu në Kosovë, Maqedoni e gjetkë, por më shumë modelet që mund të jepen janë ende shumë larg. Në këtë kuadër, impakti i Shqipërisë, sa i përket përvojave të shkollave private, ka qenë shumë i pa vënë re. Ideja për të krijuar një platformë për arsimin është e vështirë për arsye sepse nuk ka vullnet, por edhe mungon përgatitja e politikave të reja të përbashkëta të cilat do të synonin krijimin e një sistemi arsimor të unifikuar për Shqipërinë dhe Kosovën.

Ka pasur një përpjekje në vitin 2011 për abetaren, një tjetër *Marrëveshje më vonë për organizimin e përbashkët të mësimit të gjuhës shqipe dhe të kulturës shqiptare në diasporë dhe në mërgatë*, nënshkruar në Tiranë, me rastin e takimit të dy qeverive më 23 mars 2015. Kjo e fundit përcolli një marrëveshje tjetër që lidhej me marrëveshjen e bashkëpunimit në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, ku u premtua se shpejt do të niste procesi i njohjes së diplomave të studentëve kosovarë që janë diplomuar në institucionet private të arsimit të lartë në Shqipëri. Në zbatim të marrëveshjes, pati rritje të bashkëpunimit midis Sektorëve të Njohjes së Diplomave (Enic/Naric) të të dy ministrive, që sipas institucioneve do lehtësonte procesin e njohjes së diplomave.[99]

Por a ka dështuar arsimi në rajon dhe në hapësirën shqiptarofolëse dhe cili është impakti shqiptar? Kësaj pyetje një ministër shqiptar iu përgjigj me shumë vështirësi: "*Vendimi është për të njohur tekstet dhe tekstet janë të njohura. Pra një tekst se si shkollohet një fëmijë në Shqipëri, apo në Kosovë të njihet nga të dyja anët e kufirit. Ky vendim është marrë. Nga ana tjetër, ne nuk mund të shkruajmë për realitetin e teksteve shkollore. Në Shqipëri, sot, një shkollë ka autonomi për të përzgjedhur tekstet me të cilët do të shkollojë brezin e ri dhe kjo nuk është e njëjtë për çdo shkollë. Po flasim për tekste, të cilat janë të njohura nga dy qeveritë nga dy instancat tona",* shprehet Ministri i Jashtëm shqiptar Ditmir Bushati.[100]

Sa i përket Malit të Zi, Shqipëria vuan shumë sfida dhe ato më së pari kanë lidhje me përballjen e impaktit me komunat me popullsi shqiptare. Mungesa e duhur e librave shqip, por edhe politikave ka bërë që shqipja të fillojë të humbë nga këto vende. Pasojat janë referuar dhe disa dëshmi që vinë në terren janë shqetësuese. Në planin zyrtar kemi një *Marrëveshje bashkëpunimi në fushën e arsimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi, nënshkruar në Tiranë, më 11 mars 2013 hyrë në fuqi më 28 shkurt 2014.* Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje konsiston në:

[99] Pa Autor (2015) "Shqipëri-Kosovë, tre marrëveshje për arsimin e dy vendeve", 23 Mars, https://arsimi.gov.al/al/newsroom/lajme/shqiperi-kosove-tre-marreveshje-per-arsimin-e-dy-vendeve&page=16.
[100] Pa Autor (2017) "A dështoi bashkimi qeveritar Shqipëri – Kosovë?", Aktiv Press, http://aktivpress.com/a-deshtoi-bashkimi-qeveritar-shqiperi-kosove/.

- Bashkëpunim aktiv në kuadër të programeve arsimore rajonale, ndërkufitare dhe ndërkombëtare;
- Shkëmbimin e përvojës në reformën e sistemit arsimor, me qëllim përfitimin nga praktikat më të mira;
- Realizimin e projekteve në nivel shkollash, duke përfshirë binjakëzime shkollash, zhvillimin e programeve të përbashkëta, shkëmbime grupesh dhe nxënësish etj.
- Lëvizjen e lirë të studentëve në të gjitha nivelet e arsimit të lartë; ofrimin e bursave universitare, pasuniversitare dhe kërkimore mbi parimin e reciprocitetit.
- Shkëmbimin e profesorëve bazuar në marrëveshjet midis institucioneve të arsimit të lartë.[101]

Para saj ka funksionuar *Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Malit të Zi për bashkëpunimin shkencor dhe teknologjik, nënshkruar në Podgoricë më 16 dhjetor 2008* nga Ministrat e Arsimit dhe Shkencës të të dyja vendeve**.** Kjo marrëveshje parashikonte ndër të tjera:

- Realizimin e projekteve të përbashkëta të kërkimit, zhvillimit dhe projektimit;
- Shkëmbimin e shkencëtarëve, kërkuesve dhe ekspertëve teknikë;
- Shkëmbimin e informacionit dhe dokumentacionit shkencor dhe teknologjik;
- Organizimin dhe pjesëmarrje në takime, konferenca, simpoziume, kurse, seminare;
- Ngritjen e qendrave të përbashkëta të kërkimit shkencor dhe grupeve të përbashkëta shkencore dhe të kërkimit. Kjo marrëveshje ishte e vlefshme për 5 vjet.[102]

Shqipëria dhe Maqedonia presin që shumë shpejt të konkretizojnë ato konkluzione që do dalin nga mbledhja e dy qeverive, e cila do të zhvillohet në Shqipëri. Pritet që të dy vende të kenë propozime konkrete. Deri më tani e gjithë veprimtaria mes dy vendeve bazohet në *Marrëveshjen ndërmjet qeverisë shqiptare dhe qeverisë maqedone për bashkëpunim në fushën e arsimit dhe shkencës, nënshkruar në Shkup më 2 korrik 2015*; *programin e bashkëpunimit me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë për periudhën 2015-2018, nënshkruar në Manastir më 22.11.2015*.[103] Në bazë të marrëveshjes dhe këtij programi palët janë zotuar që të shkëmbenin reciprokisht bursa në institucionet shtetërore të arsimit të lartë për mësimin e gjuhës dhe letërsisë maqedonase dhe për mësimin e gjuhës dhe letërsisë shqiptare, bursa për studime universitare dhe pasuniversitare, vizita studimore, shkëmbimi i ekspertëve në fushën e arsimit, duke realizuar vizita studimore dhe shkencore si dhe forma të tjera të bashkëpunimit.[104] Për fat të keq impakti ka qenë i vogël dhe pothuaj i papërfillshëm megjithë fjalët e mëdha. Një përpjekje e madhe është bërë me idenë e hapjes së një universiteti të dytë shqiptar, këtë herë në Shkup në një përpjekje që u bë më

[101] Burimi: zyra e shtypit të Ministrisë së Arsimit në Tiranë për raportin, datë 16 nëntor.
[102] *Po aty*.
[103] *Po aty*.
[104] *Po aty*.

2015. *"Kisha dashur që kjo ide që në fazën e planifikimit të analizohet saktë se në çfarë drejtime mund të kontribuohet për nevojat e popullatës shqiptare në Shkup. Kjo të bëhet duke plotësuar standardet e larta evropiane që të mund të keni një universitet sa më cilësor. Këtu kujdesi duhet shtuar në stafin menaxhues, por edhe në profesorët. Këtë e them edhe duke marrë parasysh përvojat jo të mira si tek ne lidhur me hapjen e universiteteve publike, pothuajse në të gjitha qytetet kryesore",* shprehej asokohe ish-zv/ministrja e Arsimit, Hafizi.[105]

Periferi e Periferisë: Rasti i Luginë së Preshevës dhe Bujanovcit

Problemi më i madh që është krijuar mes dy vendve lidhet me tekstet shkollore që pëdoren në Luginën e Preshevës. Tekstet mësimore që përdoren në shkolla janë në bazë të marrëveshjes së ministrisë së Arsimit të Serbisë dhe Shqipërisë. Abetarja që përdoret tashmë është e botuar në Shqipëri dhe ajo në pjesë të vogla iu është përshtatur nxënësve nga lugina e Preshevës.[106] *"Ka një marrëveshje në parim që të gjitha tekstet mësimore për shkollat fillore dhe të mesme për komunat në jug të Serbisë të vijnë nga Shqipëria, por në lidhje me këtë nuk është arritur ndonjë marrëveshje ndërmjet ministrive të dy shteteve për shkak të dallimit në sistemin arsimor"* ka thënë deputeti shqiptar në Parlamentin serb Hasani.[107]

Në fakt, marrëdhënia e arsimit mes Shqipërisë dhe Serbisë është e vjetër. Gjuha dhe letërsia shqipe pranë katedrës së gjuhës shqipe në Beograd mbështetet me pedagogë në kuadër të *Memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Serbisë* për bashkëpunimin rinor nënshkruar në Beograd më 10 nëntor 2014. Studentët diplomohen si specialistë të gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe kanë të drejtë të vijojnë studimet e ciklit të dytë në këto fusha. Çdo vit pranohen rreth 10-15 studentë serbë që ndjekin kursin veror të gjuhës shqipe. Në fakt, gjëndja në këtë katedër është larg parashikimeve dhe vetëm një pjesë e këtyre studentëve dalin me njohuri të mira të shqipes. Nga ana tjetër, çdo vit akademik pranohen për të studiuar në universitetet dhe shkollat tona të larta një numër i konsiderueshëm studentësh shqiptarë nga Lugina e Preshevës (Preshevë, Medvegjë, Bujanovc). Ky kontingjent studentësh dërgohet me kërkesën dhe pëlqimin e autoriteteve komunale shqiptare, por jo në kuadrin e bashkëpunimit zyrtar me Serbinë. Po ashtu në Marrëveshjen me Serbinë, te Neni 1, pika 8 e tij, parashikon që palët do të punonin së bashku, që brenda 90 ditëve të miratonin një dokument të përbashkët për njohjen reciproke të diplomave dhe gradave universitare. Ajo i është përcjellë Ministrisë së Punëve të Jashtme, duke shprehur gatishmërinë që përfaqësues/ekspertë të të dyja palëve të takohen për të saktësuar detajet teknike të kësaj marrëveshjeje, por ende sot, ajo mbetet në nivele teknike.[108] Që në vitin 2007 është nënshkruar marrëveshja ndërmjet Universitetit të

[105] Pa Autor (2015) "Tirana përkrah Universitetin shqip në Shkup", Gazeta Express, 11 Gusht, http://www.gazetaexpress.com/lajme/tirana-perkrah-universitetin-shqip-ne-shkup-121898?archive=1.
[106] Pa Autor (2017) "Abetaret dhe tekstet shkollore për Luginën arrijnë nga Shqipëria", Shenja, 2 Shkurt http://shenja.tv/abetaret-dhe-tekstet-shkollore-per-luginen-arrijne-nga-shqiperia/.
[107] *Po aty*.
[108] Procesverbal, datë 09.11.2016, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, Kuvendi i Shqipërisë, Tiranë, https://www.parlament.al/wp-content/uploads/2016/12/Komisioni-i-Medies-dat---09.11.2016.pdf.

Tiranës (UT) dhe atij të Beogradit (UB), për shkëmbimin e studentëve dhe të lektorëve, si dhe për pjesëmarrjen e studentëve dhe lektorëve të gjuhës shqipe të Universitetit të Beogradit në kurset verore të gjuhës dhe kulturës shqipe, që organizohen pranë Fakultetit Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës.[109]

Problemi më i madh i dy vendeve është realisht Presheva dhe Lugina e Bujanovcit. Shqetësimi me tekstet e komunave shqiptare vazhdon që të jetë shumë i mprehtë. Deputeti shqiptar në parlamentin e Serbisë Fatmir Hasani ka deklaruar se nxënësit e shkollave fillore në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë që e ndjekin mësimin në gjuhën shqipe përdorin tashmë teskte shkollore dhe abetare që botohen në Tiranë, por mungojnë tekste për lëndë të tjera.[110] *"Për ti përdorë këta tekste mësimore duhet që plan programi në këto dy shtete të përputhet së paku 70-80%, çka nuk është rasti. Në Ministrinë e Arsimit në Shqipëri më kanë thënë se propozimi i tyre është për ti përkthyer tekste mësimore që përdoren në Serbi në gjuhën shqipe"* ka thënë Hasani. *Tekstet mësimore në gjuhën shqipe për nxënësit e luginës së Preshevës deri në vitin 1999 janë siguruar nga Prishtina. 18 vitet e fundit nxënësit nga Lugina përdorin tekstet e vjetra 20 vjeçare, skripta apo marrin shënime me dorë*.[111]

Drejt Krijimit të Sistemeve të Përbashkëta Kulturore

Marrëveshja për Partneritetin Strategjik midis të dy vendeve është dokumenti bazë që ndihmon në forcimin e lidhjeve por edhe që institucionalizon marrëdhënien tonë. Bashkëpunimi në drejtim të Kulturës dhe Arsimit i Tiranës me vendet ku banojnë shqiptarët në rajon, megjithë marrëveshjet e arritura deri më tani llogaritet se është ende në fillesa. Kur e tillë konsiderohet marrëdhënia me Kosovën, atëherë llogaritet se sa i përket vendeve të tjera, marrëveshjet janë shumë të rregullta por ende pa impakt real.

Në fund, ajo që është më shqetësuese është sesa do të mbahet realisht në praktikë, kjo marrëdhënie, që tashmë nga ana institucionale, është krejt e kopsitur mes dy vendeve tona. *"Lidhur me sfidat që përballemi në këtë fushë, gjithsesi duhet thënë se duhet bërë më shumë në realizimin e projekteve më të mëdha në fushën e botimit të librit, projekteve të përbashkëta filmike dhe sportive. Natyrisht, për këtë duhen rritur edhe fondet financiare dhe kapacitetet administrative dhe ky është një proces që nuk mund të përmbyllet me një goditje, por vit pas viti. Esenciale mbetet të jetë prioritet i të dyja vendeve, qeverive dhe dikastereve të caktuara".*[112]

Është e vërtetë se në vitet e fundit ka bashkëpunime dhe përpjekje, madje promovimi i kulturës kombëtare dhe mbështetja kulturore e shqiptarëve jashtë vendit përbën detyrim kushtetues, por deri sot në programet e qeverive nuk kemi asnjë strategji mirëfilli apo zbatim praktik të këtij detyrimi. Në ministritë e lidhura direkt me kulturën dhe diplomacinë publike

[109] Partnerët, Universiteti i Tiranës, http://www.unitir.edu.al/index.php/studentet/trajnimet/36-universiteti-/artikuj-universiteti/63-pertneret.
[110] Pa Autor (2017) "Abetaret dhe tekstet shkollore për Luginën arrijnë nga Shqipëria", Shenja, 2 Shkurt http://shenja.tv/abetaret-dhe-tekstet-shkollore-per-luginen-arrijne-nga-shqiperia/.
[111] *Po aty*.
[112] Intervistë me Syl Ukshini, Ministër Këshilltar, I Ngarkuar me Punë Çështjet Politike, Integrime evropiane, organizata rajonale dhe ndërkombëtare, datë 24 nëntor 2017

nuk ka në organikën e tyre akoma struktura të posaçme dhe të specializuar për Diplomacinë Kulturore. Ka ardhur koha, që institucionet të krijojnë mekanizmat e duhura dhe instrumentet e monitorimit që t'u japin jetë marrëveshjeve. Për fat të keq, nuk ka buxhete të përcaktuara, sa i përket bashkëpunimeve në kulturë, art, media dhe sport dhe kjo i bën marrëveshjet që të jenë shumë burokratike. Ndërkohë gjetja e bashkëpunimit real në kulturë e arsim do të krijonte sheshimin e parë të problematikave të shqiptarëve në rajon dhe do të kishte impakt pozitiv jo vetëm në marrëdhëniet e përgjithshme Shqipëri-Kosovë, por edhe me Maqedoninë e Malin e Zi. Nga ana tjetër, impakti i diplomacisë kulturore të Shqipërisë mungon edhe prej vizionit shumë të pakët sa i përket gjetjes së elementëve që do e ndihmojnë këtë. Tirana, Prishtina dhe më pak qendrat e tjera nuk duhet ta shohin më me shemri njëra-tjetrën. Ka ardhur koha, që ato të krijojnë sisteme të përbashkëta kulturore. P.sh. Shqipëria ka pasur kohë të vështira prej komunizmit dhe izolimit të krijuar prej saj. Mungesën e qasjes në kulturën moderne të atyre kohëve mund ta plotësojë me autorët shqiptarë jashtë kufijve të saj. Për këtë duhet që Tirana artistike të jetë më modeste dhe të shikojë me respekt autorët e përtej kufirit, që kanë jetuar në hapësirën ish-Jugosllave. Është momenti që shteti të subvencionojë median shqiptare të atashohet në Kosovë, Maqedoni e Malin e Zi. Është mënyra e vetme për të përcjellë përditmërinë, por edhe të monitorojë gjendjen e këtyre marrëveshjeve dhe grackave burokratike. Nga ana tjetër, arsimi duhet të punojë shumë më tepër sa i përket teksteve të përbashkëta dhe mirëkuptimit për të bashkërenduar shumë problematika. Ndërkohë që mund të punohet shumë më tepër sa i përket projektit për mësuesit e diasporës dhe përshtatjeve të kurrikulave të tyre.

Është e përcaktuar se kufijtë nuk mund të ndryshojnë, por përpjekja për të forcuar impaktin e Shqipërisë nuk duhet të ndalet. Problemi është nëse këto marrëdhënie në kulturë e arsim do jenë brënda hapësirës ekonomike, që parashikohet të bëhen me ndryshimet e realiteteve doganore. Përpjekja për anëtarësimin në BE do të ketë një rëndësi të veçantë për shqiptarët dhe vendet e banuara nga shqiptarët pasi do ndikojë direkt në mirëqenien e tyre.

SHTOJCA: MARRËVESHJET BILATERALE TË SHQIPËRISË ME VENDET E RAJONIT

I. Marrëveshjet midis Shqipërisë dhe Maqedonisë

1. Protokoll bashkëpunimi në fushën e sigurisë ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë dhe Ministrisë së Rendit Publik te Republikës së Shqipërisë dhe Shërbimit Informativ Kombëtar të Shqipërisë, nënshkruar më 5.6.1992.
2. Protokoll për vendosjen e bashkëpunimit midis Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë se Marrëdhënieve me Jashtë të Republikës së Maqedonisë në fushën e marrëdhënieve konsullore, nënshkruar më 29.7.1992.
3. Protokoll midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë për hapjen e pikave të reja të kalimit kufitar, nënshkruar më 12.12.1992.
4. Marrëveshje për bashkëpunimin shkencor, teknik dhe teknologjik midis Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë së Maqedonisë, nënshkruar më 1.6.1994.
5. Marrëveshje midis Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë së Maqedonisë për mbrojtjen dhe nxitjen e ndërsjellë të investimeve me Maqedoninë, nënshkruar më 4.12.1997, hyrë në fuqi me 3.4.1998.
6. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Maqedonisë për rindërtimin, riparimin dhe mirëmbajtjen e vijës kufitare dhe shenjave kufitare në kufirin shtetëror shqiptaro-maqedonas, nënshkruar më 4.12.1997.
7. Marrëveshje mbi tregtinë dhe bashkëpunimin ekonomik midis Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Maqedonase, nënshkruar më 4.12.1997.
8. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Maqedonase për masat për parandalimin dhe zgjidhjen e incidenteve në kufirin shtetëror shqiptaro-maqedonas, nënshkruar më 4.12.1997.
9. Protokoll mbi bashkëpunimin ekonomik midis Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë së Maqedonisë, nënshkruar më 15.1.1998.
10. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë së Maqedonisë mbi bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes së bimëve, nënshkruar më 15.1.1998.
11. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë së Maqedonisë për transportin ndërkombëtar të udhëtareve dhe të mallrave, nënshkruar më 15.1.1998.
12. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë së Maqedonisë për ekzekutimin e ndërsjellë të vendimeve gjyqësore për çështjeve penale, nënshkruar më 15.1.1998.
13. Marrëveshje ekstradimi ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë së Maqedonisë, nënshkruar më 15.1.1998.
14. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë së Maqedonisë mbi bashkëpunimin në fushën e mjekësisë veterinare, nënshkruar më 15.1.1998.
15. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë së Maqedonisë për ndihmë juridike në fushën civile dhe penale, nënshkruar më 15.1.1998.
16. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Maqedonisë, në lidhje me ndihmën e ndërsjellë dhe bashkëpunimin midis administratave të tyre doganore, nënshkruar më 15.1.1998.
17. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë Maqedonase për Shërbimet Ajrore ndërmjet dhe përtej territoreve të tyre respektive, nënshkruar më 4.6.1998. hyrë në fuqi në 1.1.2005.
18. Marrëveshje ndërmjet Qeverise Shqiptare dhe Qeverisë së Maqedonisë për shmangien e tatimeve të dyfishta, në lidhje me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal, nënshkruar më 15.1.1998.
19. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për vendosjen e linjës ndërkombëtare liqenore për pasagjerë Pogradec-Ohër, nënshkruar më 25.9.1999, hyrë në fuqi në 20.7.2005.
20. Protokoll ndërmjet Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punës dhe Politikave Sociale të Maqedonisë, mbi bashkëpunimin në fushën e politikave të punësimit, trajnimit dhe sigurimit social, nënshkruar më 22.1.1999.
21. Protokoll bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë maqedonase të Punëve të Jashtme, nënshkruar më 22.1.1999.
22. Marrëveshje mbi bashkëpunimin në fushën e bujqësisë ndërmjet Ministrisë Shqiptare të Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministrisë së Bujqësisë, Pyjeve dhe Ekonomisë Ujore të Maqedonisë, nënshkruar më 22.1.1999.
23. Protokoll mbi përcaktimin e fushave, mënyrave dhe rregullimit të pengimit të migrimit të paligjshëm midis Ministrisë së Rendit Publik të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë, nënshkruar më 16.7.2000.

24. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Maqedonase për bashkëpunimin në fushën e shëndetësisë dhe shkencave mjekësore, nënshkruar më 23.2.2001, hyrë ne fuqi me 25.4.2003.
25. Marrëveshje ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Maqedonase për bashkëpunim në fushën e arsimit dhe shkencës, nënshkruar më 23.2.2001, hyrë në fuqi 18.2.2003.
26. Marrëveshje për tregtinë e lirë ndërmjet Qeverisë Shqiptare dhe Qeverisë Maqedonase, nënshkruar më 29.3.2002, hyrë në fuqi më 15.7.2002.
27. Memorandum mirëkuptimi midis Ministrisë së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë për bashkëpunim dhe kontakte të avancuara, nënshkruar më 5.2.2003.
28. Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Maqedonisë për stërvitjen "Përpjekja e fqinjëve", nënshkruar më 5.3.2003.
29. Memorandumi i bashkëpunimit në procesin e integrimit evropian, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, nënshkruar më datë 17.6.2004.
30. Memorandumi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për mbrojtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të liqenit të Ohrit dhe pellgut të tij ujëmbledhës, nënshkruar në Shkup, më 17.6.2004.
31. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për ri-pranimin e personave, si dhe protokollin e saj, nënshkruar më 17.6.2004, hyrë në fuqi më 15.7.2005.
32. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë mbi bashkëpunimin në luftën ndaj terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope e prekursorëve, migracionit të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të paligjshme, nënshkruar më 17.6.2004, hyrë në fuqi në 20.5.2005.
33. Protokolli i bashkëpunimit midis Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë, nënshkruar në Shkup, më 15.4.2005.
34. Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë lidhur me stërvitjen "Adriatic Engagement 05", nënshkruar në Tiranë më 28.6.2005 dhe në Shkup në 8.7.2005.
35. Marrëveshje për bashkëpunimin në fushën e kulturës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, nënshkruar më 16.11.2005, hyrë në fuqi më 5.1.2007
36. Marrëveshje mbi bashkëpunimin në fushën e turizmit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, nënshkruar më 16.11.2005, hyrë në fuqi më 10.5.2006.
37. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për hapjen e pikës së kalimit kufitar rrugor ndërkombëtar midis dy vendeve "Xhepisht-Trebisht", nënshkruar më 16.11.2005.
38. Marrëveshje bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes së Maqedonisë dhe Bullgarisë për bashkëpunimin në fushën e përgatitjes luftarake, teknikës dhe shkencës, nënshkruar më 17.5.2005.
39. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për mbrojtjen e ndërsjellë të informacionit të klasifikuar, nënshkruar në Tiranë, më 16.11.2005, hyrë në fuqi 4.4.2006.
40. Protokolli i bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Patentave dhe Markave e Republikës së Shqipërisë dhe Entit Shtetëror të Pronësisë Industriale të Republikës së Maqedonisë, nënshkruar më 25.11.2005.
41. Protokoll bashkëpunimi në fushën e sektorit të energjisë, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Ekonomisë së Republikës së Maqedonisë, nënshkruar më 19.5.2006.
42. Protokoll dy palësh ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë dhe Konsorciumit AMBO "Për pikën hyrëse-dalëse të naftësjellësit Trans-Ballkanik AMBO", nënshkruar më 30.10.2006.
43. Memorandum Mirëkuptimi mbi bashkëpunimin ndërmjet zyrës së Prokurorit Publikë të Shqipërisë dhe zyrës së prokurorit të Përgjithshëm të Republikës së Maqedonisë, nënshkruar më 30.3.2005.
44. "Tirana Declaration" dokument i firmosur në datën 16.10.2007 mbi koordinimin e Sigurimeve sociale ne Evropën Juglindore.
45. "Montenegro Conclusions" dokument i firmosur gjate forumeve te konferencës së Tretë Ministrore mbi Punësimin dhe Politikat Sociale ne Evropën Juglindore, nënshkruar në Budva ne 26.10.2007.
46. Protokoll shtesë për intensifikimin e bashkëpunimit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore përmes kufijve shtetërore dhe për intensifikimin e viktimave, si dhe të personave të dyshuar si viktima të trafikut të qenieve njerëzore, në plotësim të "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë mbi bashkëpunimin në luftën ndaj terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope e prekursorëve, migracionit të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të paligjshme", nënshkruar më 14.9.2007.

47. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë mbi lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve, nënshkruar më 13.2.2008 dhe Protokolli i marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Maqedonisë mbi lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve gjatë qarkullimit në zonat kufitare, nënshkruar më 19.2.2008, hyrë në fuqi më 28.8.2008.
48. Marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Maqedonisë për patrullat e përbashkëta përgjatë kufirit shtetëror, nënshkruar më 22.2.2008.
49. Protokoll ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Maqedonisë, mbi organizimin dhe zhvillimin e takimeve ndërmjet drejtuesve të policive kufitare të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal, nënshkruar më 22.2.2008.
50. Protokoll bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Maqedonisë, nënshkruar me 8.2.2010, hyrë në fuqi të njëjtën datë.
51. Protokoll bashkëpunimi ndërmjet Akademisë Diplomatike të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe Drejtorisë për Akademinë Diplomatike të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Maqedonisë, nënshkruar më 8.2.2010, hyrë në fuqi në të njëjtën ditë.
52. Protokoll mbi shkëmbimin elektronik të të dhënave ndërmjet Administratave Doganore të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë, nënshkruar më 31.5.2012, hyrë në fuqi më 8.1.2013.
53. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, nënshkruar me 17.3.2011, hyrë në fuqi më 30.1.2012.
54. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për ndryshimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për lëvizjen e ndërsjellë të shtetasve, të nënshkruar më 19.2.2008", nënshkruar më 14.12.2011, hyrë në fuqi më 6.4.2012.
55. Marrëveshje midis Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Maqedonisë për krijimin dhe funksionimin e një qendre të përbashkët bashkëpunimi policor, nënshkruar më 15.3.2012, hyrë në fuqi më 14.4.2012.
56. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për zgjidhjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë kundrejt Republikës së Maqedonisë, lidhur me shlyerjen e shumave në llogarinë e shkëmbimit të mallrave ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe ish-Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë, nënshkruar në Tiranë më 18.6.2012 dhe në Shkup më 27.6.2012.
57. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për njohjen e ndërsjellë të lejeve të drejtimit, nënshkruar në Tiranë, më 23.11.2012, hyrë në fuqi me datë 14.3.2013.
58. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për pikën e përbashkët të kalimit kufitar, Trebisht–Xhepisht, nënshkruar në Tiranë, më 23.11.2012, hyrë në fuqi në datën 5.3.2013.
59. Memorandum Bashkëpunimi ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Maqedonisë, mbi forcimin e bashkëpunimit në fushën e kontrollit të brendshëm, nënshkruar më 17.5.2013, në Qafë Thanë, hyrë në fuqi më datë 17.5.2013.
60. Marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Maqedonisë mbi ngritjen dhe funksionimin e Qendrës së Përbashkët për shkëmbim informacioni në Qafë Thanë, nënshkruar në Shkup, më 15.3.2012.
61. Protokolli me shkëmbim notash diplomatike për zbatimin e "Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për vendosjen e linjës ndërkombëtare liqenore OhërPogradec", hyrë në fuqi më datë 4.8.2014.
62. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Ministrisë për Shoqëri Informatike dhe Administratë të Republikës së Maqedonisë për bashkëpunimin në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), nënshkruar më 15.9.2014, hyrë në fuqi në datën e nënshkrimit.
63. Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes se Republikës së Maqedonisë mbi shkëmbimin e ekspertëve, nënshkruar në Shkup, më 22.1.2015, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
64. Program për bashkëpunim kulturor ndërmjet Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës së Republikës së Maqedonisë për periudhën e vitit 2015-2020", nënshkruar në Tiranë, në datën 16.3.2015, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
65. Marrëveshje ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Maqedonisë për Mbrojtjen Shoqërore, nënshkruar më 17.3.2015, hyrë në fuqi më 1.6.2016.

66. Protokoll ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe ministrisë së Brendshme të Republikës së Maqedonisë për bashkëpunim gjatë sezonit turistik, nënshkruar në Tiranë, më 5.9.2014, hyrë në fuqi ditën e nënshkrimit.
67. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe shkencës, nënshkruar në Vlorë, më 2.7.2015, hyrë ne fuqi më 23.2.2016.
68. Program ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë në fushën e arsimit dhe shkencës për periudhën 2015-2018, nënshkruar në Manastir, më 22.11.2015, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
69. Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave të Shqipërisë dhe Arkivit Shtetëror të Maqedonisë, nënshkruar në Shkup, më 6.11.2015, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
70. Memorandum bashkëpunimi në sektorin e energjisë ndërmjet Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Ekonomisë së Republikës së Maqedonisë, nënshkruar në Strugë, më 11.12.2015, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
71. Program për bashkëpunim kulturor ndërmjet Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës së Republikës së Maqedonisë për periudhën e vitit 2015-2020, nënshkruar më 16.11.2015.
72. Protokoll ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë për ndjekjen konstante ndërkufitare, nënshkruar në Tiranë, më 19.7.2016, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
73. Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Urdhrit të veterinarisë së Republikës së Shqiptarë dhe Urdhrit të veterinarisë së Republikës së Maqedonisë, nënshkruar në Tetovë, më 2.12.2016.

II. Marrëveshjet midis Shqipërisë dhe Malit të Zi

1. Marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Rendit Publik të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Malit të Zi mbi vendosjen e qarkullimit te përhershëm ndërkombëtar nëpërmjet pikës së kalimit kufitar Hani i Hotit-Bozhaj, nënshkruar më 24.1.2000.
2. Marrëveshje për bashkëpunimit kulturor ndërmjet Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës, Sporteve dhe Medias të Malit të Zi, nënshkruar më 28.2.2001, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.
3. Marrëveshje midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi mbi problemet ujore, Statuti i Komisionit të përbashkët ndërqeveritar shqiptaro malazez për trajtimin e ujërave kufitare, si dhe Protokolli i mbledhjes së këtij Komisioni, nënshkruar më 31.10.2001, hyrë në fuqi më 13.2.2003.
4. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi, për bashkëpunimin në fushën e luftës kundër krimit të organizuar dhe trafikut të paligjshëm dhe aktiviteteve të tjera kriminale, nënshkruar më 31.10.2003.
5. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi, mbi transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, nënshkruar më 2.7.2004, hyrë në fuqi më 11.11.2004.
6. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi, për vendosjen e linjës ndërkombëtare liqenore për udhëtarë, Shkodër-Virpazar, nënshkruar në Podgoricë, më datë 2.7.2004.
7. Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi për shfrytëzimin e LTL 400 KV, nënshkruar më 2.7.2004.
8. Protokoll ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për bashkëpunimin në fushën e shëndetësisë dhe shkencave mjekësore, nënshkruar më 10.11.2004.
9. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Malit të Zi për bashkëpunim të ndërsjellë në çështjet doganore, nënshkruar më 23.12.2005, hyrë në fuqi më 1.12.2007.
10. Memorandum Mirëkuptimi mbi bashkëpunimin ndërmjet Zyrës së të Prokurorit të Përgjithshëm Republikës së Shqipërisë dhe zyrës së Prokurorit Shtetëror Suprem të Malit të Zi, nënshkruar më 30.3.2005.
11. Marrëveshje ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi, për organizimin e trafikut hekurudhor ndërmjet dy vendeve, nënshkruar më 16.5.2006.
12. Memorandum mirëkuptimi ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi për zhvillimin ndërkufitar të Liqenit të Shkodrës nënshkruar më 26.5.2006.
13. "Tirana Declaration" dokument i firmosur në datën 16.10.2007 mbi koordinimin e Sigurimeve sociale ne Evropën Juglindore.

14.“Montenegro Conclusions” dokument i firmosur gjatë Forumeve të Konferencës së Tretë Ministrore mbi Punësimin dhe Politikat Sociale në Evropën Juglindore, nënshkruar më 26.10.2007.
